



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 503 Akti

Nr. 635 Vendimi
Tiranë, më 13.3.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi Kryesuese
Roland Ilia Relator
Pamela Qirko Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 9.3.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Rexhina Merlika**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisioner Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në muajin qershor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Brunilda Bekteshi. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia, ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Brunilda Bekteshi. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Rexhina Merlika, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, kontrollit të figurës, si dhe vlerësimit të aftësive profesionale.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 22.12.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Rexhina Merlika; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
7. Subjekti i rivlerësimit, pas njoftimit mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit në datën 6.3.2023.
8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë znj. Rexhina Merlika në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 7.3.2023.

10. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 9.3.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

11. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Subjekti Rexhina Merlika ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

14. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

14.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

14.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

14.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

15. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

¹“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’.

kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

17. Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin Rexhina Merlika:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive;*
- *ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

18. Znj. Rexhina Merlika është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave private: (i) para fillimit të detyrës, vitit 2003; (ii) periodike/vjetore për vitet 2003 – 2017; (iii) deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;

Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

20. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2003 – 2018, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar pasuritë, si vijojnë:

1. Apartament banimi me sip. 105.13 m² dhe garazh me sip. 24.41 m², rruga “**”, nr. ****, Tiranë**

1.1 Në deklaratën *Vetting*² subjekti ka deklaruar këto pasuri të blera sipas kontratës së shitblerjes nr. ****, datë 3.12.2012. Vlera: 145.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

Hetimi i Komisionit

1.2 Komisioni hetoi lidhur me vlerën e blerjes, kohën dhe mënyrën e pagesës së kësteve (*cash* apo nëpërmjet bankës) të kësaj pasurie bazuar në deklarinin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar.

Vlera e blerjes

1.3 Në bazë të kontratës së shitblerjes nr. ****, datë 3.12.2012, rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj L.M kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin me sip. 105.13 m², me nr. pasurie ****, z. k. ****, vol. ****, f. ****, me çmim 135.000 euro dhe garazh me sip. 24.41 m², me nr. pasurie ****, z. k. ****, vol. ****, f. ****, me çmim 10.000 euro, në rrugën “****”, Tiranë. Pagesa në total 145.000 euro dhe sipas kontratës rezulton se është kryer jashtë zyrës noteriale.

1.4 Në deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur, pjesë të deklarinimit të interesave periodikë privatë për vitin 2008, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes

² Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti ka depozituar ndër të tjera: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, datë 24.12.2012, për apartament me sip. 105.13 m², me nr. pasurie ****, z. k. ****, vol. ****, f. **** në rrugën “****” Tiranë, në bashkëpronësi të shtetasve L dhe Rexhina Merlika + kartelë pasurie + hartë treguese e regjistrimit; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, datë 24.12.2012, për garazh me sip. 24.41 m², me nr. pasurie ****, z. k. ****, vol. ****, f. ****, në rrugën “****” Tiranë, në bashkëpronësi të shtetasve L dhe Rexhina Merlika + kartelë pasurie + hartë treguese e regjistrimit; (iii) kontratë shitblerjeje nr. ****, datë 3.12.2012, sipas së cilës shtetasit L dhe Rexhina Merlika blejnë nga shoqëria “****” sh.p.k., apartament me sip. 105.13 m², me nr. pasurie ****, z. k. ****, vol. ****, f. ****, me çmim 135.000 euro dhe garazh me sip. 24.41 m², me nr. pasurie ****, z. k. ****, vol. ****, f. ****, me çmim 10.000 euro, në rrugën “****”, Tiranë. Pagesa në total 145.000 euro është kryer jashtë zyrës noteriale + dokumentacion hipotekor i datës 6.7.2012 për apartamentin dhe garazhin në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. + dokumente identifikimi të blerësve.

datë 6.10.2008, për blerjen e një apartamenti me sip. 115.29 m² dhe një vendparkim automjeti, në shumën totale 172.172 euro, si dhe shlyerje të këstit të parë në shumën 62.000 euro (me burim: (i) tërhequr nga “Intesa Sanpaolo Bank” shuma 36.600 euro; (ii) të ardhura *cash* 19.990 euro; dhe (iii) gjendje të deklaruara nga bashkëshortja në vitet paraardhëse).

1.5 Me kontratën datë 6.10.2008 (shkresë e thjeshtë), bashkëshorti i subjektit, shtetasi L.M, ka porositur te shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. ndërtimin e një apartamenti me sip. 115.29 m², ku përfshihet edhe sipërfaqja e përbashkët në Tiranë dhe një vend parkimi nr. ***, në katin ***, bodrum, kundrejt çmimit total prej 172.170 euro.

1.6 Sa më sipër, rezultoi se ka mospërputhje në lidhje me sipërfaqen dhe çmimin e apartamentit, pasi në kontratën e datës 6.10.2008 është porositur një apartament me sip. 115.29 m² dhe një vend parkimi automjeti, në shumën totale 172.170 euro, ndërsa në kontratën e shitblerjes apartamenti rezulton me sip. 105.13 m² dhe çmimi total i dy pasurive (apartament + garazh) është 145.000 euro.

1.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit në lidhje me mospërputhjen e çmimit të kontratës së sipërmarrjes me atë të blerjes, si dhe me punimet shtesë të kryera nga subjekti dhe personat e lidhur për këtë pasuri, ka shpjeguar se: *“...mospërputhja e çmimit të kontratës së sipërmarrjes datë 6.10.2008 dhe kontratë së shitblerjes datë 3.12.2012, nga 172.170 euro në 145.000 euro, ka ardhur për faktin se kontrata e sipërmarrjes është ndryshuar me vullnetin e palëve, pas rakordimit të punimeve, që janë pasqyruar në procesverbalin e mbajtur në datën 30.10.2010, ku janë listuar të gjitha ndryshimet e bëra gjatë ndërtimit të objektit, të bëra nga shoqëria “****” sh.p.k., të cilat kanë sjellë uljen e kostos së ndërtimit të objektit në tërësi e, për pasojë, edhe uljen e çmimit përfundimtar të shitjes. Ndryshimet në ndërtim kanë ndodhur për shkak të materialeve të termoizolimit (veshjes) të fasadës së jashtme të objektit, në ngrohjen qendrore, në heqjen e mobilimit të brendshëm (kuzhina berloni), etj., si dhe heqjen e disa punimeve të brendshme nga porositësi, të cilat janë kryer vetë më pas...”*

1.8 Subjekti, për të provuar deklaratimet e saj, ka bashkëlidhur: (i) kontratën e sipërmarrjes datë 1.11.2010; (ii) procesverbalin datë 30.10.2010.

1.9 Në bazë të procesverbalit datë 30.10.2010, të mbajtur ndërmjet përfaqësuesit të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe porositësit L. M, ndryshimet e bëra gjatë ndërtimit të objektit nga shoqëria kanë sjellë ndryshime në koston e objektit, për rrjedhojë, në ndryshim të çmimit të apartamentit dhe të vendparkimit, si dhe duke rënë dakord për çmimin total prej 145.000 euro.

1.10 Referuar kontratës së datës 1.11.2010 (shkresë e thjeshtë), mbajtur pranë selisë së shoqërisë “****” sh.p.k., porositësi L.M ka porositur pranë shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k. një apartament banimi me sipërfaqe ndërtimi në total 115.29 m² dhe një vendparkimi nr. ***, në katin ***, bodrum, në objektin “godinë banimi dhe shërbime”, 7-8 kate dhe 2 kate parkim nën tokë, në rrugën “****”, Tiranë.

1.11 Në pikën 1.3 të kontratës është përcaktuar se sipërmarrësi i dorëzon të përfunduar sipërfaqen ndërtimore apartament, në datën 30.10.2010, gjithashtu në nenin 3 “Çmimi i kontratës dhe mënyra e pagesës”, ku përcaktohet se: *“Çmimi i ambientit objekt kontrate, pasi janë bërë të gjitha rakordimet preventuese për të gjitha punimet e kryera në këtë objekt, të jetë 145.000 euro (për apartamentin dhe për vendparkimin); deri në datën 30.10.2010 është likuiduar vlera prej 119.609 euro dhe kësti i fundit në vlerën 25.391 euro do të paguhet deri në datën 30.6.2011”*.

1.12 Në deklaratën e interesave privatë personi i lidhur (pjesë e DIPPV-së së vitit 2010), bashkëshorti i subjektit, ka deklaruar detyrime financiare ndaj personave juridike dhe fizikë: *“...mbetur pa likuiduar kësti i fundit i çmimit të blerjes së apartamentit, pas zbritjes së punimeve të tjera të kryera privatisht në datën 1.10.2010...”*

1.13 Në lidhje me shpenzimet për punime shitesë të deklaruara, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit sqaron, ndër të tjera, se: *“...kemi kryer punime privatisht në apartament, janë hequr pjesë nga muret e brendshme, dyer të brendshme, janë kryer të gjitha punimet elektrike, hidraulike të objektit, si dhe lysterja e apartamentit, etj. Punime të cilat janë kryer kryesisht nga bashkëshorti, vëllai i tij hidraulik etj...”*.

1.14 Nisur nga fakti që subjekti ka pranuar kryerjen e punimeve shitesë, por nuk ka deklaruar vlerën e shpenzuar dhe/ose dokumentuar punimin e kryer, nga Komisioni i është kërkuar subjektit të deklarojë duke analizuar punimet e kryera, materialet e përdorura, kohën e kryerjes së tyre, vlerën e shpenzuar për këto punime, si dhe burimin e të ardhurave për shumën e shpenzuar.

1.15 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Lidhur me muret e brendshme, të cilat kanë qenë mure ndarëse sipas projektit me kërkesën tonë nuk janë ndërtuar fare nga firma. Prandaj mosvendosja e tyre ka eliminuar edhe vendosjen e dy dyerve të brendshme... Nga ana jonë janë kryer punimet elektrike, hidraulike në vitin 2009, si pas fazës ndërtimore në karabina. Këto punime janë marrë përsipër për t’u kryer privatisht për një cilësi dhe garanci punimesh dhe persona specialistë të familjes.*

*Vlera e materialeve hidraulike, tuba plastikë me veshje alumini, blerë privatisht nga ana jonë në treg evidentohet në shumën 288 euro, konvertuar në 37.252 lekë sipas f. daljes nr. ***, datë 25.8.2009.*

*Vlera e materialeve elektrike (edhe këto të realizuara në vitin 2009), në shumën 15.250 lekë, sipas faturave të datave 15.8.2009, 5.11.2009 dhe 6.11.2009 janë paguar sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 24.2.2010.*

Pra, punimet e kryera në vitin 2009 janë në vlerën 52.500 lekë, por nga kjo shumë në këtë vit është paguar vetëm vlera prej 35.252 lekësh (pjesa e mbetur paguar në vitin 2010) dhe si burim kanë shërbyer të ardhurat nga paga dhe biznesi i bashkëshortit...”

1.16 Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar³ se në vitin 2010 është paguar shuma prej 639.404 lekësh për punime të kryera, duke ndarë burimin e të ardhurave, për periudhën janar - qershor 2010, të ardhurat nga puna dhe biznesi i bashkëshortit në vlerën 138.530 lekë dhe për periudhën korrik - nëntor 2010 nga shuma e mbetur (500.874 lekë) nga huaja e z. P.H.

1.17 Pra, subjekti ka deklaruar se vlera e shpenzuar për punimet në apartamentin në rrugën “****”, Tiranë, është në vlerën 676.656 lekë (37.252 lekë në vitin 2009 dhe 639.404 lekë në vitin 2010), vlerë e cila është pasqyruar në analizën paraprake financiare.

1.18 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka paraqitur pranë Komisionit kopje të dokumentit, “fletë dalje nr. ****”, të muajit gusht 2010, e cila mban vulën “*****”, person fizik, me NIPT ***, për blerjen e 4 dyerve të brendshme për banesën e saj. Sipas QKB-së, subjekti tregtar “****” është regjistruar dhe krijuar në vitin 2015. Për këtë mospërputhje është pyetur subjekti, e cila ka deklaruar⁴ se: *“Në vitin 2010 kur kemi porositur dyert aty për shkak të lidhjes familjare, ne nuk kemi verifikuar a ka ky subjekti regjistrim në organet tatimore dhe nuk na ka shkuar ndërmend se një aktivitet privat në një ambient publik i njohur në lagjen ‘***’, nuk ka*

³ Subjekti ka bashkëlidhur ndër të tjera edhe: (i) fletë daljeje datë 25.8.2009, në vlerën 288 euro; (ii) fletë daljeje datë 15.8.2009, në shumën 7.370 lekë; fletë daljeje datë 5.11.2009, në shumën 6.280 lekë; dokument datë 6.11.2009 për shumën 1.600 lekë; preventiv datë 30.1.2010 nga “****” sh.p.k. për shumën 5.320 lekë; mandatarkëtim datë 24.2.2010 shuma 20.570 lekë; fletë daljeje datë 19.4.2010, në vlerën 12.600 lekë; fletë daljeje datë 29.5.2010 për shumën 18.600 lekë; mandatarkëtimi datë 2.8.2010 në shumën 700 euro; fletë dalje ***, për dyer të brendshme dhe mandatpagesë në shumën 78.000 lekë; printim fature shitjeje datë 6.8.2010 në shumën 134.150 lekë; printim faturë shitjeje datë 12.9.2010, në shumën 176.000 lekë; fletë daljeje datë 13.3.2010 në shumën 2.756 lekë (pa emër); dokument scontrino datë 13.3.2010 për nxjerrje nga magazina mallra/materiale në vlerën 24.100 lekë; dokument scontrino datë 21.4.2010 për nxjerrje nga magazina mallra/materiale në vlerën 15.253 lekë; fletë daljeje datë 21.4.2010, në vlerën 26.914 lekë; fletë daljeje datë 8.6.2010 në vlerën 10.267 lekë.

⁴ Shihni përgjigjen e subjektit mbi pyetësorin nr. ***.

qenë i regjistruar në organet tatimore që kontrolloheshin në atë kohë nga inspektorët e tatimeve pranë Bashkisë Krujë”.

1.19 Në lidhje me konflikt të mundshëm të interesit, subjekti ka deklaruar⁵ dhe dokumentuar me shkresën nr. *** prot., datë 20.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, që nuk ka gjykuar çështje gjyqësore me palë ndërgjyqëse shoqëritë ndërtuese “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., si dhe administrator/ortakun e tyre, z. V.N.

Koha dhe mënyra e pagesës së çmimit të blerjes

1.20 Në kontratën e datës 6.10.2008 është dakordësuar që çmimi total i blerjes së këtyre pasurive prej 172.170 euro, të paguhej me këste:

- i. porositësi ka paguar këstin e parë në shumën 51.000 euro me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes;
- ii. kësti i dytë në shumën 51.000 euro deri në datën 30.2.2009;
- iii. kësti i tretë në shumën 51.000 euro deri në datën 30.10.2009;
- iv. kësti i fundit në shumën 19.170 euro, me firmosjen e procesverbalit dhe marrjen në dorëzim të ambientit.

1.21 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se likuidimi i vlerës së shtëpisë është bërë me këste, duke filluar nga periudha 2008 – 2012.

1.22 Në deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur, pjesë të deklaramit të interesave periodikë privatë për vitin 2008, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes datë 6.10.2008, për blerjen e një apartamenti me sip. 115.29 m² dhe një vendparkimi automjeti, në shumën totale 172.172 euro, si dhe shlyerje të këstit të parë në shumën 62.000 euro.

1.23 Në DIPP-në e vitit 2009 (deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur), bashkëshorti i subjektit ka deklaruar *shlyer kësti në shumën 30.000 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 21.1.2009.*

1.24 Në DIPP-në e vitit 2010 (deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur), bashkëshorti i subjektit ka deklaruar – *shlyer kësti i blerjes së apartamentit në datën 2.7.2010 në shumën 30.000 euro, te firma ‘***’, ndërsa në detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë ka deklaruar – mbetur pa likuiduar kësti i fundit i çmimit të blerjes së apartamentit, pas zbritjes së punimeve të tjera të kryera privatisht në datën 1.10.2010 (kontratë), shuma e shlyer 30.000 euro, detyrim i mbetur 25.391 euro...”.*

1.25 Në DIPP-në e vitit 2011 (deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur), bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “...shlyer kësti i fundit i blerjes së apartamentit në datën 30.6.2011, në shumën 25.391 euro, te firma ‘****’...”.

1.26 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2⁶, subjekti i rivlerësimit në lidhje me kohën dhe shumën e paguar për blerjen e këtyre pasurive, ndër të tjera, ka deklaruar se pagesat e bëra për shlyerjen e shumës 145.000 euro, të vlerës së shitjes së apartamentit + garazh, nga personi i lidhur (bashkëshorti) janë kryer me bankë dhe në arkën e shoqërisë (*cash*), konkretisht:

Datë	Shuma e paguar në euro	Mënyra e pagesës
17.10.2008	25.100	Arkë
17.10.2008	36.900	Bankë
20.3.2009	30.000	Bankë
2.7.2010	30.000	Bankë
7.1.2011	13.000	Bankë
30.6.2011	12.391	Arkë

⁵ Përgjigje pyetësori nr. ***.

⁶ Përgjigje e pyetjes nr. ***.

1.27 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe dokumentacionin për të vërtetuar pagesat e kryera për çmimin e blerjes së kësaj pasurie⁷.

Konkluzion i Komisionit

1.28 Në përfundim të hetimit Komisioni konstatoi se ka mospërputhje të:

- çmimit të paguar me vlerat referuar mandateve të depozituara, konkretisht, subjekti deklaroi se personi i lidhur (bashkëshorti) ka paguar 145.000 euro, ndërsa referuar dokumentacionit është paguar një shumë prej 147.391 euro;
- pagesës së kështit të parë, pasi referuar kontratës së datës 6.10.2008, shuma prej 51.000 euro është likuiduar në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti është paguar shuma 62.000 euro në datën 17.10.2008;
- në lidhje me pagesën e kështit të fundit të çmimit të blerjes së apartamentit, pasi në DPV-në e vitit 2011 është deklaruar *paguar në datën 30.6.2011, shuma 25.391 euro*, ndërsa referuar përgjigjeve në pyetësorin nr. *** rezultoi se kjo shumë është paguar në dy këste, një në datën 7.1.2011 në vlerën 13.000 euro dhe kësti tjetër në datën 30.6.2011 në shumën 12.391 euro.

1.29 Lidhur me gjetjet e mësipërme subjektit i kaloi barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

1.30 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij ndër të tjera, ka deklaruar se mospërputhja mes çmimit të paguar dhe atij të parashikuar në kontratën e shitblerjes datë 3.12.2012, ka ardhur si shkak i parapagesës së disa shpenzimeve shtesë, të cilat kapin vlerën afërsisht 2,391 euro⁸. Për sa i përket deklarimit në DPV-në e vitit 2011, në të cilin është deklaruar se në datën 30.6.2011 është paguar shuma prej 25.391 euro, kur në fakt ky kësht është bërë në dy kohë të ndryshme, 13.000 euro në datën 7.1.2011 dhe tjetri prej 12.391 euro në datën 30.6.2011, ky deklarim është bërë në datën e fundit vetëm për efekt të deklarimit të detyrimit si total përmbushjeje detyrimi.

Vlerësim i Komisionit

1.31 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, në shpjegimet dhe në provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet dhe provat e depozituara në seancën dëgjimore të zhvilluar me subjektin e rivlerësimit, arsyetoi se:

1.32 Ndonëse gjatë hetimit administrativ u konstatuan mospërputhje të çmimit të deklaruar me atë të dokumentuar të paguar, nga Komisioni në analizën financiare paraprake janë pasqyruar në kohë dhe vlerë shumat e paguara, mbështetur në dokumentacionin përkatës ligjor/financiar, për rrjedhojë shpjegimet dhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti pas rezultateve të hetimit, përveçse saktëson qëllimin e pagesës më të lartë (parapagesë shpenzime shtesë), nuk ndikon në analizën dhe treguesit financiar për vitin 2011.

1.33 Në përfundim, trupi gjykues konstatoi se mospërputhja e çmimit të përcaktuar në kontratën e shitjes me vlerën e paguar nga subjekti, sipas veprimeve bankare dhe në arkë të kryera për këtë pasuri, ka ardhur si rezultat i pagesave shtesë të kryera nga subjekti që kapin shumën në total prej 2.391 euro.

⁷ (i) mandatpagesë nr. ***, datë 17.10.2008; (ii) transfertë bankare datë 17.10.2008, në "Intesa Sanpaolo Bank"; (iii) transfertë bankare datë 20.3.2009, në "Intesa Sanpaolo Bank"; (iv) transfertë bankare datë 2.7.2010, në "Intesa Sanpaolo Bank"; (v) transfertë bankare datë 7.1.2011 në IAP Bank; (vi) mandatpagesë nr. ***, datë 30.6.2011 i shoqërisë "****" sh.p.k.

⁸ Shihni dokumentacionin përcjellës në përgjigje të rezultateve të hetimit.

Në lidhje me burimin e deklaruar të të ardhurave për pagesën e çmimit të blerjes dhe mundësia financiare

1.34 Në deklaratën *Vetting*, subjekti, si burim të ardhurash, ka deklaruar:

- “Të ardhura neto nga puna ime si prokurore, gjyqtare, si dhe pagesë si lehtësuese nga Shkolla e Magjistraturës nga data 1.9.1989 deri më 31.12.2016.

- Të ardhura neto të bashkëshortit nga puna si nd/gjyqtar, gjyqtar, pagesë papunësie, si dhe profesioni i avokatit në vitet 1.1.1994 – 31.12.2016.

- Të ardhura nga pensioni nr. *** (babai i bashkëshortit), në vitet 11.3.1990 – 16.2.2004.

- Dëshmëpërblim si i përndjekur politik (babai i bashkëshortit) në vitet 1995 – 2013.

- Të ardhura nga pensioni nr. *** (nëna e bashkëshortit) në vitet 16.2.2004 – 28.5.2005.

- Dëshmëpërblim si trashëgimtarë të të përndjekurit politik (nëna e bashkëshortit) dhe sipas prokurës së posaçme nr. ***, datë 18.1.1995.

- Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 62.58 m², Lagjja nr. ***, Laç, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 10.1.2007. Depozituar në llogarinë depozitë llog. ***, në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, tërhequr në datën 20.1.2009, vlera ½ e depozitës + interesat.

- Të ardhura nga emigracioni, vëllezërit në Gjermani dhe Itali në vitet 2005 – 2009.

- Të ardhura nga shitja e automjetit (autoveturë tip ‘****’ viti 1992), kontratë nr. ***, datë 31.12.2009. Burimi i saj kontrate dhurimi automjeti me nr. ***, datë 9.8.2006.

- Të ardhura nga shitja e tokës bujqësore (ullishte) me sip. 72.500 m², sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 1.4.2008. Pasuri trashëgimore e bashkëshortit, sipas pjesës takuese. Pasuri e paregjistruar për shkak se nuk ka një regjistrim fillestar në qytetin e Krujës, sipas aktit të marrjes në pronësi nr. ***, datë 9.9.1997.

- Shitje trualli me sip. 500 m² sipas kontratës së shitblerjes noteriale nr. ***, datë 8.10.2009 (pasuri trashëgimore e bashkëshortit nga nëna).

- Shitje trualli me sip. 180 m² sipas kontratës së shitblerjes noteriale nr. ***, datë 8.10.2009 (pasuri trashëgimore e bashkëshortit nga nëna).

- Të ardhura nga shitja e autoveturës tip ‘****’, viti i prodhimit 2000, me kontratë nr. ***, datë 18.12.2012 (fillimisht është blerë autoveturë tip ‘****’, vit prodhimi 1986, sipas kontratës nr. ***, datë 7.10.2002, i cili është shitur me kontratë nr. ***, datë 17.11.2006 dhe me të ardhurat nga kjo shitje është blerë autovetura tip ‘****’, vit prodhimi 2000, me kontratë nr. ***, datë 25.4.2007).

Likuidimi i vlerës së shtëpisë është bërë me këste, duke filluar që nga viti 2008 – 2012.

Për likuidimin e kësaj vlere janë përdorur edhe huat e marra ndaj personave të tretë, përkatësisht me kontrata datë 17.1.2009; datë 1.3.2011, si dhe ajo datë 2.7.2010.

Po kështu, depozitat bankare në ‘Alpha Bank’ A. E. nr. ***, në lekë, datë 26.7.2001, nr. ***, në euro datë 8.8.2007 me interesat e tyre, janë përdorur për likuidimin e kësteve të shtëpisë. Llogaria tek ‘Intesa Sanpaolo Bank’ nr. ***, datë 17.1.2007”.

1.35 Nisur nga fakti që në deklaratën *Vetting* subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë bërë një ndarje të burimeve të krijimit të kësaj pasurie në momentin e krijimit, por kanë deklaruar gati të gjitha burimet e të ardhurave, duke përfshirë dhe jo vetëm burimet e krijimit ashtu edhe burimet e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e huave të deklaruara të marra nga persona të tretë, për të evidentuar mundësitë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për pagesën e kësteve të kësaj pasurie, Komisioni vlerësoi që analiza ligjore ashtu edhe financiare të kryhet për çdo këst, në vitin/kohën e pagesës.

Në lidhje me pagesën e kështit të parë në shumën 62.000 euro

1.36 Në deklaratën e interesave private të personit të lidhur, pjesë të deklaratimit të interesave periodike private për vitin 2008, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar shlyerje të kështit të parë në shumën 62.000 euro (me burim: (i) tërhequr nga “Intesa Sanpaolo Bank” shuma 36.600 euro; (ii) të ardhura *cash* 19.990 euro; dhe (iii) gjendje të deklaruara nga bashkëshortja në vitet paraardhëse).

1.37 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në vitin 2008 (datë 17.10.2008), nga ana e personit të lidhur (bashkëshortit të saj) është shlyer me dy pagesa, kështi i parë i çmimit të blerjes së pasurive objekt i kontratës së sipërmarrjes.

1.38 Referuar të dhënave nga “Intesa Sanpaolo Bank” me shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.7.2022, rezulton se në datën 17.10.2008 nga llogaria në emër të bashkëshortit të subjektit është transferuar shuma 36.900 euro, te llogaria e shtetasit B. U me përshkrimin “shlyerje për blerje apartamenti”.

1.39 Shuma e transferuar prej 36.900 euro, në datën 17.10.2008, është formuar si rezultat i maturimit të depozitës me afat në emër të bashkëshortit të subjektit në këtë bankë, në shumën 35.000 euro (depozituar *cash* në datën 17.1.2007) dhe interesit përkatës të llogaritur.

1.40 Nisur nga fakti që në deklaratimin e interesave private për vitin 2007 nuk është deklaruar burimi i të ardhurave për krijimin e shumës 35.000 euro në datën 17.1.2007 është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili ka sqaruar se: “...shuma prej 35.000 euro të depozituara në ‘Intesa Sanpaolo Bank’ (ish Banka Amerikane), janë kursime nga puna e përbashkët, tërheqjet nga bankat në lekë/euro, shitje autoveturë tip ‘***’, gjendje *cash* në lekë/euro, të ardhura të tjera të krijuara sipas deklarimeve DPV në vitet e mëparshme 2005 dhe 2006, nga gjendjet *cash* si në lekë apo euro...”.

1.41 Referuar deklaratimit të interesave private për herë të parë dhe deklarimeve periodike vjetore subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur ka kryer këto deklarime në lidhje me shtesat dhe pakësimet, kursimet gjendje *cash* në banesë, konkretisht:

- në deklaratimin e interesave private për herë të parë në datën 17.3.2004, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në shumën 0.6 milionë lekë, me burim kursime familjare ndër vite;
- në deklaratimin e interesave private periodikë për vitin 2004, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 300.000 lekë, vit krijimi 2004;
- në deklaratimin e interesave private periodikë për vitin 2005, subjekti ka deklaruar shtesë në gjendje *cash* në shumën 750.000 lekë, nga pakësimi i gjendjes në llogari në emër të bashkëshortit në “Alpha Bank”;
- në deklaratimin e interesave private periodikë për vitin 2006, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 1.100.000 lekë, si dhe gjendje *cash* 3.500 euro (ardhur nga emigracioni në datën 15.11.2006 në Bankën Popullore nga shtetasit N.G dhe A.G).

1.42 Nga vlerat e deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur (bashkëshorti i saj) në deklaratimet, më sipër, si kursime *cash* të krijuara në vitet përkatëse të deklaratimit (pra, shtesë të likuditeteve *cash*)⁹, shuma totale e likuditeteve *cash* të deklaruara gjendje në banesë në datën 31.12.2006, do të rezultonte në vlerat 2.750.000 lekë dhe 3.500 euro.

1.43 Nga analiza paraprake e treguesve financiarë të kryer nga Komisioni¹⁰, rezulton se për vitin e mbyllur 2004 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për shtesën në kursime *cash* në shumën 300.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të ndryshme. Pra, për periudhën deri në datën 31.12.2006, referuar deklarimeve të subjektit në DIPPV-në përkatëse, mbështetur edhe në analizën e sipërpërmendur, shuma e kursimeve *cash*

⁹ Subjekti në DPV-në e vitit 2007 nuk deklaroi pakësim të vlerave monetare *cash* në banesë.

¹⁰ Bashkëlidhur rezultateve.

nga Komisioni vlerësohet në vlerën 2.450.000 lekë (2.750.000 lekë - 300.000 lekë) dhe 3.500 euro.

1.44 Nga Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, u krye një analizë paraprake e treguesve financiarë për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e shumës 35.000 euro në datën 17.1.2007, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2007 - 17.1.2007 (duke përfshirë gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur deri në fund të vitit 2006).

1.45 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshorti) nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e depozitës në shumën 35.000 euro në datën 17.1.2007 në “Intesa Sanpaolo Bank” (e cila ka shërbyer si burim për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit, nëpërmjet transfertës bankare në datën 17.10.2008), si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.1.2007 - 17.1.2007 (balancë negative në vlerën -1.236.543 lekë)¹¹.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

1.46 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegime të rezultateve të hetimit ka pretenduar se në pyetësorët ***,*** dhe *** ka deklaruar burimet e të ardhurave në mënyrë të detajuar, si dhe sipas raportit financiar datë 3.3.2023 janë evidentuar në hollësi ato, shoqëruar me tabelat përkatëse.

1.47 Subjekti i rivlerësimit, mbështetur në analizën, metodologjinë dhe në përfundimet e pasqyruara në raportin e datës 3.3.2023 të Kontabilistit të Miratuar P. XH., ka pretenduar se sipas të hyrave dhe të dalave të parasë, analizës financiare dhe gjendjes së likuiditetit në arkë dhe në bankë për periudhën 2002 – 2006, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi nga burime të deklaruara dhe të dokumentuara të ardhurash për krijimin e depozitës në shumën 35.000 euro në datën 17.1.2007.

1.48 Në vazhdim të shpjegimeve ka analizuar se të gjitha kursimet që posedoheshin ndër vite nga prindërit e bashkëshortit, pas ndarjes nga jeta të tyre, janë depozituar në bankë në datën 17.1.2007. Shuma e kursimeve të prindërve ka qenë afërsisht 1.700.000 lekë, të cilat janë krijuar ndër vite nga prindërit e bashkëshortit¹².

1.49 Shuma e kursimeve përafërsisht prej 1.700.000 lekësh së bashku me gjendjen *cash* në ALL, të rezultuar në fund të vitit 2006 në shumën 2.750.000 lekë, janë derdhur në datën 17.1.2007 në “Intesa Sanpaolo Bank”, si depozitë në shumën 35.000 euro ose sipas kursit të këmbimit, konvertuar në vlerën 4.355.775 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

1.50 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar si dhe shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramet dhe provat e depozituara në seancën dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

¹¹ Për më shumë referojuni dosjes së procesit të rivlerësimit.

¹² Krijuar në periudhën 1989 – 2002, si burim të ardhurash janë deklaruar: kursimet nga pensioni; përfitimi nga dëmshpërblimi si i përndjekur politik; të ardhura nga puna në veprimtari private bujqësore ndër vite; kontribute ndër vite nga subjekti i rivlerësimit dhe i personit të lidhur me të, si dhe nga kontributi i fëmijëve të tjerë D. M. dhe S. M.

1.51 Depozita me afat në emër të personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit) në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 35.000 euro, krijuar nga depozitimi *cash* në datën 17.1.2007, ka shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë të çmimit të apartamentit + garazh në Tiranë, për rrjedhojë, nga Komisioni është verifikuar/analizuar burimi i të ardhurave të subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e saj.

1.52 Nisur nga fakti që në deklarin e interesave privatë për vitin 2007 nuk është deklaruar burimi i të ardhurave për krijimin e shumës 35.000 euro në datën 17.1.2007, është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. ***¹³, ka sqaruar se: “...shuma prej 35.000 euro të depozituara në ‘Intesa Sanpaolo Bank’ (ish Banka Amerikane) janë kursime nga puna e përbashkët, tërheqjet nga bankat në lekë/euro, shitje autoveturë tip ‘***’, gjendje *cash* në lekë/euro, të ardhura të tjera të krijuara sipas deklarimeve DPV në vitet e mëparshme 2005 dhe 2006, nga gjendjet *cash* si në lekë apo euro, të cilat janë depozituar në datën 17.1.2007...”.

1.53 Marrë shkas nga ky deklarin i burimit të krijimit të këtyre likuditeteve të depozituara në datën 17.1.2007, nga Komisioni janë analizuar kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur (bashkëshorti), në deklarin të interesave privatë pranë ILDKPKI-së, që nga periudha e parë deklaruese (viti 2003) deri në deklarin e vitit 2006.

1.54 Në shpjegimet pas rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se si burimin për krijimin e kësaj depozite kanë shërbyer edhe kursimet e prindërve të bashkëshortit në shumën 1.700.000 lekë, të krijuara në periudhën 1989 – 2002.

1.55 Në lidhje me këtë burim krijimi, të deklaruar pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personi i lidhur kanë shtuar një burim të ri për krijim të këtyre vlerave monetare, burim i cili nuk ka qenë i deklaruar në asnjë deklarin paraardhës, përfshirë edhe përgjigjet e pyetësorit nr. ***, në të cilin është pyetur drejtpërdrejt për burimin e krijimit të shumës 35,000 euro, të depozituar *cash* në datën 17.1.2007 në “Intesa Sanpaolo Bank”.

1.56 Në lidhje me këtë burim krijimi, të deklaruar pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personi i lidhur kanë shtuar një burim të ri për krijim të këtyre vlerave monetare, burim i cili nuk ka qenë i deklaruar në asnjë deklarin paraardhës, përfshirë edhe përgjigjet e pyetësorit nr. ***, në të cilin është pyetur drejtpërdrejt për burimin e krijimit të shumës 35.000 euro të depozituar *cash* në datën 17.1.2007 në “Intesa Sanpaolo Bank”.

1.57 Pavarësisht këtij konstatimi, Komisioni ka marrë në analizë dokumentacionin e depozituar nga subjekti lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave, deklaruar si kursime të prindërve në shumën 1.7 milionë, krijuar në periudhën 1989 – 2002, specifikisht: kursimet nga pensioni; të ardhura të përfituara nga dëmshpërblimi si i përndjekur politik; të ardhura nga puna në veprimtari private bujqësore ndër vite; kontribute ndër vite nga subjekti i rivlerësimit dhe i personit të lidhur me të, si dhe nga kontributi i fëmijëve të tjerë D. M. dhe S. M.

1.58 Lidhur me këto të ardhura, Komisioni ka konstatuar se të ardhurat nga pensionet e prindërve të bashkëshortit kanë qenë në vlerën 654.261 lekë për babain e ndjerë të bashkëshortit për periudhën 4.3.1986 – 16.2.2004¹⁴ dhe në vlerën 52.944 lekë për nënën e ndjerë për periudhën 16.2.2004 – 28.5.2005¹⁵. Të ardhurat e pretenduara si dëmshpërblim si i përndjekur politik, në bazë të shkresës nr. *** prot., datë 24.2.2023, të Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave dhe për z. I. L në shumën 542.000 lekë (dosje ***), kanë filluar të shpërndahen në vitin 2009,

¹³ Përgjigje e pyetjes nr. ***.

¹⁴ Vërtetim Nr.*** Prot, datë 01.12.2016 nga DRSSH-ja Durrës.

¹⁵ Vërtetim Nr.*** Prot, datë 01.12.2016 nga DRSSH-ja Durrës.

ndërsa për sa i përket ish të dënuarit z. D.A.P. rezulton se nuk është miratuar asnjë nga listat e VKM-ve siç parashikon legjislacioni në fuqi¹⁶, ndërsa në shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2023, të Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë dhe monitorimit të Institucioneve të Varësisë, rezulton se ka përfituar shumën në të holla 200.000 lekë dhe në masën 720.000 lekë në letra me vlerë, por nuk përcaktohet koha e përfitimeve.

1.59 Për sa i përket pretendimeve për të ardhura të përfituara nga veprimtaria private bujqësore ndër vite dhe kontributi i subjektit, personit të lidhur (bashkëshortit) dhe fëmijëve të tjerë, këto kanë qenë deklarative, të padokumentuara me dokumentacion justifikues ligjor si për vlerën/kohën e përfitimit ashtu edhe për ligjshmërinë e të ardhurave.

1.60 Po ashtu, lidhur me pretendimin e subjektit se referuar raportit të kontabilistit të miratuar, bazuar në hyrje-daljet e parasë, analizës financiare dhe gjendjes së likuiditetit në arkë dhe në bankë për periudhën 2002 – 2006, ajo dhe personi i lidhur me të ka pasur mundësi nga burime të deklaruara dhe të dokumentuara të ardhurash për krijimin e depozitës në shumën 35.000 euro në datën 17.1.2007, trupi gjykues çmon se vlerëson se kursimet e mundshme të pretenduara nuk mund të merren në konsideratë, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar këto kursime në deklaratën e interesave privatë. Bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar tatimet, ndërkohë që në rastin konkret kursimet e realizuara, si *cash*, ashtu edhe në formën e likuiditeteve në bankë, të pretenduara si kursime të prindërve nuk janë deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në çdolloj forme.

1.61 Në rrethanat konstatuese dhe arsyetuar me sipër, trupi gjykues vlerëson se në kushtet që subjekti: (i) nuk e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* e në atë periodike, si dhe përgjatë hetimit kursimet e prindërve si burim; (ii) nuk i ka deklaruar kursimet e prindërve në shumën 1.7 milionë lekë as si gjendje *cash* apo në ndonjë formë tjetër (të ardhura apo dhurim) në DPV-në përkatëse; (iii) nuk provoi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave – konkludon se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me krijimin e pasurisë depozitë bankare në shumën 35.000 euro, e përdorur për shlyerjen e këstit të parë të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

1.62 Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të barrës së provës në rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar mundësinë financiare për krijimin e depozitës në emër të bashkëshortit në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 35.000 euro, në datën 17.1.2007.

1.63 Për sa më sipër, rezultoi se subjekti nuk kishte burime financiare të ligjshme për krijimin e depozitës bankare prej 35.000 euro, shumë e cila është përdorur për shlyerjen e këstit të parë për blerjen e pasurisë apartament + garazh.

Në lidhje me pagesën *cash* nëpërmjet arkës së shoqërisë ndërtuese të shumës 25.100 euro, në datën 17.10.2008

1.64 Referuar të dhënave nga “Alpha Bank”¹⁷ rezulton se nga llogaria depozitë në lekë në emër të bashkëshortit të subjektit në datën 7.8.2007 është tërhequr *cash* shuma 1.997.700 lekë, ndërsa në datën 8.8.2007 është depozituar në llogarinë depozitë në euro shuma 20.000 euro deri në datën 1.10.2007, ku është tërhequr *cash* shuma 19.990 euro.

1.65 Në deklarinimin e interesave privatë periodikë për vitin 2007, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 19.990 euro, nga pakësimi i depozitës në “Alpha Bank” në emër të bashkëshortit.

¹⁶ Duke nënvizuar se kjo ka filluar ushtrim të kompetencave në vitin 2009, dhe nuk ka të dhëna për dëshmipërblime të përfituara nga viti 1994

¹⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.8.2022.

1.66 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit, për të vërtetuar pagesën e shumës prej 25.100 euro, ka depozituar mandatpagesën nr. ***, datë 17.10.2008.

1.67 Nga Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, u krye një analizë paraprake e treguesve financiarë për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për pagesën e shumës 25.100 euro në datën 17.10.2008, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2008 - 17.10.2008 (në këtë analizë u përfshi edhe gjendja *cash* e deklaruar në fund të vitit 2007, në shumën 19.990 euro).

1.68 Bazuar në analizën financiare rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi nga burime të deklaruara dhe të dokumentuara të ardhurash për pagesën *cash* në arkën e shoqërisë ndërtimore të shumës 25.100 euro në datën 17.10.2008.

Në lidhje me pagesën e këstit të dytë në shumën 30.000 euro, në datën 20.3.2009

1.69 Në DIPP-në e vitit 2009 (deklaratën e interesave private personi i lidhur), bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “... shlyer kësti në shumën 30.000 euro, sipas kontratës së sipërmarrjes me të ardhura nga llogaria e bashkëshortes prej 1.311.600 lekësh dhe kontrata e huas datë 17.1.2009 me A.L”.

1.70 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagesën e këtij kësti në datën 20.3.2009, në shumën 30.000 euro, nëpërmjet bankës.

1.71 Referuar dokumentacionit të përcjellë nga subjekti¹⁸, në datën 20.3.2009, është paguar shuma 30.000 euro me një depozitim *cash* në “Intesa Sanpaolo Bank”, me përshkrimin “L.M pag. për blerjen e apartamentit kësti II”.

Të ardhura nga llogaria e subjektit në vlerën 1.311.600 lekë

1.72 Në DIPP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar pakësim nga llogaria bankare dyemërore “D.G dhe Rexhina Merlika” në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 1.311.600 lekë, në datën 20.1.2009, përdorur për shlyerje të këstit të banesës sipas kontratës së sipërmarrjes.

1.73 Referuar të dhënave nga “Intesa Sanpaolo Bank” me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.7.2022, rezulton se në datën 20.1.2009 është kthyer në llogarinë e përbashkët të subjektit me nënën e saj njëra depozitë në shumën 1.168.140 lekë dhe në të njëjtën ditë është tërhequr *cash* shuma 1.311.600 lekë me përshkrimin “tërhequr *cash* Rexhina Merlika, pagesë këst shtëpie”.

1.74 Kjo shumë e ka prejardhjen nga vlera 2.100.000 lekë, e depozituar në këtë llogari në datën 17.1.2007, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 62.58 m², Lagjja nr. ***, Laç.

Hua me kontratë datë 17.1.2009 me shtetasin A.L

1.75 Me kontratë huaje datë 17.1.2009, shtetasi A. L i ka dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. L. M, shumën 20.000 euro, me afat 3-vjeçar.

1.76 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, në lidhje me huan e marrë nga shtetasi A.L, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se huaja në shumën 20.000 euro, marrë me kontratë në datën 17.1.2009, ka pasur si qëllim shlyerjen e detyrimit sipas kontratës së sipërmarrjes, me afat 3-vjeçar, e cila është likuiduar në datën 26.12.2012.

Mbi burimin e të ardhurave të huadhënësit

¹⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. ****.

1.77 Në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit A.L, subjekti ka deklaruar se ka pasur burime financiare të mjaftueshme për dhënien e huas, duke përfshirë të ardhura nga biznesi privat, si familje bujqësore, depozita bankare etj.¹⁹.

1.78 Referuar ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “person fizik”, me NIPT ***, rezulton se person fizik “****” është regjistruar në datën 10.12.2008, me veprimtari në fushën e përpunimit të ullirit dhe prodhim vaji në Fushë-Krujë. Në datën 11.2.2009, ky aktivitet është çregjistruar.

1.79 Në bazë të të dhënave të depozituara nga subjekti për shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar me NIPT ***, rezulton se kjo shoqëri është krijuar në datën 21.8.1999 me aktivitet “tregti artikuj të ndryshëm”, me ortakë fillestarë shtetasit A.H, A.P dhe S.L. Z. A.L është shtuar si ortak në këtë shoqëri me vendim të asamblesë së ortakëve datë 7.12.2015, nëpërmjet të transferimit të 100% të kuotave të shtetasit S.L.

1.80 Sa më sipër deri në datën e dhënies së huas shtetasi A.L nuk ka qenë ortak dhe/ose administrator i kësaj shoqërie.

1.81 Komisioni i është drejtuar DRT-së Durrës në lidhje me të ardhura të deklaruara, realizuara nga huadhënësi deri në kohën e dhënies së huas.

1.82 DRT Durrës, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.9.2022, informon se shtetasi A.L rezulton i regjistruar si person fizik me NIPT ***, në datën 10.12.2008. Ky tatimpagues rezulton me status “çregjistruar”, që nga data 11.2.2009, gjithashtu referuar arshivës së institucionit nuk disponohet informacion për qarkullim, fitim apo pagesë të detyrimeve tatimore.

1.83 DRSSH Durrës, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.9.2022, ka informuar se z. A.L ka qenë i punësuar pranë subjektit tregtar “N. H.”, regjistruar me NIPT ***, për periudhën nga viti 2007 e në vijim. Të ardhurat e realizuara për të cilat janë derdhur kontributet për periudhën 2007 - janar 2009, rezultojnë në vlerë 383.000 lekë.

1.84 Nga subjekti në përgjigje të pyetësorit janë depozituar edhe lëvizje të llogarisë së përbashkët në emër të D ose A.L pranë BKT-së, konkretisht:

- Lëvizje në llogarinë depozitë në USD, nr. ***, në të cilën në datën 15.4.2004 është depozituar *cash* shuma 4.000 USD, e cila ka kaluar në depozitë me afat periodikisht, ndërsa në datën 12.9.2005 është depozituar *cash* edhe shuma 5.000 USD. Në datën 11.7.2006 është tërhequr *cash* shuma 9.069 USD nga znj. D. L.

- Lëvizje në llogarinë depozitë në lekë, në të cilën në datën 12.9.2005 është depozituar *cash* nga shtetasi A.L shuma 1.000.000 lekë, shumë e cila ka kaluar në depozitë me afat, në datën 27.2.2006 është depozituar *cash* edhe shuma 1.000.000 lekë , ndërsa në datën 3.7.2006 është depozituar edhe shuma 1.650.000 lekë, pra deri në datën 4.7.2006 në këtë llogari ka qenë e depozituar shuma 3.650.000 lekë, e cila është tërhequr *cash* me tri këste deri në datën 4.6.2007.

1.85 Gjithashtu, janë depozituar edhe disa të dhëna në lidhje me depozita në emër të znj. D.L në “Union Bank”.

1.86 Sa më sipër, z. A.L (L) ka pasur lëvizje në vlera monetare në llogaritë e tij bankare, përpara datës së dhënies së huas (vetëm në BKT në vitin 2007 janë tërhequr nga llogaritë e sipërpërmendura në BKT shumat 3.650.000 lekë dhe 9.069 USD, të cilat rezultojnë më të larta

¹⁹ Subjekti ka bashkëlidhur: (i) ekstrakt QKB, person fizik me emër tregtar “****”, NIPT ***, datë regjistrimi 10.12.2008, objekti i veprimtarisë “përpunim i ullirit dhe prodhimit të vajit, Fushë Krujë; (ii) ekstrakt QKB, person juridik, “****” sh.p.k. NIPT ****, datë regjistrimi 21.8.1999, ortak në shoqëri (administrator); (iii) pasuri e paluajtshme në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., truell me sip.1900 m², ndërtesë 200 m², adresa *** Tiranë, certifikatë vërtetim pasurie datë 6.2.2015; (iv) pasuri e paluajtshme regj. hipotekor nr. ***, datë 18.4.2017, regjistrim fillestar në vitin 1992, shtëpi banimi dykatëshe, kati përdhe 164 m², kat i dytë 170 m² dhe truell 200 m² në Fushë-Krujë; (v) depozita nga të ardhurat e bashkëshortes D.L në “Union Bank”.

se shuma e dhënë hua në janar të vitit 2009), por nuk është paraqitur dokumentacion për burimin e plotë të të ardhurave për krijimin e tyre.

1.87 Nga Komisioni është vlerësuar se kjo hua nuk është dokumentuar me dokumentacion ligjor të kohës, si dhe nuk u provua burimi i të ardhurave të huadhënësit për dhënien e saj, për këtë të mos përfshihet në analizën financiare paraprake. Gjithashtu, në këtë analizë nuk janë përfshirë edhe kështet e deklaruara për shlyerjen e kësaj huaje.

1.88 Nga Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, u krye një analizë paraprake e treguesve financiarë për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për pagesën e shumës 30.000 euro në datën 20.3.2009, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2009 - 20.3.2009, për sa duket se kishin pamundësi financiare në vlerë -2,497,862 lekë.

Në lidhje me deklarinimin e shlyerjes së huas nga shtetasi A. L.

1.89 Në DPV-në e vitit 2009, në deklaratën e interesave private, personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) ka deklaruar detyrim të palikuiduar nga kontrata e huas e datës 17.1.2009, shumën 10.000 euro (shuma e shlyer 10.000 euro).

1.90 Në DPV-në e vitit 2010, në deklaratën e interesave private, personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) ka deklaruar *shlyer huan e marrë nga huadhënësi A.L në shumën 10.000 euro* dhe në detyrime financiare nuk deklaroi detyrim të mbetur ndaj shtetasit A. L.

1.91 Në DPV-në e vitit 2011, në deklaratën e interesave private, personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit), në detyrime financiare ka deklaruar *mbartur detyrime për P. H në shumën 5.000.000 lekë dhe A. L në shumën 10.000 euro*.

1.92 Në DPV-në e vitit 2012, në deklaratën e interesave private, personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) ka deklaruar *shlyer detyrimi nga kontrata e huas, datë 17.1.2009, në shumën 10.000 euro*.

1.93 Referuar deklaratës noteriale të datës 25.1.2017, z. A.L ka deklaruar se kësti i parë në shumën 10.000 euro është shlyer në fund të vitit 2010, ndërsa kësti i dytë në shumën 10.000 euro është likuiduar në datën 26.12.2012.

1.94 Në këtë deklarinim, si subjekti ashtu edhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar burim të të ardhurave për shlyerjen e një pjese të huas.

1.95 Sa më sipër, ka mospërputhje në lidhje me kohën e shlyerjes së këstit të parë dhe të dytë të huas ndaj shtetasit A.L.

1.96 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se huaja ndaj shtetasit A. L. është shlyer nga kursimet *cash* të deklaruara.

1.97 Në përgjigje të pyetësorit nr. ****, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, ndër të tjera, se: *“...shuma prej 10.000 euro është paguar në vitin 2010, me gjendjen cash që ka mbetur nga viti 2009 dhe të ardhurat e tremujorit të parë. Nga personi i lidhur është një pasaktësi në deklarinim duke referuar në vitin e plotësimit të deklaratës 20.3.2010, duke reflektuar detyrime të paguara në vitin 2010.*

*Në DPV-në e vitit 2010 është deklaruar shlyerja e huas së mësipërme 10.000 euro, por nga personi i lidhur nuk është pasqyruar detyrimi i mbetur. Kjo pasaktësi vërtetohet në DPV-në e vitit 2011, sipas së cilës në pjesën e detyrimeve është shënuar detyrimi i mbartur për A. L 10.000 euro, shumë e cila është likuiduar në fund të vitit 2012. Njëkohësisht edhe në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr.*** kol, datë 25.1.2017, huadhënësi ka deklaruar se kësti i parë i është paguar në fund të vitit 2010 dhe kësti i dytë për shlyerjen përfundimtare të huas është kthyer në datën 26.12.2012”.*

1.98 Në bazë të DIPP-së së vitit 2010, subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*.

1.99 Duke nisur nga fakti që Komisioni vendosi mospërfshirjen në analizën financiare të huas nga shtetasi A. L., për rrjedhojë është vlerësuar që të mos pasqyrohet edhe shlyerja e kësaj huaje, për të cilën burimi i të ardhurave është deklaruar nga subjekti se ishin kursimet *cash* sa më sipër.

1.100 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit²⁰.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

1.101 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegime të rezultateve të hetimit²¹, ka pretenduar se në lidhje me pagesën e këstit të dytë në shumën 30.000 euro, datë 20.3.2009, burim kanë qenë shuma e tërhequr nga llogaria e nënës D.G (llogari në “Intesa Sanpaolo Bank”) në shumën 1.311.600 lekë, datë 20.1.2009, si dhe sipas kontratës së huas datë 17.1.2009, marrë hua nga shtetasi A.L shuma 20.000 euro.

1.102 Në lidhje me burimin e të ardhurave për huadhënësin A.S.L rezultoi se personi i lidhur A.S.L dhe pjesëtarë të familjes së tij D.L dhe S.L kanë gjeneruar të ardhura nga aktiviteti privat si familje bujqësore, pasi kanë përfituar tokë sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”. Nga ana tjetër, personi i lidhur ka qenë i punësuar tek N. H. p. f., nga viti 2000 e në vazhdim deri në datën 24.2.2023. Bashkëshortja e tij ka qenë e punësuar në BKT, dega Fushë - Krujë në periudhën 15.4.2004 – 12.7.2006 dhe në “Union Bank” në periudhën 1.1.2007 – 24.2.2023. Babai i personit të lidhur S.L ka qenë kryetari i familjes bujqësore, i cili ka administruar dhe ka realizuar të ardhura së bashku me pjesëtarët e tjerë, duke kultivuar këtë tokë bujqësore që prej vitit 1992 e në vijim rreth 1.500.000 – 2.500.000 lekë. Nga nxjerrja e llogarisë datë 17.2.2023, në emër të S ose D.L kanë tërhequr në datën 24.9.2007, shumën prej 3.329.819 lekësh, para dhënies së huas, shume e cila ishte mbajtur *cash* dhe prej saj është konvertuar shuma e huas prej 20.000 euro. Ky veprim bankar është kryer nga bashkëshortja D.L në llogarinë e përbashkët me babain e personit të lidhur.

1.103 Për sa i përket shlyerjeve të kësaj huaje dhe deklarimit të tyre, subjekti sqaron se ka qenë pasaktësi e personit të lidhur në deklarimin e tij në DPV-në e vitit 2009, pasi kësti i parë prej 50% të vlerës është paguar në vitin 2010, me gjendjen *cash* që ka mbetur në vitin 2009 dhe të ardhurat e tremujorit të parë. Për të provuar deklaratat e saj subjekti ka paraqitur si prova dokumentacion shkresor²².

Vlerësimi i Komisionit

1.104 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe në shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet dhe provat e depozituara në seancën dëgjimore të zhvilluar me subjektin e rivlerësimit, arsyetoi se:

1.105 Në analizë të dokumentacionit, me anë të të cilit është konfirmuar marrëdhënia e huas, qoftë nga huadhënësi, ashtu edhe nga huamarrësi (personi i lidhur bashkëshorti i subjektit), në

²⁰ Për më shumë, referojuni dosjes së procesit të rivlerësimit.

²¹ Shihni përgjigjet e dhëna nga subjekti mbi rezultatet e hetimit

²² Vërtetim datë 24.2.2023, lëshuar nga punëdhënësi N.H P.F., me të cilin provohet se: A.S.L është punonjës pranë firmës “****” P.F. nga viti 2000 e në vazhdim, i paguhen rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; certifikatë regjistrimi prone me nr. pasurie ***, kodi unik ***, z. k. ***, arë sip. 22050 m², me adresë pasurie Tiranë, datë lëshimi 23.2.2022; kartela e pasurisë së paluajtshme kodi unik ***, z. k. ***, lloji i pasurisë arë, nr. pasurie *** dhe sip. 22050 m²; fragment i hartës kadastrale, z. k. ***, kodi unik ***, nr. pasurie ***, index i hartës; certifikatë familjare nr. ***, datë 22.2.2023, gjendje date 1.8.1991. Nxjerrje llogarie datë 17.2.2023 të llogarisë nr. *** ALL, në emër të S ose D.L, datë 24.9.2000, faqe ***; nxjerrje llogarie datë 15.6.2021 të llogarisë *** ** USD, në emër të D ose A.L, për periudhën 15.4.2004 – 12.7.2006, f. ****; nxjerrje llogarie datë 15.6.2021 të llogarisë nr. *** ** ALL, në emër të D ose A. L, për periudhën 12.9.2005 – 5.1.2007, f. ***; nxjerrje llogarie datë 24.2.2023, nr. *** ALL, në emër të znj. D.L, për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2010, f. ***.

zbatim të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së pika 19, detyrohen të paraqesin dokumentacionin justifikues ligjor, referuar burimit të krijimit të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

1.106 Në rezultatet e hetimit nga Komisioni janë analizuar të dhënat e paraqitura nga subjekti dhe jo vetëm, në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit A. L., për dhënien hua të shumës 20.000 euro, me kontratë në datën 17.1.2009, nga ku rezultoi që ndonëse ky shtetas ka pasur lëvizje në vlera monetare në llogaritë e tij bankare, përpara datës së dhënies së huas (tërhequr në vitin 2007 nga llogaritë në BKT), të cilat rezultojnë më të larta se shuma e dhënë hua në janar të vitit 2009, nuk është arritur të provohet si burim i krijimit, ashtu edhe destinacioni i tyre (për një periudhë afro 2-vjeçare, nisur edhe nga fakti që huaja është dhënë në janar të vitit 2009).

1.107 Në shpjegimet dhe dokumentacionin e dërguar pas rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se shtetasi A. L. ka qenë i punësuar në subjektin tregtar N. H. (person fizik) për periudhën nga viti 2000 e në vazhdim, por ky fakt nuk është konfirmuar nga DRSSH-ja Durrës, ku me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.9.2022, ka informuar Komisionin se z. A. L. ka qenë i punësuar pranë subjektit tregtar “N. H.”, regjistruar pranë organeve tatimore, për periudhën nga viti 2007 e në vijim. Të ardhurat e realizuara, për të cilat janë derdhur kontributet për periudhën 2007 - janar 2009, rezultojnë në vlerën 383.000 lekë.

1.108 Ndërsa për sa i përket përfshirjes së babait të huadhënësit dhe të ardhurave të administruara dhe të realizuara prej tij së bashku me pjesëtarë të tjerë të familjes nga aktiviteti si familje bujqësore që prej vitit 1992 e në vijim në vlerën rreth 1.500.000 lekë – 2.500.000 lekë, Komisioni vlerëson se, ndonëse një burim i ri për huadhënësin nuk janë arritur të provohen/dokumentohen, shumat e deklaruara të përfituara nga aktiviteti privat si familje bujqësore.

1.109 Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve mbi barrën e provës të dërguar me rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit A. L., për shumën 20.000 euro, dhënë hua bashkëshortit të subjektit në janar të vitit 2009.

1.110 Për sa më sipër, rezultoi se personi tjetër i lidhur me cilësinë e huadhënësit A. L. nuk kishte burime financiare të ligjshme për dhënien hua të shumës 20.000 euro, shumë e cila është deklaruar se është përdorur për pagesën e këstit të dytë për blerjen e pasurisë apartament + garazh.

Në lidhje me pagesën e këstit të tretë në shumën 30.000 euro në datën 2.7.2010

1.111 Në DIPP-në e vitit 2010 (deklaratën e interesave private personi i lidhur), bashkëshorti i subjektit ka deklaruar *shlyer kësti i blerjes së apartamentit në datën 2.7.2010, në shumën 30.000 euro, te firma “***” me të ardhurat e marra hua nga huadhënësi P.H.*

1.112 Ndërsa në detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, personi i lidhur në këtë vit deklaroi: *“Kontrata e huas datë 2.7.2010 me kredidhënës P.H, detyrim i mbetur 5.000.000 lekë”.*

1.113 Në DIPP-në e vitit 2015 (deklaratën e interesave private personi i lidhur), bashkëshorti i subjektit në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” ka deklaruar kontratën e huas datë 20.7.2010, depozituar në deklaratimet e mëparshme (shlyer gjatë vitit shuma 1.500.000 lekë, detyrim i mbetur 3.500.000 lekë).

1.114 Në deklaratën *Vetting* bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në detyrime financiare, ndër të tjera, kontratë huaje, datë 2.7.2010, në shumën 5.000.000 lekë, me qëllim shlyerje të detyrimit sipas kontratës së sipërmarrjes. Likuiduar pjesërisht në shumën 1.500.000 lekë, në datën 31.12.2015 dhe detyrim i mbetur shuma 3.500.000 lekë. Subjekti ka depozituar ndër të tjera edhe kontratë huaje datë 2.7.2010, me objekt dhënien e shumës 5.000.000 lekë nga huadhënësi P.H.

1.115 Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti me përgjigje të pyetësorit nr. ***, rezulton se në datën 2.7.2010 është paguar me depozitim *cash* shuma 30.000 euro në “Intesa Sanpaolo Bank”, me përshkrimin “L.M këst për blerje apartamenti”.

1.116 Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 10.4.2017, shtetasi P.H deklaroi si burim për huan e dhënë në shumën 5.000.000 lekë (me kontratën e huas nr. ***, datë 2.7.2010, përpiluar nga avokat E.D): (i) nga biznesi që ka ushtruar në Shqipëri; (ii) nga qiratë; (iii) nga puna si emigrant i ligjshëm në SHBA, ndër vite.

1.117 Gjithashtu, ai deklaroi se nga shuma e dhënë hua, është kthyer nga huamarrësi shuma 1.500.000 lekë në datën 31.12.2015. Diferenca tjetër mbetet për t’u paguar në kohët në vijim.

1.118 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe se të ardhurat ndër vite janë krijuar pasi ka ushtruar aktivitetin e biznesit si fotograf në Fushë - Krujë, nga data 6.1.1993, person fizik me NIPT ***.

1.119 Në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit P. H, subjekti ka deklaruar se *shtetasi në fjalë ka lindur në Krujë dhe është shtetas amerikan me banim në NY, SHBA dhe burim i huas janë të ardhurat nga puna në Shqipëri, pasi ka ushtruar aktivitetin si fotograf në Fushë - Krujë, para viteve 1992 – 2004 si person fizik me NIPT ***, e më pas në emigracion në punë të ndryshme si hidraulik, etj., të ardhura nga qiratë e pasurive të paluajtshme (dyqane në Fushë-Krujë dhe apartament në Krujë), si dhe nga llogaria bankare në lek/euro pranë “Raiffeisen Bank” dhe “Credins Bank”, nga viti 2004 e në vijim²³.*

- Të ardhura nga aktiviteti

1.120 Referuar të dhënave të depozituara, në bazë të ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “person fizik” P.H, është regjistruar në datën 6.1.1993, në vend të ushtrimit të aktivitetit Fushë-Krujë.

1.121 DRT Durrës, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.9.2022, informon Komisionin se:

- Shtetasi P.H rezultoi i regjistruar në DRT Durrës, me NIPT ***, për të ushtruar aktivitet në fushën “aktivitete fotografike”, në adresë Fushë - Krujë, nga data 12.10.2006 dhe aktualisht është në statusin pasiv nga data 30.12.2012. Ky tatimpagues nuk ka deklaruar të dhëna në sistemin C@ts.

- Shtetasi P.H rezultoi i regjistruar në DRT Durrës, Agjencia Krujë me NIPT *** për të ushtruar aktivitet në “fushën e arsimit për sporte dhe argëtim”, në adresën Krujë, nga data 4.4.2003 dhe aktualisht është në statusin pasiv nga data 30.12.2012. Ky tatimpagues nuk ka deklaruar të dhëna në sistemin C@ts.

1.122 Gjithashtu, ky institucion sqaron se nga të dhënat e verifikuara në dosjen e tatimpaguesit P.Sh.H, në ish-degën e Tatim-Taksave Krujë, sot DRT Durrës, agjencia Krujë rezultoi e regjistruar me kod fiskal ***, bazuar në vendimin nr. ***, datë 6.1.1993, të gjykatës, dosje në të cilat janë të dhënat e NIPT *** dhe ***. Tatimpaguesi ka kryer aktivitet si fotograf për vitet

²³ Subjekti ka bashkëlidhur ndër të tjera : (i) ekstraktin nga QKB-ja, person fizik me NIPT ***; (ii) dokumentacionin për pasuri të paluajtshme në Fushë - Krujë dhe Krujë; (iii) kontratë qiraje datë 27.3.2004; (iv) kontratë qiraje datë 20.9.2006; (v) dokumentacion mbi llogari bankare në USD në “Credins Bank”, e hapur në datën 31.3.2004; (vi) dokumentacion mbi llogari bankare në lekë dhe USD në “Raiffeisen Bank”.

1993 - 1999, 2001, 2003 dhe 2006 sipas të dhënave në dosjen e tatimpaguesit dhe në regjistrat e ish-degës së Tatim-Taksave Krujë. Në periudhën viti 1993 – prill 2009 të dhënat e ish-degës së Tatim-Taksave Krujë kanë qenë manuale dhe jashtë sistemit informatik tatimor.

- *Të ardhura nga qiradhënia*

1.123 Subjekti ka depozituar edhe:

- Kontratë qiraje datë 27.3.2004, nëpërmjet së cilës shtetasi P.H ka dhënë me qira një ambient me sip. 15 m² për periudhën 1.4.2004 - 1.4.2005 kundrejt qirasë 25.000 lekë/muaj. Shuma totale prej 300.000 lekësh është paguar me lidhjen e kontratës.

- Kontratë qiraje datë 20.9.2006, nëpërmjet së cilës shtetasi P. H ka dhënë me qira objektin me sip. 15 m², për periudhën 1.10.2006 – 30.9.2008, me të drejtë përsëritjeje kundrejt qirasë 25.000 lekë/muaj. Pra, referuar kësaj kontrate shuma e të ardhurave të përfituara duket se ka qenë në vlerën 600.000 lekë deri në shtator të vitit 2008.

- Kontratë qiraje datë 10.12.2011, nëpërmjet së cilës shtetasi P.H ka dhënë me qira një ambient me sip. totale 86 m² kundrejt qirasë 50.000 lekë/muaj për një periudhë 1-vjeçare me të drejtë rizgjatjeje.

1.124 Sa më sipër, Komisioni vlerëson se të ardhurat e përfituara nga kontrata e qirasë e datës 10.12.2011, nuk mund të kenë shërbyer për dhënien e huas në datën 2.7.2010, ndërsa shuma e të ardhurave të dokumentuara nga qiraja rezulton 900.000 lekë.

1.125 Bashkia Krujë, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.9.2022, informon Komisionin se nuk disponon të dhëna në lidhje me pasuri të deklaruara të dhëna/marra me qira për aktivitet tregtar për/nga shtetasi P.Sh. H.

- *Të dhënat bankare*

1.126 Referuar dokumentacionit të dërguar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. ***, rezulton se:

- Në datën 28.5.2010 është kaluar në llogarinë nr. ***, në USD, në “Raiffeisen Bank”, në emër të z. H shuma 60.000 USD; në datën 16.6.2010, shtetasi P.H ka transferuar me këmbim shumën 6.672.000 lekë në llogarinë nr. ***, në emër të tij në lekë në “Raiffeisen Bank”; në datën 21.6.2010 kjo shumë është mbyllur në depozitë me afat deri në datën 21.6.2011.

1.127 Sa më sipër, kjo shumë tregon për posedim të likuditeteve nga z. P. H, por nuk mund të ketë shërbyer për dhënien e huas në datën 2.7.2010, pasi në kohën e dhënies së huas kanë qenë gjendje në llogarinë bankare.

1.128 Në bazë të dokumentacionit të dërguar dokumentohet se në “Credins Bank” shtetasi P.H ka pasur të depozituar për periudhën 31.3.2004 - 31.3.2005, shumën 21.000 USD.

1.129 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar, ndër të tjera, se sipas huadhënësit ka pasur të ardhura cash rreth 2.600.000 lekë dhe për të plotësuar pjesën e mbetur prej 2.400.000 lekësh dhe u ka kërkuar dy nipërve të bashkëshortes së tij, shtetasve S.S dhe A.S, që të mundësojnë plotësimin e shumës. Nga ana e tyre janë tërhequr në “Union Bank” në datën 2.7.2010, shuma 1.192.792 lekë nga shtetasi S.S dhe mandat tërheqjeje bankare me nr. ref. ***, në shumën 1.251.004 lekë nga shtetasi A.S.

1.130 Për këtë, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale datë 30.11.2022 të deklaruesve S.S dhe A. S.

1.131 Nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 30.11.2022, shtetasit S dhe A.S kanë deklaruar se nga halla e tyre, shtetasja L.H (S), bashkëshortja e z. P. H, u është dhënë shuma 24.000 USD, të cilat kanë qenë kursime të saj nga puna dhe nga ana e tyre janë depozituar në “Union Bank” në llogarinë në emër të A dhe S.S.

Me kërkesë të hallës L.H dhe bashkëshortit të saj P. H , i kemi tërhequr kursimet e saj . pasi ato do tia jepnin hua shokut të ngushtë L.M ...Me datë 02.07.2010 kemi tërhequr cash përkatësisht , S. S shumën 1.192.792 lekë dhe A.S shumën 1.251.004 lekë

1.132 Në lidhje me të ardhura nga emigracioni në SHBA, të z. P. H dhe bashkëshortes së tij, subjekti ka depozituar deklaratat e tatimit mbi të ardhurat në SHBA për vitin 2008 në shumën bruto 23.226 USD, në vitin 2009 në shumën 29.797 USD dhe në vitin 2010 në shumën 38.632 USD, pra, në total për periudhën 2008 – 2010, shuma e të ardhurave të dokumentuara në SHBA për personin tjetër të lidhur dhe bashkëshorten e tij rezultojnë në vlerën bruto 91.655 USD.

1.133 Nga Komisioni është vlerësuar se kjo hua nuk është dokumentuar me dokumentacion ligjor të kohës, si dhe nuk u provua burimi i të ardhurave të huadhënësit për dhënien e saj. Subjekti duket se ka ndryshuar deklaram lidhur me burimin e kësaj huadhënieje, duke përfshirë edhe shtetasit S. S. dhe A. S. Subjekti nuk ka provuar dhe dokumentuar mënyrën e dhënies së kësaj huaje nga shtetasi P. H. Për këto arsye, Komisioni vendosi të mos përfshihet kjo hua në analizën financiare paraprake. Gjithashtu, në këtë analizë nuk janë përfshirë edhe kështet e deklaruara për shlyerjen e kësaj huaje.

1.134 Nga Komisioni u krye një analizë paraprake financiare për pagesën e shumës 30.000 euro në datën 2.7.2010, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2010 – 2.7.2010²⁴ (duke mos përfshirë shumën e dekluar marrë hua nga P. Hoxha, si dhe shlyerjen e dekluar të kështit të huas nga A. L), për sa duket se kishin pamundësi financiare në vlerën -3.933.792 lekë.

1.135 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit²⁵.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

1.136 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegime të rezultateve të hetimit²⁶, në lidhje me pagesën e kështit të tretë në shumën 30.000 euro, datë 2.7.2010, burim ka qenë shuma e marrë hua sipas kontratës së huas nr. ***, datë 2.7.2010, me huadhënës P.Sh.H, në shumën 5.000.000 lekë. Ky shtetas ka punuar në Shqipëri qysh prej vitit 1982, si fotograf në qytetin Fushë - Krujë deri fillim të vitit 2004.

1.137 Nga viti 2004 personi i lidhur P. H. ka emigruar së bashku me bashkëshorten e tij L. H. në SHBA. Ai, së bashku me bashkëshorten e tij, kanë punuar dhe kanë qenë të siguar nga punëdhënësi, kjo sipas deklaratës federale të tatimit mbi të ardhurat individuale viti 2005 në shumën 8.900 USD, viti 2006 në shumën 5.998 USD dhe në vitin 2007 kanë deklaruar të ardhura 9.466 USD.

1.138 Nga ana e huadhënësit P. Hoxha është dhënë shuma 5.000.000 lekë, sipas kontratës së huas datë 2.7.2010, ku pjesa prej 2.556.204 lekësh ka qenë gjendje cash dhe pjesën tjetër e ka plotësuar duke i tërhequr nga kursimet e bashkëshortes L. H, të cilat ishin depozituar në dy llogari në emër të dy nipave të saj S.S dhe A.S, pranë “Union Bank” në Fushë - Krujë (tërhequr

²⁴ Në këtë analizë nuk janë përfshirë gjendjet cash të akumuluar deri në datën 31.12.2009, nga deklaramet e subjektit dhe personit të lidhur.

²⁵ Për më shumë, referojuni dosjes së procesit të rivlerësimit.

²⁶ Shihni përgjigjet e dhëna nga subjekti mbi rezultatet e hetimit.

sipas dy mandateve bankare datë 2.7.2010). Për të provuar deklaratat e saj subjekti ka paraqitur si prova dokumentacion shkresor²⁷.

Vlerësimi i Komisionit

1.139 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe në shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet dhe provat e depozituara në seancën dëgjimore të zhvilluar me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

1.140 Në analizë të dokumentacionit, me anë të të cilit është konfirmuar marrëdhënia e huas, qoftë nga huadhënësi, ashtu edhe nga huamarrësi (personi i lidhur bashkëshorti i subjektit), në zbatim të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së pika 19, detyrohen të paraqesin dokumentacionin justifikues ligjor, referuar burimit të krijimit të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

1.141 Në rezultatet e hetimit nga Komisioni janë analizuar të dhënat e paraqitura nga subjekti dhe jo vetëm, në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit P. H., për dhënien hua të shumës prej 5.000.000 lekësh, me kontratë në datën 2.7.2010.

1.142 Pas rezultateve të hetimit subjekti ka depozituar dokumentacion (deklaratat e tatimit mbi të ardhurat në SHBA) në lidhje me të ardhurat e huadhënësit dhe bashkëshortes së tij, të përfituara në SHBA për periudhën 2005 – 2007, të cilat rezultojnë në vlerën 24.364 USD.

1.143 Duke iu referuar të dhënave për shpenzimet e jetesës për familjen (2 persona) sipas standardit në SHBA²⁸ (pa përfshirë shpenzime qiraje) për periudhën 2005 – 2007, në vlerën 39.462 USD²⁹, Komisioni konstaton se huadhënësi dhe bashkëshortja e tij nuk mund të kishin mundësi kursimi për këtë periudhë, pasi shpenzimet rezultojnë më të larta se të ardhurat e dokumentuara.

1.144 Lidhur me burimet e tjera të pretenduara të huadhënësit, trupi gjykues vlerëson se ato mbeten në nivel deklarativ, pasi subjekti nuk arriti të dokumentojë plotësisht burimin e deklaruar të të ardhurave dhe mundësitë financiare të huadhënësit për shumën e dhënë hua.

1.145 Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të barrës së provës në rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit P. H., për shumën 5.000.000 lekë, dhënë hua bashkëshortit të subjektit me kontratë në datën 2.7.2010.

1.146 Për sa më sipër, rezultoi se personi tjetër i lidhur me cilësinë e huadhënësit P. H. nuk kishte burime financiare të ligjshme për dhënien hua të shumës 5.000.000 lekë, shumë e cila

²⁷ Përmbledhje e taksave dhe udhëzime për paraqitjen e Deklaratës Federale të Tatimit mbi të Ardhurat Individuale, viti 2005, në shumën 8.900 USD; përmbledhje e taksave dhe udhëzime për paraqitjen e Deklaratës Federale të Tatimit mbi të Ardhurat Individuale, viti 2006, në shumën 5.998 USD; përmbledhje e taksave dhe udhëzime për paraqitjen e Deklaratës Federale të Tatimit mbi të Ardhurat Individuale, viti 2007, në shumën 9.466 USD; certifikatë familjare nr. ***, datë 24.2.2023; certifikatë familjare nr. ***, datë 24.2.2023; certifikatë familjare nr. ***, datë 24.2.2023; deklarate noteriale nr. *** rep., nr. *** ***, kol., datë 16.9.2022; deklaratë (me shkresë të thjeshtë) datë 31.12.2015 për shlyerje të huas ne shumen prej 1.500.000 leke ne emër të P.Sh. H; depozitim ne Llogari date 31.10.2019 për shlyerje të huas datë 2.7.2010 në shumën 1.000.000 lekë në emër të P.Sh.H; depozitim në llogari (transferte bankare) datë 14.12.2020, në shumën 1.000.000 lekë për shlyerje të huas datë 2.7.2010, në emër të P.Sh. H; depozitim ne Llogari (transferte bankare) date 17.12.2021 ne shumen prej 1.500.000 lekë për shlyerje të huas datë 2.7.2010 në emër të P. Sh. H. certifikatë vdekjeje nr. ****, datë 29.3.2016, faqe ***; vërtetim dhe verifikim i dokumentacionit me postë elektronike të ardhur në adresën *email* ***@yahoo.com nga dërguesi ***@hotmail.com, datë 3.3.2023, ora 15:15, “Deklaratë personale me shkrim dore nga P.H, i nënshkruar datë 2.2.2023 (bashkëngjitur).

²⁸ <https://www.census.gov/topics/income-poverty/poverty/guidance/poverty-footnotes/cps-historic-footnotes.html>

²⁹ Viti 2005, në vlerën 12.755 USD; viti 2006, në vlerën 13.167 USD; dhe viti 2007, në vlerën 13.540 USD.

është deklaruar se është përdorur për pagesën e kështit të tretë për blerjen e pasurisë apartament + garazh.

Në lidhje me pagesën e kësteve në vitin 2011

1.147 Në DIPP-në e vitit 2011 (deklaratën e interesave private personi i lidhur), bashkëshorti i subjektit ka deklaruar *shlyer kësti i fundit i blerjes së apartamentit në datën 30.6.2011, në shumën 25.391 euro, tek firma “****” sh.p.k.*, pa deklaruar burim të të ardhurave për këtë pagesë.

1.148 Në përgjigje të pyetësorit subjekti ka deklaruar se në datën 7.1.2011 është shlyer nëpërmjet “Intesa Sanpaolo Bank” shuma 13.000 euro, ndërsa shuma 12.391 euro është shlyer *cash* në arkën e shoqërisë duke depozituar edhe mandatpagesën nr. ***, datë 30.6.2011, të shoqërisë “****” sh.pk.

1.149 Në pyetësin standard subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë huaje datë 1.3.2011, në shumën 15.000 euro, pa afat, për likuidim të kontratës së sipërmarrjes.

1.150 Me kontratë huaje datë 1.3.2011, shtetasi P.Sh i ka dhënë hua pa afat shumën 15.000 euro, bashkëshortit të subjektit.

1.151 Me deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.1.2017, z. Sh ka deklaruar se në zbatim të kontratës së huas të datës 1.3.2011, nga kursimet e tij ndër vite, si dhe nga depozita e tij në euro, pranë “ProCredit Bank” i ka dhënë huamarrësit L.M shumën 15.000 euro.

1.152 Në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit P.Sh, subjekti, në pyetësin standard ka deklaruar: “kursime nga puna në hotel “****” sh.p.k.”, depozita në “ProCredit Bank”.

1.153 Edhe në pyetësin nr. ***, subjekti ka deklaruar se huadhënësi ka pasur burime financiare të mjaftueshme për dhënien e huas së cituar, të cilat janë kursime nga puna ndër vite, të ardhura që i ka pasur *cash* apo në depozita në “Credins Bank”. Duke depozituar ndër të tjera edhe kontratë depozite bankare datë 19.3.2015, me BKT-në, për depozitim me afat të shumës 8.000 euro për periudhën 20.3.2015 – 18.3.2016. Gjithashtu, janë depozituar të dhëna nga transferim të drejta pronësie për pasuri të paluajtshme në vitin 2015, si dhe mandatpagesë për pagesë tatim për kalim prone datë 12.5.2015.

1.154 Sa më sipër, dokumentacioni i përcjellë nuk arrin të dokumentojë burimin e të ardhurave të këtij huadhënësi për huan e dhënë në vitin 2011, pasi i përket një periudhe kohore pas dhënies së huas.

1.155 Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.9.2022, ka informuar se z. P.Sh ka qenë i punësuar tek shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ****, si nëpunës dhe janë dërguar të dhëna në lidhje me pagën mbi të cilën është derdhur kontribut për periudhën 2012 – 2016.

1.156 Për vitin 2012 janë deklaruar të ardhura në vlerën 560.000 lekë (për të cilat janë derdhur kontribute). Për sa i përket periudhës deri në vitin 2011, informojnë se kjo shoqëri i ka derdhur kontributet në Tiranë te VIP-at.

1.157 Drejtoria Qendrore e Arkivit Tiranë, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.11.2022, vërteton se paga mbi të cilën paguhen kontributet për periudhën 1.1.2011 - 31.12.2011, rezulton në vlerën 360.000 lekë.

1.158 Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë arritur të dokumentojnë burimin e të ardhurave të personit tjetër të lidhur (huadhënësit), z. P. Sh, për huan e deklaruar dhënë bashkëshortit të subjektit në shumën 15.000 euro, me kontratë datë 1.3.2011, e cila ka shërbyer si burim për pagesën e kështit të apartamentit dhe garazhit tek shoqëria ndërtuese në vitin 2011.

1.159 Kjo hua nuk është pasqyruar në analizën paraprake të treguesve financiarë.

1.160 Nisur nga fakti që në DIPP-në e vitit 2011 subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të pasurive shtesa/pakësime, gjendje të likuditeteve *cash*, gjithashtu, edhe në sqarime të dhëna “lidhur me deklarimin e pasurisë 2003 – 2013”, pranë ILDKPKI-së³⁰, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se: “*Viti 2011 nuk rezultojnë lekë cash...*”, duket se burimi i deklaruar nga subjekti (kontratë huaje datë 1.3.2011), për pagesën e shumës 25.391 euro deri në datën 30.6.2011, ka qenë i pamjaftueshëm.

1.161 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektin i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit³¹.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

1.162 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegime të rezultateve të hetimit³², në lidhje me gjetjet për personin e lidhur P. Sh paraqet prova të tjera shtesë që provojnë se ai dhe familja e tij kanë pasur burime të ardhurash. Huadhënësi P.Sh ka pasur mundësinë e kursimit të të ardhurave, kjo e provuar në llogaritë bankare në “ProCredit Bank” në lekë – viti 2007, në euro – viti 2008 dhe në USD – viti 2009. Një argument më shumë për të treguar se ka pasur burime të mjaftueshme, pasi nga ana e tij është kryer blerje pasurie të paluajtshme, në datën 11.5.2015, kundrejt shumës 70.000 euro. Për të provuar deklaratat e saj subjekti ka paraqitur si prova dokumentacion shkresor³³.

Vlerësimi i Komisionit

1.163 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe në shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat dhe provat e depozituara në seancën dëgjimore të zhvilluar me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

1.164 Në analizë të dokumentacionit, me anë të të cilit është konfirmuar marrëdhënia e huas, qoftë nga huadhënësi, ashtu edhe nga huamarrësi (personi i lidhur bashkëshorti i subjektit), në zbatim të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së pika 19, detyrohen të paraqesin dokumentacionin justifikues ligjor, referuar burimit të krijimit të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

1.165 Në rezultatet e hetimit nga Komisioni janë analizuar të dhënat e paraqitura nga subjekti dhe jo vetëm, në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit P. SH., për dhënien hua të shumës 15.000 euro, me kontratë huaje datë 1.3.2011.

1.166 Në bazë të dokumentacionit nga DRSSH-ja Tiranë, të depozituar për z. P. Sh., për periudhën janar 2006 - shkurt 2011 rezultojnë që të ardhurat e dokumentuara janë në vlerën

³⁰ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.8.2022, të ILDKPKI-së.

³¹ Për më shumë, referojuni dosjes së procesit të rivlerësimit.

³² Shihni përgjigjet e dhëna nga subjekti mbi rezultatet e hetimit.

³³ Dosjen e plotë të praktikës së përfitimt të pensionit të pleqërisë me vendimin nr. ***, datë 28.1.2016, në të cilën janë dokumente ligjore që provohet periudha e punës prej 38 vite e 2 muaj, në detyrat dhe funksionet përkatëse, si dhe pagat respektive për të gjithë periudhën e vlerësuar nga DRSSH-ja, si periudhë sigurimi; librezë pensioni nr. ***, datë 1.11.2015; librezë pensioni nr. ***, në emrin e L.H. Sh (bashkëshortja); nxjerrje llogarie “ProCredit Bank” me nr. ***, në lekë, datë 27.12.2007 19.07.2016; nxjerrje llogarie “ProCredit Bank” me nr. ***, në euro, periudha 22.1.2008 – 17.01.2014; nxjerrje llogarie “ProCredit Bank” me nr. ***, në USD, periudha 12.1.2009 – 14.01.2013; kontratë shitje pasuri e paluajtshme NT. *** rep. e nr. *** kol., datë 11.5.2015 me palë shitëse P.M e R.M dhe palë blerëse P. Sh, me çmim shitjeje 70.000 euro; bashkëlidhur kontratë shitjeje NT. *** rep. e nr. *** kol., datë 11.5.2015 është depozituar në arkë, pranë “Alpha Bank”, datë 11.5.2015 është bërë derdhja nga z. P.Sh (blerësi) në llogari të noteres Dh. Q shuma 70.000 euro; pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë për kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.5.2015, për vlerën aktuale të kontratës së shitjes në shumën 9.842.700 lekë.

1.374.588 lekë³⁴ dhe shpenzimet për jetesë vetëm për huadhënësin për këtë periudhë, sipas të dhënave nga INSTAT-i, rezultojnë në vlerën 665.257 lekë. Pra, mundësia për kursim në bazë të këtyre të dhënave duket se është në vlerën 709.331 lekë (afro 5.100 euro, pa përfshirë të ardhura të tjera, shpenzime shtesë dhe krijim pasurie).

1.167 Ndërsa, për sa i përket pretendimeve të subjektit lidhur me të ardhurat e tjera dhe mundësitë financiare të personit të lidhur si huadhënës, mbeten në kuadrin deklarativ.

1.168 Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të barrës së provës në rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit P. Sh., për shumën 15.000 euro, dhënë hua bashkëshortit të subjektit me kontratë huaje datë 1.3.2011.

1.169 Për sa më sipër, rezultoi se personi tjetër i lidhur, me cilësinë e huadhënësit P. Sh., nuk kishte burime financiare të ligjshme për dhënien hua të shumës prej 15.000 euro, shumë e cila është deklaruar se është përdorur për pagesën e këstit të fundit për blerjen e pasurisë apartament + garazh.

Në lidhje me shlyerjen e kësteve të kësaj huaje

1.170 Në DPV-në e vitit 2013, në deklaratën e interesave private, personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit), në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” ka deklaruar shlyerje të shumës 10.000 euro nga kontrata e huas e datës 1.3.2011 (detyrim i mbetur shuma 5.000 euro), ndërsa në DPV-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar shlyerje edhe të detyrimit të mbetur prej 5.000 euro.

1.171 Në pyetësin standard subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo shumë është likuiduar në dy këste, në datën 23.12.2013, shuma 10.000 euro dhe në datën 30.6.2014, shuma 5.000 euro³⁵.

1.172 Ndërsa në sqarime të dhëna “lidhur me deklarimin e pasurisë 2003 – 2013” pranë ILDKPKI-së³⁶, subjekti ka deklaruar se shuma 10.000 euro, në datën 23.12.2013 është shlyer nga likuiditetet *cash* të mbartura nga periudhat paraardhëse.

1.173 Nga Komisioni, paraprakisht, është vlerësuar që pagesat *cash* për shlyerjet e kësaj huaje të mos pasqyrohen si shpenzim në analizën paraprake të treguesve financiarë, përderisa nuk është pasqyruar në të ardhura huaje me kontratë datë 1.3.2011.

1.174 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit³⁷.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.175 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka deklaruar se³⁸: *“Kam deklaruar se viti 2013, nuk kemi të ardhura cash, pasi është shlyer detyrimi i kontratës së z. P.Sh 10.000 euro. Ky fakt përputhet edhe me deklaratimet tona në vijimësi edhe në deklaratën Vetting. Datat e shlyerjes janë përkatësisht 23.12.2013, shuma 10.000 euro dhe datë 30.6.2014 shuma 5.000 euro. Këto fakte provohen edhe me deklaratën noteriale të huadhënësit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2017, paraqitur si provë nga ana jonë së bashku me shkresat e thjeshta (deklarata datë 23.12.2013 dhe 30.6.2014) për likuidimin e dy kësteve.*

³⁴ Mungojnë të dhëna për periudhën shtator 2002 - dhjetor 2005.

³⁵ Përmeshja e detyrimit, konfirmuar me deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.1.2017.

³⁶ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.8.2022, e ILDKPKI-së.

³⁷ Për më shumë, referojuni dosjes së procesit të rivlerësimit.

³⁸ Shihni përgjigjet e dhëna nga subjekti mbi rezultatet e hetimit.

Kontratat e huas janë lidhur nga ana jonë në kushtet e lirisë kontraktuale dhe të mirëbesimit mes palëve në një marrëdhënie detyrimi. Kjo, pasi marrja e një huaje për nevoja familjare nuk është diçka që mund të realizohet me këdo, por vetëm me persona të afërt në çdo aspekt (lidhje gjaku, shoqërie apo miqësie) dhe që të njohin për korrektësinë dhe mundësinë likuiduese. Huadhënësit tanë janë persona të njohur nga ne prej vitesh dhe që me ta marrëdhëniet janë ekzistuese, gjë që konfirmohet edhe me dokumentet që kemi sjellë, si llogarite bankare etj., në vijimësi dhe na janë përgjigjur për çdo kërkesë tonën në raport me procesin. Nga ana tjetër kemi hyrë në marrëdhënie detyrimi, duke qenë tejskajshëm të kujdesshëm me persona që janë korrektë, pa asnjë precedent penal dhe pa asnjë konflikt interesi”.

Vlerësim i Komisionit

1.176 Trupi gjykues vlerësoi se përderisa subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të huas së përfutur në datën 1.3.2011, nga shtetasi P. Sh., atëherë nuk mori në analizë as mënyrën dhe burimet e shlyerjes së kësaj huaje.

Në lidhje me të ardhurat e vëllezërve nga emigracioni

1.177 Referuar DPV-ve për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhurime cash nga vëllezërit konkretisht:

- Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura nga emigracioni i vëllezërve në shumën 3.000 euro”*.

- Në DIPP-në e vitit 2006, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Gjendje cash 3.500 euro (ardhur nga emigracioni në datën 15.11.2006, në Bankën Popullore nga N.G dhe A.G)”*.

- Në deklarimin e interesave private periodike për vitin 2007, subjekti, në seksionin “ të dhëna konfidenciale” (dhurata dhe trajtime preferenciale) ka deklaruar: *“Dhuruar në valutë nga N, N dhe A.G shuma 4.000 euro”*.

- Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura nga emigracioni shuma 3.000 euro, (burimi i tyre vëllezërit)”, gjithashtu në të dhëna konfidenciale (dhurata dhe trajtime preferenciale) ka deklaruar: “Dhuruar në valutë nga N, N dhe A. G shuma 3.000 euro”*.

- Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *“shtuar të ardhura nga emigracioni në shumën 3500 euro(vëllezërit dhuruar)”*. Në të dhëna konfidenciale (dhurata dhe trajtime preferenciale) ka deklaruar: *“Dhuruar nga N, N dhe A.G shuma 3.500 euro”*.

- Në DIPP-në e vitit 2012, në deklaratën e interesave bashkëshorti ka deklaruar: *“Të ardhura në llogari nga kunati A.G në shtator 2012, në shumën 2.688 euro dhe nga E.V në shumën 970 euro”*.

1.178 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka deklaruar se: *“Të ardhurat nga emigracioni i vëllezërve, në formën e dhuratave cash nga vëllezërit N.G, A.G (Gjermani) dhe N.G (Itali) nga vitet 2005 – 2009 (deklaruar në DPV periodike vitet 2006 – 2010), në shumën totale 16.500 euro, këto shuma janë dhënë brenda vitit kalendarik, kur vëllezërit kanë ardhur për pushime në Shqipëri (për faktin se me largimin e tyre subjekti është kujdesur për nënën D.G, e cila ka qenë e vetme nga viti 1998)”*.

1.179 Sa më sipër, ka mospërputhje të shumës së deklaruar në DPV vjetore me vlerën e deklaruar në pyetësor, gjithashtu, subjekti nuk ka qartësuar kohën dhe kontributin e dhuruar nga secili prej vëllezërve të saj. Subjekti duhet të provojë dhe si janë dërguar të ardhurat ndër vite nga vëllezërit e saj (p. sh. në vitin 2005 nuk rezultojnë që vëllezërit e subjektit të kenë ardhur në Shqipëri).

1.180 Sa më në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë shpjegimet e saj në lidhje me këtë konstatim të Komisionit.

Në lidhje me burimet e të ardhurave të vëllezërve

- z. N.G vëllai i subjektit

1.181 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka deklaruar se vëllai ka punuar në punë të ndryshme në Gjermani, por që të ardhurat e krijuara në vitet 2000 – 2010, nuk gjendet dokumentacion duke depozituar shkresën e datës 16.7.2021, nga ***, nëpërmjet së cilës nuk konfirmohen bilancet për periudhën 2000 – 2010, pasi nuk ekzistojnë dokumente tej një periudhe 10-vjeçare, pra, nga data 1.1.2011 e në vazhdim.

1.182 Për sa i përket dhurimeve nga vëllai N. G, me burim të deklaruar të ardhurat nga puna në emigracion në Gjermani, subjekti ka kërkuar pamundësinë e dokumentacionit pas kalimit të një afati 10-vjeçar. Duket se ky deklaram i subjektit nuk përkon edhe me qëndrimin që ka mbajtur vetë subjekti në raport me të ardhurat e paraqitura për vëllain tjetër A. R., po në shtetin gjerman.

- z. N. G vëllai i subjektit

1.183 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka deklaruar se vëllai N.G ka punuar në shtetin italian, nga viti 2000 e në vijim dhe është paguar rregullisht, provuar me deklaramet e punëdhënësit për vitet 2005, 2007 dhe 2009, të lëshuara nga autoritetet italiane.

1.184 Subjekti ka depozituar edhe vërtetimet (deklaramet të të ardhurave nga punësimi) e datave 1.3.2006, 25.2.2008 dhe 26.2.2010.

1.185 Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti (formulari CUD), viti 2006, në lidhje me të ardhurat e realizuara nga N. G. për vitin 2005, rezultojnë në vlerë *bruto* rreth 15.632 euro; për vitin 2007, në vlerën 2.160 euro dhe në vitin 2009, në vlerën 18.243 euro.

1.186 Sa më sipër, subjekti ka arritur të dokumentojë marrëdhëniet e punësimit dhe realizim të të ardhurave të vëllait për periudhën e sipërpërmendur, por nuk është qartësuar shuma që vëllai me banim në Itali ka dhuruar.

- z. A. G vëllai i subjektit

1.187 Referuar deklarameve të interesave periodikë vjetorë, z. A.G, përveç pasqyrimin si pjesë e vëllezërve (pa ndarje shume të dhuruar) në këto deklaramet nga subjekti dhe/ose personi i lidhur është identifikuar si dhurues më vete:

- në DPV-në e vitit 2006, në dhurim të automjetit tip “****”, në datën 9.8.2006, në shumë dhurate, afro 5.000 euro;

- në DPV-në e vitit 2010, në dhurim të deklaruar të kuzhinës së gatimit me pajisjet elektroshtëpiake në shumën 16.760 euro;

- dhënien në përdorim për periudhën 2012 – 2017, të automjetit tip “****”, me targa AA ***, deklaruar nga subjekti në deklarametën *Vetting*.

1.188 Në deklarametën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhurat nga puna si emigrant në Gjermani, si burim të të ardhurave për pasuritë dhe likuiditetet e dhuruara ose në përdorim nga subjekti.

1.189 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka deklaruar se vëllai A.G ka emigruar në Gjermani që nga viti 1994 dhe ka qenë i punësuar me kohë të plotë që në momentin e hyrjes në Gjermani e në vijim.

1.190 Në lidhje me burimin e të ardhurave subjekti ka depozituar formularë të regjistrimit për sigurim për vitet 2003, 2005, 2006, 2007, 2008, 2014, 2015, 2016, 2017 etj., deklarametën noteriale nr. ***, datë 24.3.2021, të shtetasit A.G.

1.191 Me deklarametën noteriale të datës 24.3.2021, shtetasi A.G deklaron se së bashku me familjen e tij, si emigrantë të ligjshëm prej vitit 1994, ka punuar si privat nga viti 1994 në

profesionin kuzhinier, kamerier dhe i punësuar në restorant, ndërsa aktualisht ka një biznes privat në Gjermani.

1.192 Z. Gojani, në vazhdim të deklaramit të tij, shpjegon se shumat e dërguara nga ai dhe vëllezërit e tjerë për subjektin kanë pasur si qëllim ndihmën e saj dhe të nënës. Të ardhurat nga puna si privat dhe i punësuar në restorantin “****” për periudhën 15.5.2004 – 3.3.2015, kanë qenë të mjaftueshme për dhurimin e automjetit tip “****”, me kontratë dhurimi datë 9.8.2006 dhe një kuzhinë gatimi me elektroshtëpiaket në vlerën 16.760 euro (14.084 euro pas zbritjeve/kthimit). Ai deklaron se bashkë me vëllezërit nuk disponojnë pasuri të paluajtshme në Shqipëri.

1.193 Subjekti ka sqaruar, ndër të tjera, se: “...shtetasi A. G më ka bërë dhuratë kuzhinë komplet me aksesore dhe elektroshtëpiake ardhur në datën 31.5.2010 (deklaruar. importi 27.5.2010), nga vlera 16.760 euro është marrë vlera e TVSH-së në shumën 2.675 euro, ndërsa dogana është paguar nga ana jonë në shumën 472.346 lekë. Pagesa e kryer nga A.G është kryer cash, nga të ardhurat nga puna, paga, si dhe bakshishet si kamerier në restorantin e klubit të golfit ***, *** Gjermani, që prej 15.5.2004 - 3.3.2015”.

1.194 Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti (përkthyer dhe noterizuar), shuma e të ardhurave të përfituara për periudhën 2003 – 2012, rezulton në shumën 74.716 euro.

1.195 Sa më sipër, duke iu referuar një shpenzimi për konsum për një person për këto periudha në afro 35.000 euro, Komisioni vlerëson se personi tjetër i lidhur, vëllai i subjektit, nuk ka pasur të ardhura të dokumentuara për mundësinë e dhurimit cash ndër vite (rreth 20.000 euro), blerjen e automjetit tip “****” (5.000 euro), blerjen e automjetit dhënë në përdorim subjektit (rreth 14.000 euro), si dhe në blerjen e kuzhinës për subjektin në bazë të deklarameve të sipërpërmendura (16.760 euro).

• Në këtë analizë nuk janë përfshirë të ardhura të tjera, shpenzime dhe/ose pasuri të tjera të krijuara nga personi tjetër i lidhur³⁹.

1.196 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit⁴⁰.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

1.197 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegime të rezultateve të hetimit, ka bërë një ndarje të shumave të përfituara nga vëllezërit, duke deklaruar se⁴¹:

- Shuma e të ardhurave të vëllezërve nga emigracioni në fakt është 17.000 euro, sipas deklarameve në DPV-të e viteve 2005 – 2009 dhe është një lapsus shuma prej 16.500 euro, e deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. ***⁴².
- Ndërsa në DPV-në e vitit 2012 është deklaruar nga personi i lidhur se në llogarinë e biznesit të tij në “Raiffeisen Bank” ka depozituar në datën 3.8.2012 shumën 2.688 euro, ndërsa në të njëjtën llogari datë 27.12.2012 është derdhur nga shtetasja E. V. shuma 972 euro (tarifë suksesi) si avokat.
- Këto likuiditete kanë ardhur nga shtetasit N.G, N.G dhe A.G kur kanë ardhur në Shqipëri, për këtë janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS, për të provuar hyrjet-daljet nga Shqipëria.
- Në lidhje me burimet dhe të ardhurat e vëllezërve në përgjigjet e pyetësorit janë paraqitur akte shkresore që provojnë mundësinë financiare për të dërguar shumat e deklaruara në

³⁹ Përfundimi varet edhe nga shuma cash që ky shtetas i ka dërguar nënës dhe subjektit të rivlerësimit.

⁴⁰ Për më shumë, referojuni dosjes së procesit të rivlerësimit.

⁴¹ Shihni përgjigjet e dhëna nga subjekti mbi rezultatet e hetimit.

⁴² Subjekti ka deklaruar duke analizuar në çdo periudhë (2005 – 2009) shumën e dhuruar nga vëllezërit, konkretisht, në total z. N. G., shumën 6.250 euro, z. Nd. G., shumën 6.250 euro dhe z. A. G. shumën 4.500 euro.

DPV-të nga personi i lidhur N.G, i cili jeton e punon si emigrant i ligjshëm në shtetin gjermani nga viti 1992 e në vijim. Nuk është mundësuar të provojmë me shkresë të ardhurat e krijuara në vitet 2000 – 2010, pasi sipas shkresës së lëshuar nga banka V.D, datë 16.7.2021, rezulton se: “*Dokumentacioni i vërtetimit të të ardhurave nga periudha 2000 – 2010, nuk gjendet pasi ka kaluar afati 10-vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit, sipas ligjit gjerman*”. Pra, në këto kushte ndodhem në pamundësi objektive për të vënë në dispozicioni prova shkresore për këtë periudhë.

- Në lidhje me burimin e të ardhurave për personin tjetër të lidhur N.G rezulton se ka pasur burime të ardhurash me adresë fiskale më 31.12.2002 e në vijim, Provinca B, Itali.
- Në lidhje me burimin e të ardhurave për personin e lidhur A.G paraqiten akte shtesë që i përkasin viteve 2009 – 2013, ku jepen të dhëna mbi pagat e përfituara në vitet e tjera të deklaruara 2003 – 2008 dhe ato pasardhëse 2014 – 2019. Rezulton se llogaritjet e derdhjes së kontributeve nga punëdhënësi janë bazuar në pagat e plota që variojnë nga 20.573 euro, 20.584 euro, 20.594 euro, pra këto janë fakte të reja që vërtetojnë burimet e të ardhurave.

Vlerësimi i Komisionit

1.198 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe në shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet dhe provat e depozituara në seancën dëgjimore të zhvilluar me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

1.199 Në lidhje me mospërputhjet e shumës së dhuruar të deklaruar pas rezultateve, subjekti ka saktësuar shumën e cila është 17.000 euro që i përket periudhës 2005 – 2009.

1.200 Për sa i përket pretendimit që në vitin 2012 shumat janë transferuar në llogarinë e biznesit të bashkëshortit, “si të hyra në llogari dhe karakter personal për të”, duket se këto veprime nuk mbështeten në deklarinë e bërë nga personi i lidhur (bashkëshorti) si pjesë e DPV-së së vitit 2012, konkretisht, në seksionin “ndryshim i pasurive dhe burim i krijimit” në pikën nr. ***, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura në llogari “*Raiffeisen Bank*” dhuratë nga kunati A. G. (shtator) dhe E. V.(dhjetor) shumat 2.688 euro dhe 970 euro.

1.201 Në lidhje me burimin e të ardhurave nga emigracioni të vëllait N.G, subjekti ka provuar marrëdhënien e punësimit dhe qëndrimin e vëllait të saj për periudhën pas vitit 2011. Lidhur me periudhën para vitit 2011, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që justifikon burimet e të ardhurave të vëllait N. G. (pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016).

1.202 Ndërsa për shtetasit N.G dhe A.G (vëllezërit e subjektit), trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur të dokumentojë burimin e të ardhurave për shumën e deklaruar të dhuruar prej tyre, si dhe automjetin dhe kuzhinën e dhuruar nga A. G.

Në lidhje me gjendjet *cash* në banesë

1.203 Për sa i përket gjendjeve *cash*, nga Komisioni, sa më sipër, janë analizuar këto gjendje deri në datën 31.12.2006.

1.204 Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar: “Gjendje *cash* shumën 19.990 euro, tërhequr nga ‘Alpha Bank’ në datën 1.10.2007”.

1.205 Në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar të ardhura nga paga dhe biznesi i bashkëshortit shuma 2.000.000 lekë *cash*, ndërsa personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) ka deklaruar si burim për pagesën e kështit të apartamentit në datën 17.10.2008 edhe kursimet *cash* në vlerën 19.990 euro, të deklaruara gjendje në deklarinë e mëparshëm.

1.206 Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e automjetit tip “***”, datë 31.12.2009, në shumën 500.000 lekë *cash*, ndërsa personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) ka deklaruar: “*Gjendje nga të ardhura të përbashkëta 1.200.000 lekë cash*”.

1.207 Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: “*Gjendje cash në shumën 11.000 euro, nga të ardhurat e vitit 2010*”.

1.208 Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të pasurive shtesa/pakësime ose gjendje të likuiditeteve *cash*.

1.209 Për periudhën 2012 dhe 2013 subjekti nuk ka deklaruar gjendje, shtesa/pakësime të likuiditeteve *cash* referuar DPV.

1.210 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti, në ndryshim të pasurive, ka deklaruar: “*Të ardhura cash në vlerën 76.815 lekë*”.

1.211 Në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016, subjekti nuk ka deklaruar gjendje, shtesa/pakësime të likuiditeteve *cash*, referuar DPV-së.

1.212 Nga vlerat e deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur (bashkëshorti i saj) në deklaratimet, më sipër, deri në datën 31.12.2016, si kursime *cash* të krijuara në vitet përkatëse të deklaratimit (pra shtesë të likuiditeteve *cash*), shuma totale e likuiditeteve *cash* të deklaruara gjendje në banesë në datën 31.12.2016, do të rezultonte në vlerat 3.776.815 lekë dhe 11.000 euro.

	Në lekë	Në euro
Viti	Gjendje 31/12	
2003	600.000	
2004	900.000	
2005	1.650.000	
2006	2.750.000	3.500
2007	0	19.990
2008	2.000.000	0
2009	3.700.000	0
2010	3.700.000	11.000
2011	3.700.000	11.000
2012	3.700.000	11.000
2013	3.700.000	11.000
2014	3.776.815	11.000
2015	3.776.815	11.000
2016	3.776.815	11.000

1.213 Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 6.12.2011⁴³, subjekti ka deklaruar se: “*Gjendja ime përfundimtare cash për vitin 2009 është 1.200.000 lekë dhe shuma prej 1.000.000 lekësh, nga shitja e truallit është përfshirë në këtë gjendje...*”.

1.214 Në sqarime të dhëna “lidhur me deklarinimin e pasurisë 2003 – 2013” në ILDKPKI⁴⁴, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se: “*Viti 2011 nuk rezultojnë lekë cash; viti 2012 nuk kemi të ardhura cash pasi janë likuiduar detyrime nga kontrata e huas së mëparshme ndaj A. L (10.000 euro); viti 2013 nuk kemi të ardhura cash, pasi kemi shlyer detyrimin e kontratës P.Sh 10.000 euro; aktualisht nuk kemi të ardhura cash që prej vitit 2011 e në vazhdim, por sqaroj*

⁴³ Përgjigje të pyetjes nr.***

⁴⁴ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.8.2022, e ILDKPKI-së.

se të gjitha të ardhurat cash janë konsumuar për shlyerjen e detyrimeve ndaj kontratës së sipërmarrjes dhe kontratave të huave sipas deklarimeve deri në vitin 2013...”.

1.215 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Shuma prej 10.000 euro, si pjesë e huas nga A. L është paguar në vitin 2010, me gjendjet cash që ka mbetur nga viti 2009 dhe të ardhurat e tremujorit të parë. Nga personi i lidhur është një pasaktësi në deklaram duke referuar në vitin e plotësimit të deklaratës 20.3.2010”.

1.216 Sa më sipër, duket i paqartë nga subjekti përdorimi i gjendjeve cash për shlyerjen e huave, por të padeklaruara në DPV përkatëse si pakësim të këtyre likuditeteve, ashtu edhe akumulimi i gjendjeve cash, i cili nuk mbështetet nga pretendimet e subjektit.

1.217 Nga Komisioni, paraprakisht, u vlerësua që shtesat/pakësimet, gjendjet e likuditeteve cash në banesë të pasqyrohen në analizën paraprake të treguesve financiarë, duke u mbështetur në deklaratimet periodike vjetore, si dhe sqarimet e dhëna nga subjekti në procesverbalin e ILDKPKI-së:

Gjendje në banesë datë 31 dhjetor			
Në lekë		Në euro	
Viti	Sipas komisionit paraprakisht		Përshkrim
2003	600.000		
2004	900.000		(Shtuar me 300,000 lekë)
2005	1.650.000		(Shtuar me 750,000 lekë)
2006	2.750.000	3.500	(Shtuar 1,100,000 lekë dhe 3,500 euro)
2007	0	19.990	(Pakësuar në shumën 2,750,000 lek dhe 3500 euro dhe shtuar 19,990 euro)
2008	2.000.000	0	(Pakësuar në shumën 19,990 euro dhe shtuar 2,000,000 lekë)
2009	3.200.000	0	(Shtuar me 1,200,000 lekë)
2010	3.200.000	11.000	(pa përfshirë 10,000 euro për A. L shlyerje; shtuar me 11,000 euro në këtë vit)
2011	3.200.000	11.000	
2012	3.200.000	11.000	(pa përfshirë 10,000 euro për A. L shlyerje)
2013	3.200.000	11.000	(pa përfshirë 10,000 euro për P. Sh shlyerje)
2014	3.276.815	11.000	(Shtuar me 76,815 lekë deklarim në DIPPV)
2015	3.276.815	11.000	
2016	3.276.815	11.000	

1.218 Pa përfshirë në këtë analizë gjendjet cash të pretenduara për shlyerjen e huas ndaj shtetasit A. L në shumën 20.000 euro dhe një pjese të huas në vlerën 10.000 euro, ndaj z. P. Sh në vitin 2013, gjendjet cash të llogaritura në fund të vitit 2016 do të rezultonin në vlerat 3.276.815 lekë dhe 11.000 euro, duke mos konfirmuar deklarin e subjektit si në DPV-në e vitit 2016 ashtu edhe në deklaratën Vetting.

1.219 Për gjetjet e mësipërme lidhur me këtë pasuri, burimin e ligjshëm të krijimit, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

1.220 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegime të rezultateve të hetimit, ka deklaruar se⁴⁵: “Në lidhje me të ardhurat cash, në vitet 2004 – 2010 i kam deklaruar në datën 6.12.2011, sipas procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI-ja, si dhe për pjesën tjetër në vitet 2011 – 2016 nuk kam deklaruar gjendje cash për shkak të huave që kemi marrë për shlyerjen për kësteve për blerjen e apartamentit. Në fillim të vitit 2010 kemi filluar shlyerjen e kësteve të huave duke filluar me huadhënësin A.L etj. Në lidhje me gjendjen cash janë dhënë shpjegime në analizën financiare në pjesën e parë të shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit”.

Vlerësimi i Komisionit

1.221 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe në shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet dhe provat e depozituara në seancën dëgjimore, të zhvilluar me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

1.222 Deklarimi i gjendjeve cash (shtimi/pakësimi dhe destinacioni i tyre), nga subjekti dhe personi i lidhur në deklaratimet e interesave periodike private ka mospërputhje me deklaratimet e kryera nga subjekti në procesverbalet e ILDKPKI-së, si dhe në përgjigjet e pyetësorëve nga Komisioni, këto mospërputhje shoqëruar edhe me pasaktësi në deklaratim të shlyerjes së huave, kanë shtuar paqartësitë në lidhje me ecurinë e këtyre likuiditeteve në banesë.

1.223 Komisioni ka vlerësuar se mbajtja dhe shtimi në një periudhë të caktuar⁴⁶ i likuiditeteve cash në vlera të konsiderueshme nga subjekti dhe personi i lidhur nuk shkon me pretendimet e subjektit se qëllimi i marrjes së huave ka qenë pamundësia e likuidimit me të ardhurat e tyre të kështit/eve të shtëpisë.

1.224 Si konkluzion, Komisioni vlerëson se subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit me barrën e provës në rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me gjendjet cash.

Vlerësimi tërësor për këtë pasuri

1.225 Në vlerësimin përfundimtar lidhur me këtë pasuri (apartament + garazh) dhe burimin e krijimit trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e saj me burime të ligjshme.

1.226 Gjithashtu, subjekti nuk arriti të provojë mundësinë financiare të personave të lidhur (3 huadhënësve) lidhur me mundësitë e tyre për dhënien e huave respektive me burime të ligjshme.

1.227 Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë bërë deklaratim të pasaktë të pasurisë duke mos u gjetur në kushtet e përcaktuara nga germa “a”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

1.228 Gjithashtu, subjekti është gjendur në kushtet e përcaktuara nga germa “b”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament + garazh.

2. Bufe, kuzhinë komplet me aksesore elektroshtëpiake

2.1 Në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar: “Bufe, kuzhinë komplet me aksesore shtëpiake, bërë dhuratë nga vëllai, ardhur në datën 31.5.2010. Paguar taksa doganore nga bashkëshorti, ndërsa tax free tërhequr nga blerësi i saj (vëllai). Vlera: 14.398 euro. Zotërimi: 50%”.

⁴⁵ Shihni përgjigjet e dhëna nga subjekti mbi rezultatet e hetimit.

⁴⁶ Në DIPPV-në e vitit 2008 ashtu edhe në DIPPV-në e vitit 2009 deklarohen shtesë të kursimeve cash në banesë në vlerat, përkatësisht, 2.000.000 lekë dhe 1.200.000 lekë.

2.2 Subjekti ka paraqitur: *faturë të blerjes së pajisjeve nga vëllai në Gjermani në vlerën 16.760 euro; dokumentacion zhdoganimi në emër të L.M, datë 31.5.2010, në shumën 472.346 lekë.*

2.3 Në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar: *“Bufe, kuzhinë komplet me aksesore elektroshtëpiake, dhuratë nga vëllai A.G në vlerën 16.760 euro”.*

2.4 Pavarësisht faturës së blerjes nga vëllai i subjektit dhe deklarimit të subjektit, nuk dokumentohet nga subjekti fakti që pajisjet elektroshtëpiake janë dhuratë nga vëllai i saj.

2.5 Për të parë mundësinë e këtij dhurimi të bërë nga vëllai i subjektit, Komisioni i kërkoi subjektit të provojë me dokumentacion mundësinë e dhurimit nga vëllai A.G, (emigrant).

2.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka deklaruar dhe shpjeguar mundësitë e dhurimit nga ana e vëllezërve të saj, por Komisioni i kërkoi shpjegime edhe në rezultatet e hetimit subjektit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.7 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti parashtroi se: *“Në lidhje me dhuratën kuzhinë gatimi në shumën 16.760 euro sqaroj se dhuruesi ka marrë vlerën 19% pas kalimit të saj nga Gjermania në Shqipëri kthyer Taks Free në vlerën 3.184 euro dhe vlera e vërtetë e dhurimit është 13.575 euro. Duhet të vlerësohet se të ardhurat si burim i dhuratave të vëllait nuk mund të merren vetëm ato në kohën e dhurimit. Kjo pasi ai si emigrant ka gjeneruar të ardhura që prej vitit 1994, që fatkeqësisht nuk mund të disponohen dokumente për shkak të ligjit gjerman, pas kalimit të afatit 10-vjeçar.*

Nga ana tjetër është një fakt i njohur publikisht, por edhe nga institucionet financiare, se nga shtetasit shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit vijnë remitanca, të cilat në kuptimin ekonomik konsiderohen si dërgesa të pasurisë për familjet e tyre në Shqipëri. Këto edhe nga Banka e Shqipërisë përfaqësojnë rreth 13% të buxhetit të shtetit”.

Vlerësimi i Komisionit

2.8 Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka bërë deklarim të saktë për këtë dhurim dhe arriti të provojë burimin e krijimit dhe mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur (trajtuar më lart në pikën 1 të këtij vendimi për pasurinë apartament).

3. Depozitë bankare nr. ref. * në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të subjektit dhe të nënës së saj**

3.1 Subjekti ka deklaruar llogari bankare të llojit “depozitë” pranë “Intesa Sanpaolo Bank” në emër të saj e të nënës së saj, me qëllim për ta ndihmuar atë. Burimi i kësaj llogarie është nga shitja e apartamentit me sip. 62.58 m², Lagjja Nr. ***, Laç, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 10.1.2007. Vlera prej 24.559 lekësh është vlera e mbetur nga interesat. Pjesa takuese: 0%.

3.2 Subjekti i ka bashkëlidhur këtij deklarimi dokumentin: *Pozicioni i përgjithshëm i klientit D. G dhe Rexhina Merlika në “Intesa Sanpaolo Bank”, për llogari rrjedhëse në shumën 24.559 lekë, në datën 24.1.2017.*

3.3 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. ***, datë 11.7.2017, konfirmon llogarinë e përbashkët D.G dhe Rexhina Merlika me gjendje 24.559 lekë, në datën 27.1.2017.

3.4 Nisur nga fakti që burimi i krijimit të kësaj depozite janë të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Laçit, nga Komisioni u përfshi në analizën paraprake financiare vetëm shuma 1.311.600 lekë, që është tërhequr *cash* në datën 20.1.2009, me përshkrimin “tërhequr *cash* Rexhina Merlika , pagesë këst shtëpie”.

3.5 Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë llogari bankare.

4. Llogari në B.P.S në emër të vajzës E.M, studente

4.1 Subjekti deklaron këtë llogari në emër të vajzës së saj me burim të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit. Vlera: 23.20 euro. Pjesa takuese: 50%.

4.2 Subjekti nuk i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacion justifikues ligjor lidhur me llogarinë e vajzës E.M në Itali.

4.3 Në DIPP-në e vitit 2016, si subjekti, ashtu edhe personat e lidhur, nuk e kanë deklaruar këtë llogari bankare dhe gjendjen e likuiditeteve, por subjekti ka deklaruar: “*Shpenzime për shkollimin e I. M. në Gjermani, për vitin 2016, në shumën 8.600 euro...*”.

4.4 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se: “*...për vajzën E.M., nga llogaria B.P.S, Milano, Itali, në fund të vitit 2016 ka pasur gjendje 3.437,2 euro...*”.

4.5 Gjithashtu, subjekti ka bashkëlidhur në cilësinë e provës: (i) deklaratë nr. *** prot., datë 15.7.2016, të V.B.G; (ii) nxjerrje llogarie B.P. S, për periudhën 23.9.2016 – 20.1.2017.

4.6 Shpenzimet për shkollim të deklaruara nga subjekti janë përfshirë në analizën financiare.

4.7 Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë llogari bankare.

5. Llogari bankare në “D.B”, në emër të vajzës I.M, studente

5.1 Subjekti deklaron këtë llogari në emër të vajzës së saj, me burim të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit. Vlera: 6.019 euro. Pjesa takuese: 50%.

5.2 Subjekti nuk i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacion justifikues ligjor lidhur me llogarinë e vajzës I.M në Gjermani. Ka deklaruar ndër vite shkollimin e vajzës I në Gjermani.

5.3 Në analizën financiare janë përfshirë veprimet financiare të kryera në këtë llogari bankare.

6. Llogari K.T nr. * në emër të vajzës I.M, studente**

6.1 Subjekti deklaron këtë llogari me burim të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit. Vlera: 111.3 euro. Pjesa takuese: 50%.

6.2 Subjekti nuk i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacion justifikues ligjor lidhur me llogarinë e vajzës I.M në Gjermani. Ka deklaruar ndër vite shkollimin e vajzës I në Gjermani.

6.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. ****, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera, se: “*...Për vajzën I.M, nga llogaria S.H (llogari nga data 11.11.2014– 15.12.2016), në fund të vitit 2014 ka pasur gjendje 7.371,21 euro; në fund të vitit 2015 ka pasur 5.334,84 euro; në datën 15.12.2016 ka pasur 5.634,98 euro. Në datën 15.12.2016 nga kjo llogari është transferuar shuma 5.634,98 euro, në llogarinë bankare të “D. B” e, më pas, nga kjo llogari për shpenzimet e saj i ka kaluar në llogarinë rrjedhëse nr. **** në K.T Gjermani...*”.

6.4 Referuar dokumentacionit bankar të depozituar me këtë pyetësor, nuk gjendet i pasqyruar destinacioni i shumës prej 5.634,98 euro, të transferuar në datën 15.12.2016, si dhe veprimet e kryera për periudhën 15.12.2016 - 31.12.2016 dhe deri në dorëzimin e deklaratës *Vetting* në llogarinë bankare të “D.B”.

6.5 Në analizën financiare janë përfshirë veprimet financiare të kryera në këtë llogari bankare.

6.6 Për periudhën 2014 – 2016, subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar gjendjet në këto llogari bankare.

6.7 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: “*garanci për studime në Gjermani për I.M., viti 2014–2015, në vlerën 7.960 euro, si dhe shpenzime të tjera 2000 euro...*”

6.8 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: “*shpenzime për shkollimin e I.M. në Gjermani, për vitin akademik 2015–2016, në shumën 6.800 euro...*”

6.9 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “shpenzime për shkollimin e I.M. në Gjermani, për vitin 2016, në shumën 8.600 euro...”

6.10 Në lidhje me burimin e të ardhurave të këtyre shumave në likuiditete bankare, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se janë nga puna e saj, si dhe të ardhurat nga biznesi të personit të lidhur (bashkëshortit).

6.11 Gjendjet në këto llogari janë pasqyruar në analizën paraprake të treguesve financiarë⁴⁷. Ndërsa për sa i përket shumave të shpenzuara për shkollimin e vajzës I. M. në Gjermani, Komisioni vlerësoi të marrë në konsideratë dhe të pasqyrojë në analizën paraprake financiare shumat e deklaruara në deklaratimet e interesave periodikë/privatë vjetorë 2015–2016⁴⁸, ndërsa për vitin 2014 të pasqyrohet si shpenzim shuma prej 2.589 euro⁴⁹.

6.12 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka sqaruar se: “Llogaritë bankare në emër të vajzës I.M, për vitin akademik 2014 - 2015, janë paguar si garanci për marrjen e vizës së studentit në Ambasadën Gjermane, shuma 7.980 euro, datë 7.11.2014, pagesë për shkollën e cila ka kaluar në Bankën S.H. PAGESA tjetër e datës 30.10.2014 në shumën 2,000 euro është transferuar nga Intesa Sanpaolo Bank, llogaria L.M, në llogarinë pranë bankës S. H.

Për vajzën I.M nga llogaria sipas S.H, data 1.11.2014–15.12.2016, ju sqaroj se në fund të vitit 2014 ka pasur 7.371,21 euro. Në fund të vitit 2015 ka pasur 5,334.84 euro e në datën 15.12.2016 ka pasur 5.634,98 euro. Në datën 15.12.2016 nga kjo llogari është transferuar shuma 5.634,98 euro në llogarinë bankare të ‘D.B’ dhe më pas nga kjo llogari (‘D.B’) për shpenzimet e saj i kaluar në llogarinë rrjedhëse në K.T Gjermani (ka vijuar studimet pranë “U.S.T”), institucion sipas të Drejtës Publike. Nga ana e Komisionit kërkohet të paqyrohet destinacioni i shumës prej 5,634.98 euro, të transferuar në datën 15.12.2016, si dhe veprimet e kryera për periudhën 15.12.2016 - 31.12.2016, referuar llogarisë bankare në ‘D. B’, gjendja në datën 31.12.2016 + 5,634.94 euro lëvizjet në këtë llogari janë: Në datën 12.1.2017 janë paguar lekët e vizës së vitit 2016, në shumën 1,250 euro, po nga kjo llogari në datën 18.10.2017 lekët lëvizëse për vitet 2017, 2018 në shumën 4,000 euro. Gjendja në datën 29.12.2017 është 2,539.69 euro. Kjo shumë është përdorur nga ana e saj (vajzës) për të paguar sigurimin shëndetësor, shpenzime të tjera (deklaruar në DPV-në e vitit 2017, ku janë kontrolluar llogaritë). Mendoj se me aktet e paraqitura dhe me këto sqarime i kemi pasqyruar lëvizjet financiare të vajzës I. M deri në vitin 2016”.

6.13 Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk konstatoi problematika për këto llogari bankare.

7. Automet tip “**” në përdorim**

7.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën Vetting automjet me targë AA ***, tip “****” në përdorim, sipas prokurës së posaçme nga vëllai i saj. Mjeti është në pronësi të vëllait të subjektit A. G. Automjeti është i pajisur me certifikatë pronësie në emër të vëllait të subjektit.

7.2 Bazuar në prokurën e posaçme nr. ***, datë 20.7.2012, shtetasi A. G autorizon motrën e tij Rexhina Merlika ta përfaqësojë në institucionet dhe të qarkullojë me mjetin e tij “****”, me targa AA ***⁵⁰.

⁴⁷ Aneks bashkëlidhur (për datën 31.12.2016 nuk është depozituar dokument të vërtetohet gjendjet e deklaruara në datën 31.12.2016) për I. M. në Gjermani.

⁴⁸ Komisioni vlerëson që në analizën paraprake të treguesve financiarë gjendja në llogarinë në D.B do të paraqitet me rezervë në vlerën e deklaruar nga subjekti në pyetësorin nr. ***, por subjekti duhet të provojë me dokumentacion ligjor gjendjen në datën 31.12.2016, në shumën 5.634 euro.

⁴⁹ Vlera e deklaruar si garanci prej 7.960 euro - gjendja në llogari në datën 31.12.2014 + shumën 2.000 euro.

⁵⁰ Shihni dokumentacionin ligjor të automjetit: certifikata e pronësisë e mjetit në emër të shtetasit A.G, e datës 20.7.2012 + leje qarkullimi + dokumente identiteti të shtetasit A.G + dokumente në gjuhën gjermane të mjetit, blerë në datën 29.6.2012, me çmim 14.285 euro nga A. G.

7.3 DPSHTRR-ja, me shkresën me nr. *** prot., datë 18.7.2017, konfirmon se shtetasit L, R, E dhe I.M nuk kanë në pronësi automjete aktive deri në datën 27.1.2017.

7.4 Ky automjet rezultoi në pronësi të shtetasit A.G, bazuar në certifikatën e pronësisë së datës 20.7.2012.

7.5 Subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë në ILDKPKI deri në vitin 2017 automjetin tip “****” me targa AA ***, të cilin është e autorizuar nga vëllai ta përdorë që nga viti 2012, sipas prokurës së posaçme të këtij viti.

7.6 Bazuar në të dhënat e AMF-së dhe lëvizjet jashtë vendit nga sistemi TIMS, ky automjet që në momentin e regjistrimit në shtetin shqiptar është përdorur nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur (kryesisht bashkëshorti i saj).

7.7 Ky automjet është blerë nga A. G. në datën 29.6.2012, në vlerën 14,285 euro në shtetin gjerman, më pas është importuar në Shqipëri. Nuk u konstatuan pagesa të shpenzimeve doganore për këtë automjet dhe se kush i ka kryer këto shpenzime.

7.8 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu la barrë prove për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit⁵¹.

7.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Autovetura tip ‘***’, me targa AA ***, është blerë nga vëllai im A. G, i cili është i pajisur me certifikatë pronësie, por që me prokurë të posaçme jam autorizuar ta përfaqësoj në institucione dhe të qarkulloj me mjetin e tij. Shpenzimet doganore të këtij mjete janë kryer nga pronari i mjetit. Nga ana ime nuk është deklaruar përdorimi i këtij mjete, pasi nuk është përdorur personalisht nga unë. Ai mjet është blerë nga vëllai për ta pasur në Shqipëri, për çdo nevojë familjare, pasi ai vinte shpesh dhe në atë kohë nuk ka qenë akoma mundësia për mjete me qira. Ai në vijim ka pasur si synim të vijë në Shqipëri për biznes e, për këtë shkak, e ka lënë këtë mjet në Shqipëri, e ku tjetër më mirë se tek motra, tek e cila pritet dhe përcillet. Ai në vitin 2018, me bashkortak gjerman kanë themeluar shoqërinë *** , import-eksport sh.p.k., me NIPT ***. Në kohën kur ai ka blerë mjetin, ne kemi pasur makinë tjetër tip ‘***’ me targa TR ***”.*

7.10 Subjekti ka paraqitur prova dokumentacion plotësues⁵².

Vlerësimi i Komisionit

7.11 Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka bërë deklaram të saktë për këtë pasuri në përdorim në deklaratën *Vetting* dhe nuk është konstatuar qëllimi i fshehjes së kësaj pasurie nga ana e saj. Gjithashtu u konstatua që kjo pasuri është blerë dhe është në pronësi të vëllait të saj A. G.

7.12 Gjithashtu, subjekti arriti të provojë burimin e krijimit dhe mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur (trajtuar më lart në pikën 1 të këtij vendimi për pasurinë apartament).

8. Llogari në “Raiffeisen Bank”

8.1 Subjekti ka deklaruar llogari rrjedhëse nr. ***, në emër të bashkëshortit si person fizik.

8.2 Burimi i krijimit: të ardhura nga puna si avokat. Vlera: 4.06 euro. Pjesa takuese: 0%.

8.3 Subjekti nuk i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacion justifikues ligjor.

8.4 Në përgjigje të rezultateve të hetimit shpjegoi se në lidhje me gjetjen e vlerës 4.06 euro në “Raiffeisen Bank” ka paraqitur nxjerrjet e llogarisë për periudhën nga 2005 – 2016.

⁵¹ Për më shumë, referojuni dosjes së procesit të rivlerësimit.

⁵² Dokumenti i blerjes në Gjermani, datë 29.6.2012; faturë tatimore nr. ***, datë 20.7.2012 dhe vërtetim datë 18.7.2012 i Bashkisë Laç.

8.5 Pas shpjegimeve të subjektit, Komisioni nuk konstatoi problematika të mëtejshme për këtë llogari bankare.

9. Llogari rrjedhëse nr. * AL në “Raiffeisen Bank”** në emrin e vajzës I. M (paga e muajit dhjetor 2016). Vlera: 132.713 lekë. Pjesa takuese: 100%

9.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) nxjerrje llogarie Rexhina Merlika në “Raiffeisen Bank”, me gjendje debitore 57.286 lekë në datën 24.1.2017; (ii) vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit për muajin dhjetor 2016 Rexhina Merlika ka përfituar të ardhura *neto* nga paga në shumën 132.977 lekë.

9.2 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. ***, datë 7.7.2017, konfirmon gjendjen debitore në llogarinë e pagës së subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika 57.286 lekë, në datën 27.1.2017.

9.3 Subjekti ka deklaruar shumën e pagës së muajit dhjetor 2016, e cila kreditohet në bankë në janar 2017. Sipas konfirmimit të bankës, gjendja e mbetur e llogarisë rrjedhëse të pagës së subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika në datën 24.1.2017, ka qenë -57.286 lekë.

9.4 Edhe në informacionin nga “Raiffeisen Bank” për Komisionin, me shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.7.2022, konfirmohet gjendja në datën 27.1.2017, në vlerën -57.286 lekë, ndërsa në datën 31.12.2016 kjo llogari page ka pasur një gjendje prej -189.936 lekësh.

9.5 Të dhënat për gjendjen e kësaj llogarie në datën 31 dhjetor të çdo viti janë pasqyruar në analizën paraprake të treguesve financiarë.

10. Deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit/L.M

10.1 Bashkëshorti i subjektit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Shtëpi banimi me sipërfaqe ndërtimi 101.8 m² dhe truall 200 m² sipas kontratës nr. ***, datë 18.7.2003, ndodhur në Krujë, Lagjja ****, rruga *****”.

10.2 Burimi i kësaj prone: ndërtuar me kredi sipas aktmarrëveshjes për akordim kredie afatgjatë, banesë private datë 10.6.1992, kredihënës dega e Bankës së Shtetit, kredimarrës I. M (babai i bashkëshortit) në kushtet e bashkëjetesës. Likuiduar shuma së bashku me interesat në vlerën 100.624 lekë, datë 14.3.2001.

10.3 Trualli me sip. 200 m² është përfituar në bazë të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, ndërtim sipas ligjit, zgjidhur me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 19.5.2000. Rivlerësuar pasuria në datën 19.7.2012, me vlerë 5.737.014 lekë, zotëron 100%.

10.4 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin ligjor⁵³ të kësaj prone.

10.4.1 ZVRPP-ja Krujë, me shkresat e ardhura nga ZQRPP-ja, konfirmon pasuri në emër të shtetasit L.M⁵⁴.

10.5 Subjekti ka deklaruar se: “*Për herë të parë 2003, shtëpi banimi, 5 milionë lekë, Lagjja Nr. ****, Krujë, ndërtuar me kredi, marrë nga vjehri I.M (likuiduar), regjistruar në pronësi të bashkëshortit L. M. Zotërimi: 33%*”.

⁵³ Shihni dokumentet ligjore në aneksin nr. *** të DV: vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 12.12.2013, për pasurinë me nr. ***, z.k. ***, shtëpi banimi me sipërfaqe ndërtimi 101.8 m² dhe truall me sip. 200 m² në Lagjen ***, Krujë, në pronësi të shtetasit L.M, rivlerësuar në datën 19.7.2012 në shumën 5.737.014 lekë. Kontratë nr. ***, datë 18.7.2003, sipas së cilës L. M blen nga babai i tij I.M pasurinë me nr. ***, z.k. ***, shtëpi banimi me sip. ndërtimi 101.8 m² dhe truall me sip. 200 m² në Lagjen 4, Krujë, kundrejt çmimit prej 300.000 lekësh, paguar cash. Aktmarrëveshje për akordim kredie bankare afatgjatë në shumën 40.000 lekë për banesë private e datës 10.6.1992, ndërmjet shtetasit I.M dhe Degës së Bankës së Shtetit, për ndërtim banese vetjake me vlerë 60.000 lekë, sipas preventivit të depozituar në bankë. Kredia do të kthehet në një afat prej 10 vitesh, me interes 0.5%/vit.

⁵⁴ Shihni vërtetimet nga dokumentet hipotekore të viteve 2003 dhe 2017 në aneksin nr. *** të DV për shtëpi banimi me sip. 101.8 m² dhe truall me sip. 200 m², në Lagjen nr. ***, Krujë, me nr. pasurie ***, z.k. ***.

10.6 Subjekti nuk i është referuar kontratës së shitblerjes të vitit 2003 dhe çmimit të saj prej 300,000 lekësh nga babai i bashkëshortit I. M. Nga ASHK-ja Krujë rezultoi pasuria⁵⁵ nr. *** e llojit shtëpi banimi me sip. 101.8 m² dhe sip. trualli 200 m², ndodhur në Lagjen Nr. *** Krujë, në emër të bashkëshortit të subjektit L.M, e rivlerësuar në vitin 2012.

10.7 Komisioni vlerësoi që të marrë si çmim blerjeje/krijimi të kësaj pasurie në emër të personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit) shumën 300.000 lekë.

10.8 Në lidhje me mundësinë financiare për blerjen e kësaj pasurie nga personi i lidhur në vitin 2003 në shumën 300.000 lekë, subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur të ardhura të dokumentuara për blerjen e kësaj pasurie, blerjen e automjetit tip “****” me targë KR ***, me kontratë shitblerjeje datë 7.10.2002, në shumën 200.000 lekë, kursimet *cash* dhe në llogarinë bankare në “Alpha Bank”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara deri në datën 31.12.2003⁵⁶.

11. Llogari rrjedhëse nr. * në “Intesa Sanpaolo Bank”** në emër të bashkëshortit. Vlera: 93.79 euro. Pjesa takuese: 100%.

11.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: *Pozicioni i përgjithshëm i klientit L.M në “Intesa Sanpaolo Bank”, për llogari rrjedhëse në shumën 93 euro në datën 24.1.2017.*

11.2 Nxjerrje llogarie e z. L.M në “Intesa Sanpaolo Bank” për periudhën 1.1.2014 – 14.10.2016, me gjendje 93 euro.

11.3 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. ****, datë 11.7.2017, konfirmon llogarinë e shtetasit L.M me gjendje 93 euro në datën 27.1.2017.

11.4 Në informacionin nga “Intesa Sanpaolo Bank” për Komisionin, me shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.6.2022, konfirmohet gjendja e deklaruar në llogaritë bankare të personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit) në këtë bankë.

11.5 Përputhet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

12. Llogari rrjedhëse nr. * në “Raiffeisen Bank”,** në emër të bashkëshortit si person fizik. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna si avokat. Vlera: 21.065 lekë. Pjesa takuese: 100%.

12.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogari rrjedhëse e L. M PF në “Raiffeisen Bank”, për periudhën 19.1.2016 – 31.12.2016, me gjendje 42.484 lekë.

12.2 Llogaria e deklaruar nga z. L.M i përket aktivitetit të tij si person fizik. Gjendja e dokumentuar i përket fundit të vitit 2016.

13. Llogari në “Raiffeisen Bank”, me llogari rrjedhëse nr. ***, në emër të bashkëshortit si person fizik. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna si avokat. Vlera: 4.06 euro. Pjesa takuese: 100%.

13.1 Llogaria e deklaruar nga L.M i përket aktivitetit të tij si person fizik.

14. Të ardhura të krijuara nga shitja e tokës bujqësore ullishtë me sip. 72.500 m², me çmim 36.000.000 lekë (sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 1.4.2008), deklaruar nga subjekti.

14.1 Subjekti nuk ka arritur të provojë plotësisht kryerjen e këtij transaksioni. Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2023, i është drejtuar shoqërisë “****”, sh.p.k. dhe deri në mbyllje të rezultateve të hetimit nuk është kthyer përgjigje nga kjo shoqëri.

⁵⁵ Shihni vërtetimin hipotekor të vitit 2003, bashkë me dokumentacionin shoqërues, pjesë e hetimit të Komisionit.

⁵⁶ Pjesë e analizës paraprake financiare në aneks bashkëlidhur.

14.2 Lidhur me këtë çështje, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të vërë në dispozicion të Komisionit kopjen e kontratës së shitblerjes, kopje të pagesave të kryera, veprimet bankare për kalimin e shumës të pala shitëse, si dhe informacion për pagimin e detyrimeve tatimore lidhur me këtë transaksion.

14.3 Në analizën financiare, këto të ardhura u morën me rezervë nga Komisioni, i cili do t'i vlerësonte ato si të ligjshme pas shpjegimeve dhe provave që do të sillte subjekti.

14.4 Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, deklaroi: “... për të prapësuar gjetjet e Komisionit, paraqes prova të reja shtesë, që provojnë të ardhurat nga ky transaksion mes palës shitëse dhe palës blerëse ‘***’. Bashkëshorti si trashëgimtar ligjor i trashëgimlënësit I. L.M ka përfituar pjesë takuese prej 1/3 nga gjithë pasuria trashëgimore e I. M, tek pasuria e fituar me trashëgim për tokë bujqësore (ullishtë) ish-pasuri e L.H.M është 1/24 pjesë takuese, të cilën me deklaratën noteriale nr. ***, datë 1.4.2008 (jo me akt noterial) kanë shitur e dorëzuar sendin në përdorim palës blerëse ‘***’.

*Pagesa nga blerësi “****” është likuiduar si vijon:*

- çek pagese në emrin L.M, datë 5.5.2008, në shumën prej 10.000.000 lekësh;
- çek pagese në emrin L.M, nr. ***, datë 4.11.2010, në shumën prej 5.000.000 lekësh;
- çek pagese në emrin S.M, nr. ****, datë 7.12.2012, në shumën prej 5.500.000 lekësh;
- çek pagese në emrin S.M, nr. ****, datë ...12.2012, në shumën prej 5.000.000 lekësh;
- transfertë bankare në emrin S.M në “Raiffeisen Bank”, datë 19.12.2013, në shumën prej 10.500.000 lekësh.

Zona kadastrale nuk ishte azhurnuar dhe hedhur në sistem, në vijim të përpjekjeve të vazhdueshme për regjistrimin e pasurisë në ZVRPP-në Krujë apo më vonë në ASHK, Drejtoria Vendore Krujë. Nga ana jonë prej vitesh është aplikuar për të realizuar regjistrimin e kësaj pasurie.

*Në lidhje me mospagesën e detyrimeve tatimore për këtë transaksion është parashikuar në deklaratën noteriale nr. ****, datë 1.4.2008, në faqen 3 të saj se shoqëria merr përsipër të gjitha detyrimet që duhet të paguajnë shitësit, pra shuma sa më sipër do të jetë fitimi neto i deklaruesve, kur të bëhet shitja definitive me akt noterial, si të jetë përcaktuar nga Kodi Civil, do të bëhen edhe pagesat nga ne si palë apo nga pala blerëse”.*

14.5 Për të provuar deklaratimet e saj subjekti ka paraqitur si provë dokumentacion shkresor⁵⁷.

Qëndrimi i Komisionit

14.6 Pas shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues nuk konstatoi problematika lidhur me këto të ardhura të krijuara nga shitja e tokës bujqësore ullishtë.

15. Detyrime financiare të subjektit dhe bashkëshortit të saj

- Kontratë huaje, datë 17.1.2009, marrë me qëllim shlyerjen e detyrimit sipas kontratës së sipërmarrjes në shumën 20.000 euro me afat trevjeçar, likuiduar shuma në vlerën 10,000 euro në fund të vitit 2010 dhe kësti i dytë në datën 26.12.2012. Aktualisht shlyer tërësisht

⁵⁷ Çek pagese, datë 5.5.2008, në shumën 10.000.000 lekë; çek pagese nr. ***, datë 4.11.2010, në shumën 5.000.000 lekë; çek pagese ***, nr. ****, datë 7.12.2012, në shumën 5.500.000 lekë; çek pagese nr. ***, datë ...12.2012, në shumën 5.000.000 lekë; transfertë bankare “Raiffeisen Bank”, datë 19.12.2013, në shumën 10.500.000 lekë; pagesat për trashëgimtarët e shtetasit H (I) M, datë 16.5.2008; Pagesat për trashëgimtarët e H (I) M, datë 10.12.2012; pagesat për trashëgimtarët e H (I) M, datë 22.12.2012; pagesat për trashëgimtarët e H (I) M, datë 19.12.2012; kërkesë nr. ***, datë 6.12.2017, për ZVRPP-në Krujë; shkresë nr. *** prot., datë 29.6.2020; relacion shpjegues, datë 18.6.2020; planvendosje, datë 18.6.2020; AMTP nr. ***, datë 9.9.1997; kërkesë nr. ***, datë 17.7.2020 (mandatarkëtim postar); kërkesë nr. ***, datë 5.10.2022; kërkesë nr. ***, datë 15.12.2022; kërkesë nr. ***, datë 24.1.2023; certifikatë regjistrimi pronësie për pasurinë nr. *** me kod unik ***, datë 28.12.2022; kartelë e pasurisë së paluajtshme me kod unik ***, datë 28.12.2022; fragment i hartës kadastrale, datë 10.1.2023; deklaratë noteriale nr. ***, datë 1.4.2008.

detyrimi, konfirmuar përmbushja e këtij detyrimi me deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.1.2017 (lidhur nga bashkëshorti). Detyrim i përmbushur.

- Kontratë huaje, datë 1.3.2011, marrë hua me qëllim shlyerjen e detyrimit sipas kontratës së sipërmarrjes në shumën 15.000 euro pa afat, likuiduar në dy këste shuma në vlerën 10.000 euro më 23.12.2013 dhe kësti i dytë në vlerën 5.000 euro më 30.6.2014. Aktualisht shlyer tërësisht detyrimi, konfirmuar përmbushja e detyrimit me deklaratën noteriale nr. ***, datë 23.1.2017 (lidhur nga bashkëshorti). Detyrim i përmbushur.
- Kontratë huaje nr. 1 regj., datë 2.7.2010, marrë hua me qëllim shlyerjen e detyrimit sipas kontratës së sipërmarrjes në shumën 5.000.000 lekë pa afat, likuiduar pjesërisht në shumën 1.500.000 lekë në datën 31.12.2015. Deklaratë konfirmuese në datën 31.12.2015 e huadhënësit (lidhur nga bashkëshorti). Detyrimi i mbetur: 3.500.000 lekë.

15.1 Këto hua të marra nga personi i lidhur janë pasqyruar e analizuar si burim për pagesën e kësteve të apartamentit në rrugën “***”, Tiranë, në pikën 1 të këtij vendimi.

16. Analiza paraprake e treguesve financiarë

16.1 Nga analiza e përgjithshme paraprake e treguesve financiarë, të kryer nga Komisioni, për periudhën 2003 – 31.12.2016, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, si dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, përveç sa pasqyruar/analizuar më lart, duket se për vitet e mbyllura 2004, 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të deklaruara/dokumentuara, për blerje/krijim të pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këto vite. Balanca negative, në dukje, përkatësisht në vlerat 498.444 lekë, 1.774 lekë, 419.840 lekë, 997.996 lekë, 5.656.597 lekë dhe 1.229.287 lekë.

16.2 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit⁵⁸.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

16.3 Subjekti i rivlerësimit në shpjegime të rezultateve të hetimit ka deklaruar se: *“Në lidhje me analizën paraprake të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni për periudhën 2003–2016, i cili ka konstatuar se nuk kemi burime të mjaftueshme për krijimin e pasurive dhe të shpenzimeve të deklaruara për vitet 2004, 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011, pas të gjitha prapësimeve dhe provave çmojmë se këto konstatime duhet të rishikohen në raport me provat shtesë”. Kjo, pasi nga balanca negative e cituar më lart, nuk janë marrë në konsideratë burimet e të ardhurave nga paga ime që prej vitit 1989 deri më 31.12.2002, po kështu ato të bashkëshortit nga periudha 1.1.1994 e në vazhdim, të ardhurat nga emigracioni jo në tërësinë e tyre, si dhe të ardhurat e personave të lidhur prindërit e bashkëshortit nga përfitimi si të përndjekur politikë, pensioni dhe të ardhurat nga familja bujqësore (AMTP nr. ***, datë 9.9.1997), të cilët kanë qenë në gjendjen tonë familjare faktike dhe juridike, si burimet huadhënësve. Nëse do të ishin marrë parasysh në llogaritje si burime të ardhurash, atëherë nuk do të kishte balancë negative në asnjë nga vitet e konstatuara.*

Për të kundërshtuar në tërësi balancat negative, ne me ndihmën e një specialisti në fushën e financave kemi realizuar një analizë financiare për të gjithë periudhën e shqyrtimit. Kjo analizë financiare është mbështetur në të gjithë dokumentacionin që është depozituar nga institucionet sipas ligjit dhe nga ana jonë, për të argumentuar burimet e krijimit të të ardhurave dhe shpenzimet”.

Qëndrimi i Komisionit

⁵⁸ Për më shumë, referojuni dosjes së procesit të rivlerësimit.

16.4 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar si dhe shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet dhe provat e depozituara në seancën dëgjimore të zhvilluar me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

16.5 Në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur detyrim të deklaronin në ILDKPKI, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, përfshirë edhe: (a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to; (b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë; (c) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj; (ç) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valute të huaj.

16.6 Ndërsa në nenin 6 “Deklarimi i parë” të këtij ligji është përcaktuar se: “...*Të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, që mbartin detyrim për deklarinin, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji detyrohen të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre...*”.

16.7 Sa më sipër, subjekti në deklarinin e interesave privatë për herë të parë në datën 17.3.2004 ka deklaruar, ndër të tjera, depozitë bankare në “Alpha Bank” gjendje në datën 31.12.2003 në vlerën 1.25 milionë lekë me burim vendim gjyqësor, si dhe gjendje *cash* në banesë në shumën 0.6 milionë lekë, me burim kursime familjare ndër vite. Në bazë të analizës financiare të kryer nga Komisioni, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi për krijimin e këtyre vlerave monetare të deklaruara si gjendje në datën 31.12.2003.

16.8 Pretendimet e subjektit për të ardhura dhe kursime shtesë për periudhën 1989–2002, duke shtuar likuiditetet *cash*, nuk gjejnë pasqyrim në deklarinin e interesave privatë për herë të parë, në të cilin subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur detyrim të deklaronin të gjitha pasuritë (përfshi likuiditetet në bankë dhe *cash*) gjendje në datën 31.12.2003, por edhe në deklaratimet e mëtejshme të subjektit, por janë deklaruar vetëm pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

16.9 Për sa i përket raportit financiar të depozituar, nga Komisioni konstatohet se ai ka marrë në shqyrtim si vit bazë vitin 2002, por pa analizuar dokumentacionin provues për vlerat monetare në bankë dhe *cash* në datën 31.12.2002. Nisur nga fakti që deklarimi fillestar është kryer në vitin 2003, duket i paqartë dokumentacioni në të cilin është mbështetur kontabilisti i autorizuar për të vlerësuar gjendjen e likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2002. Analiza në vitet në vazhdim nuk është bazuar në deklaratimet e subjektit për gjendjet *cash* të deklaruara, shtesa/të pakësuara, por në fillim të vitit është aplikuar diferenca e llogaritur midis të ardhurave (hyrjeve të fondeve) dhe shpenzimeve/bletje të pasurive (daljeve të fondeve).

16.10 Për sa i përket huave nga personat e tjerë të lidhur, analiza dhe vlerësimi i Komisionit për burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe mundësinë financiare për krijimin e shumave të dhëna hua është pasqyruar më lart.

16.11 Nga Komisioni vlerësohet se si metodologjia e ndjekur në hartimin e raportit financiar, si baza e të dhënave të referuara, ashtu edhe konkluzionet e pretenduara, duket se nuk mbështeten në dokumentacion ligjor/financiar, si dhe në deklaratimet e subjektit dhe personit të lidhur.

16.12 Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti dhe/ose personi i lidhur nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit me barrën e provës në rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me balancat negative të sipërcituara.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, DSIK-ja, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe nenet 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016.

2. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit raportin⁵⁹ për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika.

3. Me shkresën⁶⁰ e dërguar në vitin 2017, DSIK-ja ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

4. Por, pavarësisht këtij raporti, në raportin e përditësuar dhe deklasifikuar pjesërisht nga DSIK-ja në vitin 2022, thuhet se: *“Për subjektin e rivlerësimit znj. Rexhina Merlika, në cilësinë e gjyqarit, gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e saj si kryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në Krujë, disponohen të dhëna për përfshirje në ndërveprime korruptive në formën e dhënies së vendimit fiktiv në një çështje gjyqësore lidhur me një pronë. Për kohën brenda periudhës së rivlerësimit, znj. Merlika evidentohet në dy të dhëna mbi përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës.*

Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit, rezulton se bazuar në parashikimet e bëra në aneksin “Rivlerësimi kalimtar i gjyqarëve dhe i prokurorëve”, neni DH “Kontrolli i figurës”, pika 2 që përcakton si periudhë të vlerësimit për kontrollin e figurës datën 1.1.2012, nisur nga të dhënat e sipërcituara, veprimtaria e dyshuar si korrupsion dhe abuzim me detyrën nga subjekti i rivlerësimit i përket një periudhe përpara këtij afati.

Ky fakt mund të konsiderohet rrethanë lehtësuese sipas përcaktimeve dhe kritereve të përcaktuara në germën “d” të pikës 5 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, pasi veprimtaria e dyshuar e kundërligjshme e subjektit të rivlerësimit i përket një periudhe shumë të hershme kohore dhe nuk ka tregues apo të dhëna që të evidentojnë faktin që ajo të vazhdojë”.

5. Gjithsesi, Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese⁶¹.

6. Komisioni në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

7. Nga hetimi i kryer dhe verifikimi i 2 çështjeve (çështje të trajtuara më poshtë⁶²) nga ana e Komisionit nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer:

⁵⁹ Shihni raportin përfundimtar të DSIK-së, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 29.8.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 19.9.2022, të KDZH-së.

⁶⁰ Shihni raportin dërguar nga DSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017.

⁶¹ Komisioni hetoi lidhur me 2 çështje gjyqësore në aspektin e vlerësimit profesional, të cilat janë trajtuar në kreun “Të tjera”, pjesë e këtij vendimi.

⁶² Trajtuar në pikën E të këtij vendimi.

- a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësinë e të dhënave nga subjekti i rivlerësimit;
- b) nuk u evidentuan rrethana që mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016;
- c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- a) formularit të vetëdeklarimit;
- b) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- c) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- ç) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

3. Lidhur me të dhënat statistikore, subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka deklaruar se gjatë tri viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 1736 çështje, ka përfunduar gjithsej 1613 çështje, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 123 çështje të vitit 2016.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti 1 – vendimi civil nr. ***, datë 3.3.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit D.Gj, me të paditur shoqëria *** sh.a., me objekt “detyrimi për dëmshpërblimin me 12 paga mujore për zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës etj.”.

Komisioni konstatoi se në vendim nuk rezulton e pasqyruar data e regjistrimit të çështjes dhe, rrjedhimisht, nuk mund të përcaktohet kohëzgjatja e gjykimit të saj, nëse është brenda apo jashtë afatit 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit⁶³. Gjyqtarja nuk ka përdorur në arsyetim ndonjë parim të shprehur të së drejtës dhe as referim në praktikë gjyqësore.

Dokumenti 2 – vendimi civil nr. ****, datë 30.3.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që u përket paditësve B. H, A. H e L. H, me të paditur A. S, F. S, L. S e E. S, me objekt “detyrimi i të paditurve të na lirojnë objektin që ndodhet në rrugën...”.

Dosja civile rezulton e regjistruar në datën 29.8.2014 dhe gjykimi ka përfunduar në datën 30.3.2015, pra pas 7 muajsh e 1 ditë, nga konstatohet se është shqyrtuar jashtë afatit 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit⁶⁴. Gjyqtarja nuk ka përdorur në arsyetim parime të shprehura të së drejtës.

⁶³ Sistemi i vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin **** “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

⁶⁴ Sistemi i vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin *** “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Dokumenti 3 – vendimi civil nr. ***, datë 8.5.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit F. A, me të paditur shoqëria *** sh.a., me objekt “deklarimi i pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, faturës tatimore të muajit maj 2014 me nr...”.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i këtyre dokumenteve nuk u konstatuan problematika.

Për gjetjet e mësipërme subjektit iu kërkua të jepte shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi se: *“Duke ndjekur sistematikën e konstatimeve tuaja, për afatet e shqyrtimit, si dhe mospërdorimi në arsyetim të ndonjë parimi të shprehur të së drejtës dhe as referim të praktikës gjyqësore, ju sqaroj fillimisht në lidhje me tre dokumentet ligjore të paraqitura nga ana ime për sa i përket afatit të shqyrtimit.*

*Në lidhje me konstatimet për çështjen që i përket vendimit nr. ****, datë 3.3.2014, me palë paditëse D. Gj., ku thuhet se nuk pasqyrohet data e regjistrimit dhe nuk mund të konkludohet për kohëzgjatjen e gjykimit, sqaroj se kjo çështje është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 16.1.2014, ndërkohë që vendimi është shpallur në datën 3.3.2014, pra rezulton që kjo çështje është gjykuar nga ana ime brenda afatit orientues të KLD-së, pasi është gjykuar për 1 muaj e 15 ditë. Në këtë vendim, në zbatim të dispozitave procedurale civile, konkretisht nenet 36/1, 41 dhe 47 të Kodit të Procedurës Civile, është verifikuar juridiksioni dhe kompetenca lëndore dhe tokësore. Kjo e fundit është referuar edhe në nenin 7 të Kodit të Punës. Në vijim është zbatuar neni 310 i Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit është përcaktuar që ‘Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-argumentuese dhe pjesën urdhëruese...’. Në arsyetimin e vendimit janë argumentuar të gjitha dispozitat specifike të Kodit Penal referuar objektit të padisë, pra kërkimeve të palëve dhe detyrimin për t’u shprehur për të gjitha kërkimet. Vendimi i mësipërm është ankimuar dhe është lënë në fuqi.*

Parimet e së drejtës nga gjykata respektohen gjatë gjykimit, si parimi i barazisë së palëve në procesin civil, parimi i vënies në lëvizje të gjykatës nga palët, pra iniciimi i procesit gjyqësor civil, por edhe i tërheqjes nga procesi, parimi i disponibilitetit të padisë, që do të thotë që gjykata gjykon mosmarrëveshjen duke u shprehur mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet, parimi i kontradiktoritetit dhe hetimit gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm dhe atë të ligjshmërisë.

*Për çështjen që i përket vendimit civil nr. ***, datë 30.3.2015, me paditës B. H. etj., me të paditur A. S. etj. me objekt “detyrimin e të paditurve të na lirojnë objektin...” është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 29.8.2014, ndërkohë që vendimi është shpallur në datën 30.3.2015, pra rezulton që kjo çështje është gjykuar pas 7 muajsh e 1 dite nga regjistrimi i saj. Sqaroj se nga ana ime, pasi është verifikuar dhe dosja nuk ndodhej në arkiv, pasi është lënë në fuqi në Gjykatën e Apelit Tiranë, është dërguar për shqyrtim në Gjykatën e Lartë mbi bazën e rekursit të palës së paditur, kam nxjerrë të dhëna lidhur me shkaqet e shtyrjes nga sistemi elektronik i gjykatës, nga të cilat rezulton se:*

Nga ana ime është menaxhuar me korrektësi çështja pas regjistrimit, njohjes me aktet, janë njoftuar palët për seancë përgatitore, datë 1.10.2014. Seancë e cila, në referim të 154 të Kodit të Procedurës Civile, është shtyrë më 28.10.2014, për t’i dhënë kohë palës paditëse të paraqesë provat në formën e kërkuar sipas ligjit, si dhe palës së paditur për të paraqitur prova shpresore lidhur me çështjen objekt gjykimi (plotësimi i të metave të padisë). Në seancën përgatitore të caktuar janë zhvilluar veprimet përgatitore duke u kaluar çështja në seancë gjyqësore, bazuar në nenin 158/a të Kodit të Procedurës Civile, datë 14.11.2014. Kjo seancë nuk është zhvilluar, për shkak se kam qenë me raport paaftësie në punë, sipas shënimit të sekretarit gjyqësor, ku janë njoftuar palët për seancë gjyqësore, datë 19.1.2014. Kjo seancë gjyqësore është shtyrë me kërkesën e palës paditëse, duke u caktuar seanca në datën

16.12.2014. Edhe kjo seancë është shtyrë në datën 28.1.2015 me kërkesën e palës paditëse, pasi nuk ka mundur marrjen e certifikatës së rifreskuar, si dhe prova të tjera. Në seancën e ardhshme nga ana e palës paditëse, në referim të nenit 161 të Kodit të Procedurës Civile, është kërkuar thirrja në cilësinë e të paditurit të shtetasve F. S., L. S. dhe E. S. Gjykata ka disponuar me pranimin e kërkesës për thirrjen e këtyre shtetasve në cilësinë e të paditurve e, për pasojë, në garanci të të drejtave të palëve në proces, konkretisht të të paditurve, është komunikuar kërkesa dhe thirrja e tyre në cilësinë e të paditurve, duke u caktuar seanca e ardhshme, datë 18.2.2015. Në këtë seancë, gjykata ka disponuar në bazë të nenit 302 të Kodit të Procedurës Civile, duke shtyrë seancën në datën 23.2.2015, për të paraqitur palët pretendimet përfundimtare me shkrim. Kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të pamundësisë sime shëndetësore, duke u njoftuar palët për datën 2.3.2015. Në këtë seancë gjyqësore, i padituri në fazën e konkluzioneve përfundimtare i ka kërkuar gjykatës shtyrjen me qëllim dhënien e mundësisë për vazhdimin e gjykimit në prani të mbrojtësit. Seanca gjyqësore vijuese është shtyrë mbi kërkesën e paditësit për t'i dhënë mundësinë për të paraqitur në seancë gjyqësore vërtetimin lidhur me statusin e të pastrehëve për familjen e të paditurve. Për këtë shkak, seanca e radhës është caktuar në datën 19.3.2015. Në këtë seancë nga pala paditëse është propozuar zgjidhje me pajtim sipas kushteve të parashtruara në seancë e, për këtë shkak, i padituri ka kërkuar që këtë mundësi ta shqyrtojë me pjesëtarët e familjes, prandaj është disponuar me shtyrjen e seancës gjyqësore, datë 25.3.2015. Në këtë seancë ka përfunduar shqyrtimi dhe, bazuar në nenin 308/2 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata ka disponuar me shtyrjen për shpalljen e arsytuar të vendimit, për shkak të natyrës komplekse të konfliktit gjyqësor. Në datën 30.3.2015 ka përfunduar shqyrtimi me shpalljen e vendimit.

Në lidhje me këtë çështje kam bërë të gjitha përpjekjet për menaxhimin dhe zgjidhjen e saj brenda afatit orientues të KLD-së, por, nëse shohim vijimin e shqyrtimit, dy seanca kanë dështuar për arsye objektive, pamundësi për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë nga ana ime, që referon shtyrje të seancave për një afat mbi një muaj. Ndërsa të gjitha shtyrjet e tjera kanë qenë në respektim dhe zbatim të parimit të disponibilitetit të paditësit (neni 161 i Kodit të Procedurës Civile), të dhënies së aksesit në gjykim, të parimit të kontradiktoritetit, të barazisë së palëve dhe ligjshmërisë në mënyrë që të mundësohet një proces i rregullt ligjor”.

5. Pas shpjegimeve të dërguara nga subjekti, Komisioni nuk konstatoi problematika penalizuese në aspektin profesional për 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

Përshkrimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short

Dosja 1 – çështja civile me nr. *** regj., datë 26.5.2015, që u përket paditësve G. D e F. D, kundër të paditurit shoqëria “***” sh.a., me objekt “detyrimin e të paditurit për të paguar në favor të paditësve shpërblimin për dëmin e plotë pasuror dhe jopasuror, si dhe shpenzimet e tjera të arsyeshme... etj.”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 29.10.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 26.5.2015, e cila i ka kaluar për gjykim gjyqtar Rexhina Merlika. Me vendimin e datës 4.6.2015, gjyqtarja Rexhina Merlika ka caktuar seancën përgatitore më 6.7.2015, ora 10:30.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka zgjatur gjithsej 4 muaj e 27 ditë, në intervalin kohor 2.6.2015 – 29.10.2015. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e aneksit 1 të sistemit të vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Të gjitha procesverbalet, të seancës përgatitore dhe gjyqësore të administruara në dosje nuk janë të plota, pasi në kundërshtim me kërkesat e nenit 118, germa “ç” e Kodit të Procedurës Civile, mungojnë gjeneralitetet e pjesëmarrësve në gjykim, e konkretisht të paditësve.

Nga aktet në dosje rezulton se vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët ndërgjyqëse.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtarja në kryesekretari, në datën 3.11.2015, pas 5 ditëve, nga shpallja brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Civil, të Kodit të Procedurës Civile, ligji nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe vendimi unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, i Gjykatës së Lartë. Gjyqtarja nuk ka përdorur në arsyetim parime të shprehura të së drejtës.

Dosja 2 – çështja civile nr. *** regj., datë 10.6.2014, që i përket kërkueses Ç. P, person i interesuar DRSSH Tiranë, DRSSH Korçë dhe Komuna Qendër B, me objekt “vërtetimi i faktit juridik të marrëdhënieve të punës pranë ish-kooperativës bujqësore L...”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 8.4.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 10.6.2014 dhe me vendimin e datës 13.6.2014 gjyqtarja Rexhina Merlika ka caktuar seancën përgatitore më 17.7.2014, ora 10:00.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka zgatur gjithsej 9 muaj e 28 ditë, në intervalin kohor 10.6.2014 – 8.4.2015. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit 2-mujor të caktuar nga pika 5, germa “j” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtarja Rexhina Merlika në kryesekretari, në datën 17.4.2015, pas 9 ditëve, nga shpallja brenda afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjyqtarja nuk i ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen brenda afatit të mosmarrëveshjes.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile. Gjyqtarja nuk ka përdorur në arsyetim ndonjë parim të shprehur të së drejtës dhe as referim në praktikë gjyqësore.

Nga aktet në dosje rezulton se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim DRSSH-ja Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 5.4.2016 ka vendosur: “*Prishjen e vendimit nr. ***, datë 8.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues*”.

Dosja 3 – çështja civile nr. *** regj., datë 22.10.2015, që i përket paditësit “****” sh.a., kundër të paditurës P.K, me objekt “detyrimin për pagimin e shumës 21, 201 lekë si detyrim i papaguar për shërbimin telefonik celular”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.6.2016.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 22.10.2015 dhe me vendimin e datës 27.10.2015, gjyqtarja Rexhina Merlika ka caktuar seancën përgatitore më 19.11.2015, ora 12:30, duke urdhëruar edhe njoftimin e palëve ndërgjyqëse.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka zgatur gjithsej 7 muaj e 28 ditë, në intervalin kohor 23.10.2015 – 21.6.2016. Kjo kohëzgjatje është jashtë afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtarja në kryesekretari, në datën 29.6.2016, pas 8 ditëve, nga shpallja brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjyqtarja nuk ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen brenda afatit të mosmarrëveshjes.

Konstatohet se procesverbalet e seancave përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje nuk janë të plota, pasi në kundërshtim me kërkesat e nenit 118, pika “ç” e Kodit të Procedurës Civile, mungojnë gjeneralitetet e pjesëmarrësve në gjykim, e konkretisht të së paditurës.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile dhe ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Gjyqtarja nuk ka përdorur në arsyetim parime të shprehura të së drejtës dhe as referim në praktikë gjyqësore.

Dosja 4 – çështja civile nr. *** regj., datë 4.11.2014, që i përket paditësit I.D, kundër të paditurit “****” sh.p.k., me objekt “detyrimi për pagimin e shumës 956.055 lekë, si detyrim që rrjedh nga marrëdhëniet kontraktuale të punës”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.2.2015.

Pas regjistrimit të çështjes në gjykatë, gjyqtarja Rexhina Merlika ka vendosur kalimin e çështjes në seancën përgatitore më 3.12.2014, ora 10:00, duke urdhëruar njëkohësisht sekretarinë gjyqësore të njoftojë palët ndërgjyqëse.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka zgatur gjithsej 3 muaj e 21 ditë, në intervalin kohor 6.11.2014 – 27.2.2015. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, gema “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtarja në kryesekretari në datën 5.3.2015, pas 6 ditëve, nga shpallja brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit të Punës, Kodit të Procedurës Civile dhe VKM-së nr. 539, datë 6.8.2014. Gjyqtarja nuk ka përdorur në arsyetim parime të shprehura të së drejtës dhe as referime në praktikë gjyqësore.

Dosja 5 – çështja administrativo-penale nr. *** regj., datë 13.7.2014, që i përket kërkesës së Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “vleftësimi i ligjshëm i arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj shtetasit G. Sh”, e përfunduar me vendimin nr. *** akti, datë 14.7.2014.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 13.7.2014 dhe, po atë ditë, çështja i është caktuar gjyqtar Rexhina Merlika, e cila ka njoftuar të shoqërohet i arrestuari G. Sh për zhvillimin e seancës gjyqësore më 14.7.2014, ora 10:00.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka zgjatur gjithsej 1 ditë, në intervalin kohor 13.7.2014 - 14.7.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit procedural penal të 48 orëve, të përcaktuar në nenin 258 të Kodit të Procedurës Penale. Kohëzgjatja e gjykimit respekton standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika në kryesekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 22.7.2014, 8 ditë pas shpalljes, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale dhe vendimi unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjyqtarja nuk ka përdorur në arsyetim ndonjë parim të shprehur të së drejtës.

Për të gjitha gjetjet e mësipërme lidhur me 5 çështjet e përzgjedhura me short, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

6. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi se: *“Çështja që i përket vendimit civil nr. ***, datë 29.10.2015, që i përket paditësve G. D., F. D. me të paditur shoqëria ‘***’ sh.a., rezulton se është shqyrtuar brenda afatit orientues të KLD-së. Kjo çështje është pushuar, pasi pala ka hequr dorë nga gjykimi referuar nenit 201/1 të Kodit të Procedurës Civile. Nga ana ime janë pasqyruar të gjitha dispozitat procedurale, që lidhen me të drejtën e heqjes dorë nga gjykimi, pra me parimin e iniciimit të procesit nga pala paditëse dhe heqja dorë, të shprehura në mënyrë të qartë në dispozitat procedurale në vendim.*

*Çështja civile nr. *** regj., datë 22.10.2015 që i përket paditësit ‘***’ sh.a. kundër të paditurës P. K., me objekt: ‘detyrimin për pagimin e shumës 21,201 lekë si detyrim i papaguar për shërbimin telefonik’. Në lidhje me faktin që në procesverbalet e seancës përgatitore dhe gjyqësore mungojnë gjeneralitetet e palëve nga verifikimi i çështjes, rezulton se paditësi P. K. nuk është paraqitur personalisht në gjykim, pra në fazën e verifikimit të paraqitjes së palëve, gjykata nuk ka marrë gjeneralitetet e palëve, por ka vijuar me të dhënat sipas akteve të padisë, pasi për paditësen gjykimi ka vijuar në mungesë të saj, njoftuar me shpallje.*

Nga ana tjetër, lidhur me kalimin e afatit 6-mujor orientues të KLD-së, sqaroj se kjo çështje ka pasur problematika në njoftimin e palës së paditur, kjo për shkak të adresës. Për rrjedhojë, për të garantuar një proces të rregullt ligjor (konkretisht, detyrimi për të njohur palën e paditur me kërkesëpadinë dhe aktet bashkëngjitur, me qëllim mundësimin e paraqitjes në gjykim, të paraqitjes së prapësimeve dhe provave, të drejtën e mbrojtjes), kërkon domosdoshmërisht që njoftimi shkresor t’u bëhet personalisht palëve. Në këtë kuadër, fillimisht nga gjykata është aplikuar njoftimi me fletëthirrje, për t’u mundësuar dorëzimi nga nëpunësi gjyqësor ose shërbimi postar i letërthirrjes ose akteve të tjera personit, në rastin konkret të paditurës. Por, në kushtet kur njoftimi personalisht i saj nuk është mundësuar sipas parashikimit të nenit 130 të Kodit të Procedurës Penale (rregullat e njoftimit shkresor të akteve), është aplikuar njoftimi me shpallje (sipas nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile) duke u vendosur shpallja në Gjykatë, si dhe në vendin e adresës sipas akteve, duke qëndruar njoftimi i afishuar jo më pak se 20 ditë. Parimet e së drejtës kanë gjetur zbatim pikërisht në gjithë procedurën e zhvilluar për shqyrtimin e kësaj çështjeje, ku për të garantuar një proces

të rregullt ligjor është shkaktuar edhe kalimi i afatit orientues të shqyrtimit të kësaj kategorie çështjeje, por jo për mangësi në menaxhimin e saj.

Çështja që i përket vendimit civil datë 10.6.2014, me kërkuese Ç. P., person i interesuar DRSSH-ja Tiranë, DRSSH-ja Korçë dhe Komuna Bulgarec, me objekt vërtetim fakti juridik të marrëdhënieve të punës pranë ish-kooperativës bujqësore L... etj. Në lidhje me këtë çështje, sqaroj se ajo aktualisht ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, mbi ankimin e personit të tretë DRSSH.

Nga verifikimi në sistemin elektronik të gjykatës rezulton se shkaqet e shtyrjes së kësaj çështjeje kanë qenë si objektive (seanca datë 1.9.2014, pasi kam qenë jashtë shtetit), ashtu edhe në respektimin e të drejtës së palëve për të paraqitur prova, në kuadër të procesit të rregullt ligjor.

Seanca e datës 15.9.2014 ka vijuar dhe është shtyrë për paraqitjen e dëshmitarëve nga pala kërkuese, duke u caktuar seanca e ardhshme në datën 8.10.2014. Kjo seancë ka vijuar me pyetjen e dëshmitarëve dhe, në bazë të nenit 193 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata ka disponuar në bazë të nenit 193 të Kodit të Procedurës Civile të thërrasë në cilësinë e personit të tretë DRSSH Tiranë, duke u caktuar seanca datë 3.11.2014. Në këtë seancë është paraqitur përfaqësuesi i palës së tretë, i cili ka kërkuar që t'i jepet kohë për të verifikuar lidhur me dokumentacionet e dëshmitarëve pranë DRSSH-së Korçë, duke u shtyrë seanca më 24.11.2014. Kjo seancë është shtyrë përsëri me kërkesën e palës së tretë për t'i dhënë kohë për të marrë përgjigjen nga DRSSH-ja Korçë, pasi nuk i ishte kthyer përgjigje shkresës së dërguar prej saj. Në të njëjtën situatë ka vijuar edhe në seancën e datës 17.12.2014, duke kërkuar shtyrjen për këtë shkak, si dhe për të marrë nga Arkivi ISSH informacion lidhur me dokumentet e djegura pranë ish-kooperativës L, Korçë. Po kështu, në seancën vijuese datë 20.1.2015, duke u caktuar seanca e ardhshme datë 23.2.2015, e cila nuk është zhvilluar për shkak të paafësisë së përkohshme time në punë.

Në shqyrtimin e saj, gjykata është bazuar në nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet se kur mund të ngrihet kërkesa. Sipas kësaj dispozite "ku nga fakti varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë". Në këtë dispozitë është përcaktuar se kjo kërkesë paraqitet në gjykatën ku ka banimin kërkuesi. Në kuptimin procedural, kërkesa për vërtetimin e fakteve gjyqësore shqyrtohet në seancë gjyqësore në prani të kërkuetit dhe personave fizikë dhe juridikë që kanë interes. Në nenin 391 të Kodit të Procedurës Penale është përcaktuar se vendimi nuk ka fuqi provuese kundër personave fizikë a juridikë që nuk kanë qenë të thirrur, në rast se e kundërshtojnë faktin e vërtetuar në vendim. Duke marrë parasysh parashikimet e mësipërme të cilat janë zbatuar nga ana ime në shqyrtimin e çështjes, qoftë sa u përket provave të paraqitura nga pala kërkuese në lidhje me zhdukjen e dokumenteve të vjetërsisë në punë të saj, si dhe të pyetjes së dëshmitarëve... Duke qenë se kërkesa nga pala kërkuese i ishte drejtuar si persona të tretë DRSSH Korçë, Komuna Qendër B nga ana e gjykatës kryesisht është disponuar me thirrjen në gjykim në cilësinë e personit të tretë të DRSSH-së Tiranë. Kjo në kushtet kur kërkueti ishte me banim në Tiranë edhe pensioni do të lidhej pranë këtij institucioni, i cili duhet të ishte palë në proces, për të pasur fuqi provuese vendimi, në rast të kundërshtimit të faktit.

Vendimi i Gjykatës së Apelit ka prishur këtë vendim, duke argumentuar se duhet thirrur si palë e tretë Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të merren prova të tjera me dëshmitarë (të pamjaftueshëm 3), si dhe të merret si provë praktika dokumentare e lidhjes së pensioneve të vetë dëshmitarëve. Në asnjë rast të vërtetimit të faktit juridik të vjetërsisë në punë në praktikën gjyqësore nuk është thirrur ISSH-ja Tiranë, përveçse në çështje me mosmarrëveshje që kanë të bëjnë me lidhjen e pensionit dhe që kanë ezuaruar rrugën e ankimit administrativ në të

gjitha nivelet, si Komisioni Rajonal i Apelit pranë DRSSH-së përkatëse sipas qarkut dhe Komisioni Qendror i Apelit, pranë ISSH-së Tiranë, të cilat shqyrtohen nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë.

*Nga ana tjetër, evidentoj faktin që nga ana e DRSSH-ve kërkesat për vërtetim fakti të vjetërsisë në punë zvarriteshin ndër vite, edhe pse ishte i njohur fakti prej tyre që në disa kooperativa bujqësore regjistrat dhe dokumentet e tyre janë zhdukur plotësisht apo pjesërisht, por vijonte kalvari i gjykimeve pa fund deri në Gjykatën e Lartë. Prandaj, nga ana e qeverisë, duke marrë parasysh sensitivitetin e tyre, për shkak të kostove financiare të qytetarëve, është miratuar ligji nr. ***/2020 'Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore'. Për rastin e kërkujeses Ç. P. rezulton se sipas listës së përcaktuar për kooperativat bujqësore dokumentacioni i vjetërsisë në punë konstatohet tërësisht i munguar.*

*Në lidhje me konstatimin e Komisionit se në çështjen penale nr. *** regj., datë 13.7.2014, masë sigurimi G. Sh., vendimi është depozituar në sekretari, në datën 22.7.2014, 8 ditë pas shpalljes, 3 ditë jashtë afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale, sqarohet se nga ana ime i është dorëzuar sekretares gjyqësore vendimi së bashku me dosjen brenda afatit 5-ditor, dhe pjesa tjetër e afatit i është nevojitur asaj për kryerjen e procedurave administrative, numërtimi, qepja e dosjes, hedhja në sistem, anonimizimi, dorëzimi fizikisht në kryesekretari etj.”.*

Vlerësimi i Komisionit për shpjegimet në 5 dosjet e përzgjedhura me short

7. Duke parë arsyetimin dhe shpjegimet konkrete të subjektit të rivlerësimit për çështjet për të cilat iu kërkuan shpjegime, trupi gjykues vlerësoi se gjyqtarja Rexhina Merlika nuk ka kryer shkelje procedurale, që mund të ndikonin në zvarritjen e proceseve gjyqësore, për të cilat mund të merret masë disiplinore në kuadrin e rivlerësimit kalimtar.

Të dhënat nga burimet arkivore

8. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Rexhina Merlika ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 6.7.1989 dhe me vendimin nr. ***, datë 28.12.1993, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbini. Më pas, me vendimin nr. ***, datë 30.8.1995, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është transferuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe me vendimin nr. ***, datë 21.4.2008, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar kryetare e asaj gjykate. Më pas, me vendimin nr. ***, datë 20.12.2013, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ajo është transferuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku edhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.

9. Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtaren Rexhina Merlika në Inspektoratin e ish-KLD-së janë paraqitur 3 ankesa në vitin 2015.

10. 2 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura më parë, ndërsa ankesa e tretë, e verifikuar për zvarritje gjykimi, është arkivuar, pasi nuk rezultuan shkelje.

11. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Rexhina Merlika përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Analiza e gjetjeve

12. Subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Një parimet e përgjithshme të së drejtës të procesit të rregullt ligjor, ndonëse në tekstin

e vendimeve përfundimtare i përdor në raste të rralla. Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit, ajo përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë.

13. Ajo ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve civile në funksion të zgjidhjes së saktë të çështjes dhe është e aftë të identifikojë rastet kur zbatohet ligji specifik apo ligji më i hershëm në kohë. Dokumentet konfirmojnë njohuritë në të drejtën civile materiale dhe procedurale, ku bien në sy e drejta e dëmshpërblimit për shkak të zgjidhjes së marrëdhënieve, vlefshmërinë e titujve ekzekutivë, të drejtën e pronësisë, shpërblimin e dëmit, vërtetimin e faktit juridik të marrëdhënieve të punës dhe të drejtën e detyrimeve. Gjithashtu, ajo ka njohuri edhe për masat e sigurimit personal.

14. Është konstatuar se përgjithësisht ajo identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes. Në çështjet penale u kushton rëndësi rrethanave që përlligjin ose jo arrestimin e personave nën hetim dhe nëse masa e sigurimit të kërkuar nga organi i prokurorisë i përshtatet ose jo kërkesave dhe kriterëve ligjore të parashikuara nga ligji.

15. Në 5 dosjet e vëzhguara rezultojnë se janë ankimuar 3 prej tyre. Në dy raste nga këto, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, ndërsa në rastin e tretë është prishur vendimi i shkallës së parë dhe është kthyer çështja për rigjykim, me tjetër trup gjykues. Në 2 rastet e tjera nuk është ushtruar ankim nga palët.

16. Subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme.

17. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet edhe me pjesë nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë. Një tipar i mirë i punës së saj është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetim të tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina.

18. Subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dhomën civile. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga kjo Gjykatë për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për këtë periudhë gjyqtarja Rexhina Merlika ka përfunduar gjithsej 1229 çështje gjyqësore, nga të cilat 487 civile me palë kundërshtare, 504 kërkesa civile, 2 çështje penale themeli, 7 kërkesa penale dhe 231 masa sigurimi. Ngarkesa sasiore në tre vjet e gjyqtarës Rexhina Merlika, me 487 çështje civile me palë kundërshtare, ka qenë mbi standardin minimal.

19. Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Rexhina Merlika nuk ka qenë gjithnjë brenda afateve standarde apo ligjore, por në intervale kohore nga 1 ditë deri në 9 muaj e 28 ditë.

20. Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Rexhina Merlika në përgjithësi ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ajo ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal dhe i ka kushtuar rëndësinë e duhur arsyetimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore.

DENONCIMET

21. Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 15 denoncime. Disa nga denoncimet janë të përsëritura dhe gjithsej rezultuan 11 denoncime për subjektin Rexhina Merlika.

21.1 Denoncim i përsëritur nr. * prot., datë 23.11.2017; nr. *** prot., datë 5.7.2018 dhe nr. *** prot., datë 11.2.2021, i shtetasit A.S.** Ky shtetas denoncon gjyqtaren Rexhina Merlika për vendim të padrejtë dhe të njëanshëm, vetëm për të favorizuar palën tjetër. Kjo gjyqtare e transferuar në dhomën penale të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në tetor të vitit 2017, në shkelje të ligjit, nuk heq dorë nga çështja ime, megjithëse kam kërkuar 8 herë përjashtimin e saj. Nëpërmjet një deklarate noteriale të nënshkruar vetëm nga unë A. S dhe urdhrin të ekzekutimit vetëm për një kat të banesës, në vendimin e saj sot është ekzekutuar nga përmbartuesi gjyqësor e gjithë vila 4-katëshe dhe 500 m tokë, të cilat nuk kanë qenë kolateral. Gjyqtarja nuk ka marrë parasysh asnjë pretendim dhe provë timen, por ka favorizuar palën tjetër. Gjyqtarja Rexhina Merlika ka shtyrë seancat, nuk më ka njoftuar dhe më ka ofenduar në zyrën e saj kur bëhej gjykimi. Denoncuesi e mbyll denoncimin e tij, duke kërkuar që të merren masa ndaj kësaj gjyqtareje që abuzon me detyrën. Pikënisja e problemit të denoncuesit është, sipas tij, mosrespektimi i kontratës së huas me garanci hipoteke me nr. ***, datë 7.11.2012, ku huadhënësi B.Xh i jep hua shtetasit A.S vlerën prej 100.000 euro me interes 3% në muaj për një afat kohor 12 muaj. Huaja do të paguhet në shumën 136.000 euro. Garancia për kthimin e huas është vënia e godinës 4-katëshe, me sip. ndërtimi 167 m² e sip. parcele ndërtimi 500 m² të A. S. Kjo pasuri do të qëndrojë e bllokuar në ZVRPP Tiranë për llogari të B.Xh, deri në momentin e kthimit të huas të marrë nga A.S. Në rast se huamarrësi A. S., së bashku me garantuesen, nuk kthejnë brenda afatit shumën e marrë hua, ata bien dakord që për shlyerjen e saj t'i kalojnë huadhënësit dhe përfituesit nga hipotekimi B.Xh katin e parë të ndërtesës prej 167 m² të godinës 4-katëshe, duke qenë dakord të zbatohet neni 510/d e Kodit të Procedurës Civile. Në datën 20.1.2014, A.S nënshkruan një deklaratë noteriale, ku deklaroi se: *“Me përmbushjen e afatit të shlyerjes së huas, nuk e kam kthyer shumën që i detyrohem, deklaroj se vlera e huas që i detyrohem B.Xh është 145.000 euro deri në likuidimin përfundimtar të kësaj shume”*. Me kalimin e afatit dhe me moskthimin e shumës, huadhënësi i drejtohet gjykatës me kërkesën për lëshim urdhër ekzekutimi, sipas neneve 510/a dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile. Denoncuesi në lidhje me deklaratën noteriale të nënshkruar nga ana e tij thotë se: *“Është e pavlefshme, sepse bashkëshortja e tij E. S nuk ka dijeni, nuk ka firmë, nuk mban përgjegjësi”*. Në kalvarin e gjyqeve nga viti 2013 e tutje, denoncuesi padit shoqërinë përmbartimore private xxx për tjetërsim prone në mënyrë të padrejtë dhe në shkelje të procedurave ligjore. Ai denoncon faktin se në garanci hipoteke ka qenë kati i parë i godinës së banimit dhe jo krejt godina 4-katëshe dhe, për këtë shkak, nuk mund t'i nënshtrohej ekzekutimit krejt godina 4-katëshe. Në tri denoncimet radhazi të A. S ka vendime gjyqësore dhe dokumente të shumta pronësie, por Komisioni shqyrtoi vendimin nr. ***, datë 11.6.2018, me gjyqtare subjektin e rivlerësimit, me qëllim verifikimin e kërkesave procedurale të një vendimi gjyqësor, nga ku konstatoi se gjyqtarja Rexhina Merlika nuk rezultoi në shkelje të procedurave të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme. Ajo ka njoftuar palët në përputhje me dispozitat e kreut IV të Kodit të Procedurës Civile, nuk rezultojnë shtyrje të paarsyeshme, si dhe nuk evidentohen fjalë e shprehje në thyerje të rregullave të etikës së një gjyqtari⁶⁵. Ndërsa nuk mund të vlerësohet vendimmarrja e subjektit për çështjen në fjalë.

21.2 Denoncim i përsëritur nr. * prot., datë 26.7.2018 dhe nr. *** prot., datë 20.9.2018, i shtetasit M.H.** Denoncuesi denoncon gjyqtaren Rexhina Merlika për zvarritje të procesit gjyqësor. *Procesi gjyqësor ka nisur që në datën 30.6.2014 dhe vazhdon akoma në gjykatën e shkallës së parë. Dyshoj se kjo zvarritje nga ana e gjyqtarës bëhet qëllimisht për të favorizuar*

⁶⁵ Shihni faqen nr. 3 të denoncimit nr. *** prot., datë 23.11.2017.

palët e paditura, përfshirë korrupsionin. Sjellja e gjyqtarës gjatë seancave gjyqësore është jashtë normave të etikës. Ju lutem të merren masa për shkarkim të kësaj gjyqtareje nga sistemi i drejtësisë. Kam vënë në dijeni edhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe kryetaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranës. Bashkëlidhur, denoncuesi ka sjellë provat me të cilat mbështet ankimin: kërkesëpadi të datës 15.6.2014; kronologjinë e seancave gjyqësore, gjithsej 57, nga data 2.9.2014 – 4.6.2018; kontratë ndërmjet ortakëve e datës 5.11.2003; shtesë kontrate datë 18.5.2004. Në kushtet kur evidentohet një afat i gjatë i zhvillimit të procesit gjyqësor, që nga viti 2014 dhe vazhdon deri në datën 3.10.2018 (pa përfunduar ende deri në këtë datë), Komisioni shqyrtoi me kujdes dokumentin e printuar nga faqja zyrtare e Gjykatës së Shkallës së Parë, detaje të çështjes civile nr. ***, ku është pasqyruar kronologjia e seancave gjyqësore dhe përshkrimi i secilës seancë, nga ku vërejt se arsyet që kanë çuar në këtë zgjatje kohore janë kryesisht arsye që lidhen me kërkesa procedurale të mbështetura në ligj, pra me një shkak ligjor të arsyeshëm e të vërtetueshëm. Dhe fare pak seanca janë shtyrë si rezultat i mosprezencës së gjyqtarës Rexhina Merlika. Edhe në këto raste, mosprezenca e gjyqtarës ka qenë e argumentuar (seminar, raport mjekësor apo rast vdekjeje). Gjithashtu, evidentohet edhe një proces gjyqësor kompleks, duke qenë se palët ndërgjyqëse sillen si paditës dhe të paditur njëkohësisht, nëpërmjet ushtrimit të të drejtës për kundërpadi në një proces gjyqësor. Sa më sipër, duke qenë se nuk jemi para zvarritjeve të qëllimshme apo të pajustificuara të procesit gjyqësor nga ana e gjyqtarës, nuk mund të hetohet më tej në lidhje me denoncimin e paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kur faktet e rrethanat e sjella nga denoncuesi nuk përbëjnë provë në aspekt të rivlerësimit të kriterit profesional të subjektit.

21.3 Denoncim nr. * prot., datë 7.8.2018, i shoqërisë “****” sh.a.** Ky denoncim është paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nga përfaqësuesi i shoqërisë “****” sh.a., avokati D. E., me lëndë “dhënie informacioni për shkelje të realizuara nga trupi gjykues i përbërë nga anëtarët; Rexhina Merlika, R.P. dhe M. Sh.”, shkelje të cilat, sipas denoncuesit, janë objekt i kompetencës së Komisionit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga trupi gjykues me anëtarë Rexhina Merlika, R.P. dhe M.Sh. ka shqyrtuar çështjen Gjyqësore që i përket palëve: Paditës shoqëria “****”, sh.a., palë e paditur: shoqëria “****” sh.a. dhe palë e tretë: K. H dhe E.H, me objekt: *Përbushje e detyrimit kontraktor që rrjedhin nga kontrata e sigurimit lidhur në datën 23.4.2014 ndërmjet **** sh.a. dhe të ndjerit B. H nëpërmjet pagesës së shumës 150.000 euro. Ky proces gjyqësor është regjistruar në datën 14.5.2015 dhe vendimi përfundimtar është dhënë në datën 14.5.2018, pra gati 3 vjet pas regjistrimit të padisë. Në përfundim, vendimi është shpallur në datën 14.5.2018, ndërsa vendimi i arsyetuar është publikuar pas datës 15.6.2018, pra më shumë se një muaj pas shpalljes së vendimit.* Denoncuesi vazhdon duke thënë se për detaje të tjera që lidhen me shkeljet procedurale të gjykatës do t’i gjeni ato në ankimin e realizuar nga ***. Denoncuesi bashkëlidhur kësaj shkrese citon: *kopje të detajeve të çështjes civile, të publikuar në faqen e internetit të gjykatës; CD me regjistrim audio të seancës së datës 2 maj 2018 (ka sjellë të zbardhur seancën e datës 2.5.2018) dhe kopje të ankimit të depozituar nga ***.* Duke parë seancat gjyqësore në dokumentin “Detaje të çështjes civile nr. ****”, vihet re se data e regjistrimit të çështjes është 22.7.2015 dhe data e shpalljes së vendimit është data 14.5.2018, pra një kohë e gjatë, gati 3 vite. Kjo në kapërcim të afatit normal të zhvillimit të një procesi gjyqësor civil. Ndërsa duke lexuar seancën e zbardhur të datës 2.5.2018 (siç pretendohet nga denoncuesi), nuk evidentohet një fjalor fyes nga ana e gjyqtarës Rexhina Merlika, që të mund të çojë në shkelje të etikës së gjyqtarit në një proces gjyqësor.

Megjithatë, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për t’u njohur me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 14.5.2018 dhe ecurinë e kësaj çështjeje në shkallë të tjera të gjyqësorit, me qëllim identifikimin e shkeljeve procedurale të mundshme, të kryera nga gjyqtarja Rexhina Merlika.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁶, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka sjellë vendimin e sipërcituar, i cili ka statusin “e ankimuar”. Nga studimi i këtij vendimi nuk u evidentuan shkelje procedurale të gjyqtarës Rexhina Merlika, në cilësinë e kryesueses së trupës gjyqësore të përbërë nga tre gjyqtarë.

21.4 Denoncim nr. * prot., datë 15.11.2019, i shtetasit M.G.** Ky shtetas ka denoncuar subjektin e rivlerësimit *për manipulim të provave në dosjen gjyqësore, heqje dokumentesh dhe bërje gjyqi me dokumente të falsifikuara*. Bashkëlidhur ankesës, subjekti sjell dokumentacionin: kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.7.2013, të KLD-së; kërkesë datë 28.7.2013, drejtuar KLD-së; kërkesë datë 11.12.2012, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; Njoftim i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për mosfillimin të procedimit penal ndaj gjyqtarës Rexhina Merlika.

Nga studimi i dokumentacionit vihet re se ish-KLD-ja, pas verifikimit të ankesës së denoncuesit, i ka kthyer përgjigje shteruese në lidhje me shqetësimet që ai ngre në kërkesën e tij.

Gjithashtu, Prokuroria Durrës nuk ka filluar procedim penal në adresë të gjyqtarës dhe për këtë fakt është njoftuar kallëzuesi M. G.

Ndodhur në këto kushte, nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

21.5 Denoncim nr. * prot., datë 9.4.2019, i shtetasit T.R.** Ky denoncues ankohet për subjektin e rivlerësimit, duke thënë se: *“nuk merr parasysh provat dhe faktet. Edhe pse jemi thirrur për t’u dëgjuar, nuk na është dëgjuar zëri asnjëherë në bashkëpunim me G.Q. dhe avokaten tonë, që sillet si avokate e K. K”*... Gjithashtu ankohet *“për zvarritje në proces dhe mosprocedim ndaj një terroristi”*.

Nga formulari i denoncimit vihet re se ankuesi nuk përmend fakte e rrethana konkrete, nga të cilat të mund të hetohet për subjektin e rivlerësimit.

21.6 Denoncim nr. * prot., datë 28.6.2019, i shtetasit B.K.** Ky shtetas ka denoncuar shumë subjekte të tjera, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, - *“për shkelje të rënda ligjore në proces gjykim, duke mos marrë për bazë faktet dhe duke cenuar të drejtën time. Nëpërmjet korrupsionit më kanë marrë dy banesa pa firmën time dhe pa dijeninë time”*.

Bashkëlidhur, denoncuesi ka sjellë një sërë dokumentesh të pronave, objekt ankimi në gjykatë, dhe ndër to edhe vendimin nr. ***, datë 6.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të gjyqtarës R.S., e cila ka rrëzuar kërkesën e denoncuesit në cilësinë e paditësit. Gjithashtu, bashkëlidhur gjendet edhe vendimi nr. ***, datë 22.9.2016, i Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e sipërcituar.

Përveçse në formularin e denoncimit, ku denoncuesi, krahas shumë emrave të subjekteve, përmend edhe emrin e gjyqtarës Rexhina Merlika, në asnjë dokument apo vendim tjetër nuk përmendet emri i subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

21.7 Denoncim i përsëritur nr. * prot., datë 30.7.2019 dhe nr. *** prot., datë 22.4.2021, i shtetasit A.Z.** Ky denoncues ankohet ndaj gjyqtarës Rexhina Merlika *se vendimi nr. ***, datë 23.11.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mënyrë flagrante ka pranuar kërkesën e prokurorit E. B., në të cilin kërkohet pushimi i procedimit penal ndaj noterit A. R., znj. M.B etj.* Denoncuesi vazhdon ankimin duke thënë se: *“Unë nuk kam qenë në dijeni të seancave gjyqësore deri në marrjen e vendimit për pushimin e procedimit penal, për arsye se kam qenë jashtë shtetit. Në 8 faqe të vendimit të marrë prej gjyqtarës, objekt denoncimi, nuk është sqaruar aspak se si çështja hetimore ka kaluar nga prokurori Y. P. tek E. B”*. Gjyqtarja,

⁶⁶ Shihni përgjigjen nr. **** prot., datë 14.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

duke abuzuar me pozicionin e gjyqtarit në vendimin e saj me objekt pranimin e kërkesës së prokurorit E. B. për pushim të procedimit penal nr. ***, datë 9.1.2018, arrin deri aty sa të dalë nga objekti i kallëzimit ndaj noterit A. R., M. B. etj. Duke hyrë në çështje të brendshme familjare dhe duke deklaruar me vendim se “kallëzimi nuk ka të bëjë me asnjë fakt që lidhet me ndonjë veprë penale”, por të “mosmarrëveshjeve midis bashkëpronarëve” dhe duke dalë totalisht nga objekti i çështjes, sugjeron si zgjidhje përpjesëtimin e pasurisë në bashkëpronësi.

Duke parë vendimin nr. ***, datë 23.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk u konstatuan shkelje procedurale nga ana e gjyqtarës. Madje, parë edhe në optikën e gjyqtarit për dhënien e vendimit për pushim procedimi, në ballafaqim të nenit 203 të Kodit Civil, gjyqtarja ka konstatuar me të drejtë se ky nen nuk është shkelur nga palët në nënshkrimin e kontratës së qirasë (objekt kallëzimi në prokurori nga ankuesi).

Kështu që, Komisioni nuk vlerësoi të vazhdonte hetimin më tej për këtë ankim.

21.8 Denoncim nr. * prot., datë 8.6.2020, i shtetases J.H.** Kjo shtetase i është drejtuar edhe ILD-së, SPAK-ut, ku kërkon rivendosjen e të drejtës kushtetuese dhe ligjore për t'u mbrojtur vetë në cilësinë e kallëzueses prej 3 vitesh në një çështje, e drejtë e cila i është mohuar nga gjyqtarja Rexhina Merlika në seancën gjyqësore të datës 2.6.2020. Znj. J.H sqaron se ankesën e ka depozituar edhe në ILD në datën 18.2.2020, si dhe në institucione të tjera.

Për këtë, Komisioni iu drejtua ILD-së në lidhje me ecurinë e kësaj ankese, me qëllim vlerësimin e saj.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2022, me lëndë “kthim përgjigjeje shkresës me nr. *** prot., datë 4.11.2022”, ka bashkëlidhur dy vendime nr. *** prot., datë 22.9.2022 “Për verifikimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara, lidhur me disa pretendime të paraqitura nga shtetasja znj. J.H” dhe vendimin nr. *** prot., datë 22.9.2022, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara, lidhur me disa pretendime të paraqitura nga shtetasja, znj. J.H”.

ILD-ja, pas shqyrtimit të ankesave të ankueses me vendimin nr. ***, datë 22.9.2022, ka vendosur “verifikimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave...”, duke konstatuar zvarritje të çështjes.

Ndodhur në këto kushte, Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vonesat gjatë shqyrtimit të çështjes gjyqësore “Mbi procedimin penal nr. */2018”.**

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi se: *“Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur kërkesë, regjistruar në datën 28.12.2018, me objekt: pushimin e procedimit nr. ***/2018 për veprën penale ‘keqtrajtimi i të miturve’, parashikuar nga neni 124/1 i i Kodit Penal. Me shortin e datës 14.1.2019 (short i cili është hedhur me vonesë për shkak të mbartjes së dosjeve në këtë gjykatë, sipas urdhrit të drejtuesit të gjykatës), jam caktuar gjyqtare për shqyrtimin e kësaj kërkesë.*

Me marrjen për veprim të çështjes datë 15.1.2019 (një ditë pas shortit), brenda 5 ditëve, në datën 17.1.2019 kam urdhëruar kalimin e çështjes në seancë paraprahe datë 4.2.2019. Seanca paraprahe e kësaj date është zhvilluar me praninë e prokurorit, N. T., të kallëzueses J. H., të mbrojtjes së caktuar kryesisht nga gjykata për të miturit.

Me vendimin datë 4.2.2019, gjykata bazuar në nenet 329/3/b, 329/b/4 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur: ‘Kthimin e akteve të procedimit penal për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme sipas pjesës arsyetuese të këtij vendimi’. Ndaj këtij vendimi nuk ka ushtruar ankim prokurori, e kanë vijuar hetimet për këtë procedim penal.

*Kjo çështje është shqyrtuar për një afat 20-ditor, nga data e marrjes për veprim. Pra, në rastin konkret, nga ana ime janë respektuar në mënyrë korrekte afatet e parashikuara në ligj. Për këtë procedim penal është paraqitur sërish kërkesa për pushimin e procedimit, depozituar në gjykatë në datën 25.9.2019, por tashmë nga prokurori E. K. Kjo çështje ka vijuar me urdhrin për kalim në seancë paraprake, datë 23.10.2019, duke u njoftuar palët. Gjykata, pasi ka shqyrtuar çështjen më 23.10.2019, ka konkluduar se nuk janë plotësuar në tërësi detyrat e ngarkuara nga gjykata për hetimin e plotë dhe të gjithanshëm të çështjes e, për këtë shkak, ka disponuar me kthimin e akteve të procedimit penal Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme sipas pjesës arsyetuese të këtij vendimi. Më pas, prokuroria ka kërkuar dërgimin për gjykim të procedimit penal në ngarkim të shtetases J. H., akuzuar për veprën penale 'kundërshtim i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik', parashikuar nga neni 235/1 i Kodit Penal. Pushimin e hetimeve për sa i përket veprës penale 'keqtrajtim i të miturve', parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal. Në datën 9.3.2020 (brenda 5 ditëve nga depozitimi i kërkesës) është caktuar seanca paraprake, datë 2.4.2020, datë kjo brenda afatit të 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës sipas përcaktimit të nenit 332 të Kodit të Procedurës Penale. Por kjo seancë nuk është zhvilluar, për shkak se me vendimin nr. 127 të KLGJ-së është vendosur pezullimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore të një natyre jo të ngutshme, në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë për shkak të pandemisë, Covid-19, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 16.4.2019. Me kalimin e kësaj gjendjeje, gjykata ka caktuar seancën paraprake më 2.6.2020, në të cilën është paraqitur prokurori i çështjes, si dhe e pandehura J. H. Në momentin kur nga gjykata iu njoh e drejta e mbrojtjes së të pandehurës, nga ana e saj u deklarua se do të mbrohet vetë. Gjykata, në zbatim të nenit 332/b/1, në kushtet kur kërkohet mbrojtja e detyrueshme për të pandehurin, në këtë fazë të procedimit penal, ka disponuar me caktimin e mbrojtësit kryesisht të avokatit M. S. Në këtë moment, e pandehura ka dalë në mënyrë demonstrative nga salla e gjykimit. Në këto kushte, gjykata për një mbrojtje efektive të së pandehurës ka urdhëruar njohjen e mbrojtjes me aktet, duke caktuar seancën në vijim, si dhe njoftimin e të pandehurës për t'u paraqitur personalisht. Njoftimi i kësaj të fundit nuk është bërë i mundur në vijim, për rrjedhojë është arritur të njoftohet për seancën gjyqësore, datë 8.7.2020, nëpërmjet Komisarariatit të Policisë Nr. ***, sipas shkresës nr. *** prot., datë 7.7.2020. Seanca paraprake është zhvilluar në praninë e prokurorit dhe, në mungesë të së pandehurës, në cilësinë edhe të kallëzueses në të njëjtin proces, ku gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës. Dërgimin për gjykim të procedimit penal, për veprën penale 'kundërshtim i punonjësit të policisë...', parashikuar nga neni 235/1 i Kodit Penal dhe pushimin e çështjes penale për veprën penale 'keqtrajtim i të miturve', parashikuar nga neni 124/1 i Kodit Penal.*

Në rastin konkret, nga gjykata janë respektuar të gjitha afatet e gjykimit, por e pandehura i është shmangur gjykimit, duke vijuar gjykimin në mungesë të saj”.

Vlerësimi i Komisionit

Në lidhje me pretendimet e ankueses për vonesat gjatë shqyrtimit gjyqësor, shpjegimi i subjektit të rivlerësimit (gjyqtarës së çështjes me të pandehur ankuesen J. H.) është shterues dhe i plotë. Duke parë rrethanat e ecures së çështjes, si përfundim, nuk rezultoi që gjyqtarja Rexhina Merlika të kishte shkaktuar vonesa në shqyrtimin e procedimit penal në ngarkim të shtetases J. H.

21.9 Denoncim nr. * prot., datë 3.12.2021, i shtetasit O.A.** Ky denoncues me profesion gazetar ka kallëzuar për më shumë se 7 vjet më parë një bankë të nivelit të dytë për disa vepra penale, mes të cilave 'falsifikim e vjedhje nga llogaritë bankare'. Procedimi penal është regjistruar në vitin 2015 me nr. ***. Në vitet 2016 dhe 2017 me dy vendime të formës së prerë, gjykata i ka lënë disa detyra organit të akuzës. Në qershor të vitit 2021 kam bërë kërkesë për sigurim prove për detyrat që nuk i kryen organi i akuzës. Në datën 6 dhjetor 2021, pra gjyqtare Rexhina Merlika bëhet një seancë gjyqësore sipas kërkesës sime, ju ftoj të merrni pjesë dhe të

dëgjoni dhe vërtetoni se si vepron Prokuroria me një njeri të medias, vaj halli me të tjerët. Ose është e kundërta, ndaj gazetarëve këto veprime kryhen me qëllim.

Duke parë ankimin, konstatohet se ankuesi citon një numër procedimi penal, por jo një vendim apo praktikë gjyqësore konkrete, përkundrazi, kërkon pjesëmarrjen tonë në seancën gjyqësore të datës 6.12.2021, me gjyqtare Rexhina Merlika.

Në këto kushte, Komisioni vendosi t'i kërkojë shpjegime subjektit në lidhje me ecurinë e këtij procesi gjyqësor me palë kallëzuese ankuesin O.A.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtrroi se nga ana e ankuesit është depozituar në gjykatë ankim ndaj heshtjes së prokurorit mbi kërkesën e datës 7.6.2021, për sigurim prove (dëshmi dhe ballafaqim). Gjykata ka njoftuar palët për seancën gjyqësore datë 6.12.2022, por kjo seancë nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes së prokurorit, edhe pse i është dërguar shkresë prokurorisë për paraqitjen e prokurorit. Për këtë shkak është urdhëruar njoftimi i prokurorit Gj. T., i cili është caktuar me short për seancën gjyqësore, datë 19.1.2022. Në këtë seancë nga ana e ankuesit O. A. është hequr dorë nga kërkesa e, për këtë shkak, gjykata ka disponuar me deklarinimin të papranueshëm të kërkesës nr. *** akti, datë 12.11.2021, që i përket kërkesit O. A. me objekt "sigurim prove".

Vlerësimi i Komisionit

Në lidhje me këtë kërkesë të Komisionit për ecurinë e procesit gjyqësor, ku ankuesi është në cilësinë e kallëzuesit, vlerësohet se subjekti ka dhënë shpjegim të qartë e të mjaftueshëm, ku rezultoi se ka qenë vetë ankuesi që ka hequr dorë nga kërkesa drejtuar gjykatës.

21.10 Denoncim nr. * prot., datë 6.5.2022, i shtetases Sh.L.** Kjo shtetase, krahas subjektit të rivlerësimit, ka denoncuar edhe një prokuror S. H., e cila kërkon të merren masa ndaj gjyqtarës Rexhina Merlika dhe prokurorit S. H. për vendim abuziv dhe në kundërshtim me ligjin procedural penal, në çështjen penale me kallëzuese Sh.L. Nga dokumentacioni bashkëlidhur ankimit vihet re vendimi gjyqësor nr. ***, datë 4.11.2021, nga studimi i të cilit nuk evidentohen fakte apo rrethana të cilat të përbëjnë provë në aspekt të rivlerësimit të kriterit profesional të subjektit.

21.11 Denoncim nr. * prot., datë 16.9.2022, i shtetasit K. R.** Ky denoncues ankohet për subjektin e rivlerësimit për çështjen nr. *** akti, datë 11.12.2019, ku ka dhënë një vendim arbitrar dhe krejtësisht të pabazuar në ligj dhe në prova, në shkelje të ligjit procedural dhe atë material.

Gjithashtu, ankuesi kërkon që të merren masa ndaj gjyqtarës Rexhina Merlika dhe prokurores S. M. si të paafta në dhënien e drejtësisë.

Nga aktet bashkëlidhur denoncimit konstatohet se denoncuesi K. R ka bërë kallëzim penal ndaj punonjësve të **** dhe të Komisarariatit të Policisë Nr. *** Kamëz, me pretendimin se këta punonjës kanë kryer ndaj tij dhe familjes së tij veprime të kundërligjshme, të cilat vijnë në kundërshtim me kryerjen e detyrave funksionale të tyre. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 11.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 14.12.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale "shpërdorim detyre", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në fund të hetimit penal, prokurorja S. M. ka kërkuar pushimin e procedimit penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtarja Rexhina Merlika, me vendimin gjyqësor të muajit gusht të vitit 2019 ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë dhe pushimin e procedimit penal për veprën penale "shpërdorim detyre".

Nga studimi i dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së denoncuesit Kurt Rusi (kërkesë për pushim procedimi penal dhe vendim gjyqësor për praninë e kërkesës për pushim procedimi penal),

konkludohet se gjyqtarja nuk ka kryer shkelje procedurale, ndërsa nuk mund të gjykohet në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes në themel të saj.

21.12 Sa më sipër, Komisioni vlerësoi se nuk mund të bëheshin hetime të mëtejshme në adresë të subjektit të rivlerësimit.

TË TJERA

22. Komisioni, bazuar në disa *indicie*, hetoi lidhur me 2 çështje që mund të jenë ndjekur nga subjekti i rivlerësimit. Për këto 2 çështje u kërkua praktika përkatëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

i. Me shkresën nr. ***, datë 5.12.2022, Komisioni i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë praktikën që i përket çështjes civile me palë paditëse B, B dhe Z. M. Kjo gjykatë ka dërguar një kopje të kësaj praktike me shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2022. Nga praktika e dërguar rezultoi se çështja civile me palë paditëse B. M dhe i paditur Këshilli i Qarkut Durrës është shqyrtuar nga gjyqtarja E. H dhe jo nga subjekti i rivlerësimit. Përfaqësues në këtë çështje gjyqësore i palës paditëse rezultoi avokat L. M, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

ii. Me shkresën nr. *** prot., datë 5.12.2022, Komisioni i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë praktikën që i përket çështjes penale me objekt “caktim mase sigurimi” me palë të pandehur A. S. dhe K. T. Kjo gjykatë ka dërguar një kopje të kësaj praktike me shkresën nr. *** prot., datë 16.12.2022.

23. Rezultoi se gjyqtare e çështjes për caktimin e masës së sigurisë për këta 2 shtetas të kapur në kushtet e flagrancës (arrestuar për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit”) ka qenë subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika.

24. Subjekti, me anë të procesverbalit të datës 25.12.2016, ka vendosur:

- a) Vleftësimin si të ligjshëm të “arrestit në flagrancë” ndaj personit nën hetim A. S.
- b) Caktimin si masë sigurimi “detyrim paraqitjeje në policinë gjyqësore”.
- c) Personi A. S. detyrohet të paraqitet pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë të mërkurën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 12:00.
- d) Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i A. S., etj.

25. Subjekti, po në datën 25.12.2016, ka nxjerrë edhe shkurtimin e vendimit dhe vendimin (nr. *** regj. themeltar) lidhur me masën e sigurisë për shtetasin A. S. Sipas vendimit, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, se shtetasi A. S. ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet. Gjykata çmon se ekziston rreziku që personi nën hetim, për shkak të dënimit për veprën penale, t’i shmanget hetimit dhe, si rrjedhojë, edhe gjykimit që mund të zhvillohet. Pra, Gjykata vlerëson se ekziston një nga kushtet e parashikuara nga germa “b” e nenit 228/3 të Kodit të Procedurës Penale, pra rreziku i largimit. Kështu që nga analiza e bërë rezultoi se plotësohen kushtet që ligji ka parashikuar si të domosdoshëm për caktimin e një mase sigurimi personal.

26. Ky arsyetim i bërë nga Gjykata nuk përkon me vendimmarrjen e saj, duke i caktuar personit nën hetim A. S. masën e sigurimit “detyrim paraqitjeje”.

27. Gjithashtu, Gjykata nuk analizon në mënyrë shteruese dhe bazuar në prova lidhur me rrezikshmërinë shoqërore të shtetasit A. S., ekzistencën e dënimeve apo procedimeve të mëparshme të tij, punën, gjendjen shoqërore apo familjare etj., pra rrethanat rënduese apo lehtësuese.

28. Të njëjtën masë sigurimi dhe të njëjtat arsyetime ka përdorur gjykata edhe për shtetasin tjetër K. H. (vendimi nr. *** regj. themeltar).

29. Duket se gjykata (subjekti i rivlerësimit) ka lehtësuar masën e sigurisë për shtetasit A. S. të arrestuar në kushtet e flagrancës, duke vendosur në kundërshtim me pjesën arsyetuese dhe argumentuese të saj dhe pa vlerësuar e referuar rrethanat lehtësuese dhe/apo rënduese lidhur me këtë shtetas.

30. Për gjetjet e mësipërme subjektit iu kërkua të japë shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

31. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtrori se: *“Këto çështje lidhen me të njëjtin procedim penal dhe nga ana ime nuk është lehtësuar masa e sigurimit ndaj shtetasit A. S., përkundrazi, kam mbajtur të njëjtin standard vlerësimi. Nga prokurori i çështjes është kërkuar për të njëjtin fakt penal masë sigurimi ndryshe për shtetasin K. T. ‘detyrim paraqitjeje në policinë gjyqësore’, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, ndërsa për shtetasin A. S. ‘arrest në burg’, parashikuar nga neni 283 i Kodit të Procedurës Penale. Në arsyetimin e vendimit nga ana ime janë trajtuar në mënyrë të hollësishme të gjitha kushtet dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të caktimit të masës së sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229, 230 të Kodit të Procedurës Penale. Sqaroj se para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, hyrë në fuqi në gusht të vitit 2017, kërkesat e prokurorit për vleftësim e caktim mase sigurimi silleshin në mënyrë individuale për secilin person nën hetim, pavarësisht se ndaj tyre ishte regjistruar i njëjti procedim penal. Kjo gjë ka sjellë në praktikë qëndrime dhe praktika të ndryshme të prokurorit dhe gjykatës, por me ndryshimet procedurale të vitit 2017, ligjvënësi ka përcaktuar në nenin 245/2 të Kodit të Procedurës Penale se, ‘Kur vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, gjykata disponon në një vendim, duke arsyetuar kushtet dhe kriteret për secilin prej tyre’. Kjo është realizuar nga ana ime në arsyetimin e vendimit, duke argumentuar kushte dhe kriteret të njëjta, por kam arsyetuar se përse nuk mund të aplikohet masa e sigurimit ‘arrest në burg’ për shtetasin, pasi ajo nuk ishte e përshtatshme për këtë person. Në këtë vendim është argumentuar se ‘Gjykata, duke mbajtur parasysh edhe raportin midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për këtë kundërvajtje penale, që është dënimi me gjobë dhe deri në dy vjet burgim, çmon se masa e sigurimit ‘arrest në burg’ nuk është e përshtatshme. Në referim të nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale, masa e sigurimit ‘arrest në burg’ mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të personit. Nga ana e prokurorit nuk u argumentua asnjë arsye se përse kërkon aplikimin e kësaj mase sigurimi, në një kohë kur vepra penale parashikohet si kundërvajtje penale dhe nuk përlligj një masë të tillë. Pra, nuk jemi para rrezikshmërisë së veçantë jo vetëm të veprës, por as të personit të dyshuar. Personi nën hetim është i padënuar me parë, në gjykim u shpreh i penduar dhe, për këto arsye, gjykata vlerëson se masa e sigurimit ‘detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore’, e parashikuar nga neni 234, është masa më e përshtatshme që mund të jepet ndaj shtetasit A. S.*

Me këtë arsyetim kam zbatuar në mënyrë korrekte dispozitat procedurale penale lidhur me caktimin e masave të sigurimit në të gjitha aspektet e tyre”.

32. Për të provuar sa më sipër, subjekti, bashkëlidhur parashtrimeve përfundimtare të saj, ka paraqitur provat shkresore⁶⁷.

⁶⁷ Të dhëna nga sistemi elektronik për çështjen që i përket paditësit D. Gj. me nr. *** regj., datë 16.1.2014, data e vendimit 8.4.2015, lënë në fuqi; Të dhëna nga sistemi elektronik për çështjen që i përket kërkueses Ç. P. me nr. *** regj., datë 10.6.2014, data e vendimit 3.3.2014, prishje dhe kthim; Të dhëna nga sistemi elektronik për çështjen që u përket paditëseve A. H. etj., datë regjistrimi 29.8.2014, data e vendimit 30.3.2015, lënë në fuqi; Lidhur me ankesën e shtetasit J.H: vendim nr. *** regj. S. P., datë 28.12.2018; Vendim nr. *** regj. S. P., datë 23.10.2019; Vendim nr. *** regj. S. P., datë 8.7.2020; Vendim nr. ***, datë 9.11.2020; Lidhur me ankesën e shtetasit O.A: vendim nr. ***, datë 19.1.2022; Procesverbale të transkriptuara për seancat 6.12.2021 dhe 19.1.2022.

Vlerësimi i Komisionit

33. Komisioni vlerësoi shpjegimin e subjektit në lidhje me argumentimin e saj për lehtësimin e masës së sigurimit të shtetasit A. S. nga “arrest në burg” në “detyrim paraqitjeje”, për sa u përket kushteve dhe kriterëve të njëjta për shtetas të ndryshëm në një proces penal, por subjekti nuk arriti të shpjegojë faktin se për sa kohë shtetasi A. S. është arrestuar në kushtet e flagrancës, cilat ishin rrethanat konkrete lehtësuese, që çuan në ndryshimin e masës së sigurimit.

34. Megjithatë, në referim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht neneve 228 e vijues të saj, për sa kohë gjykata mund të ndryshojë masën e sigurimit (duke e zëvendësuar me një më të butë), mungesa e një arsytimi më të detajuar për këtë çështje nga subjekti nuk përbën shkak për evidentim shkeljeje procedurale të kryer prej saj.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

35. Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave, arrin në përfundimin se:

Për vlerësimin e pasurisë

36. Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, për arsyet e përmendura në këtë vendim në kriterin “vlerësim i pasurisë”.

37. Rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të paplotë dhe ka mungesë të burimeve financiare lidhur me pasuritë. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për blerjen e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

38. Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasuritë, si dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, sipas përcaktimeve të germës “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

39. Duke u gjendur në këtë mënyrë, në plotësim të kushteve të parashikuara nga pika 1 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon se: “Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë dhe burimin e krijimit.

40. Pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të përmendura në këtë vendim.

41. Pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon se *nëse subjekti i rivlerësimit përpjetet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë.

42. Subjekti nuk gjendet në kushtet e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, subjekti gjendet në kushtet e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

43. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

44. Në rastin e subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

45. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika nuk ka arritur nivel të mjaftueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Për vlerësimin e figurës

46. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Për vlerësimin e aftësive profesionale

47. Në përfundim, lidhur me kriterin profesional për pesë çështje të shortuara, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

48. Lidhur me denoncimet dhe 2 çështje të tjera, trupi gjykues konstatoi disa shkelje të subjektit të trajtuara më sipër në këtë vendim, por u konsideruan si raste dhe problematika që nuk përbëjnë shkak për penalizimin e subjektit lidhur me kriterin e vlerësimit profesional.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton nga vlerësimi i kriterit të pasurisë sipas paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Rexhina Merlika ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, z. Elka Ermenkova, referuar germës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 13.3.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi